



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 dhe 23 NËNTOR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
20. i 23. NOVEMBRA 2009. GODINE

NËNTOR – NOVEMBRA
2009

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20 dhe 23 NËNTOR 2009

E premte, më 20 nëntor 2009, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë kemi 61 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fillojmë me të vetmen pikë të rendit të ditës.

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka përgatitur dhe Kuvendit të Kosovës (Ju lutem lexoni Rregulloren), rendi i ditës është bërë me Kryesinë dhe shefat e grupeve parlamentare.)

Unë nuk jam i obliguar t'ju njoftoj për atë që kemi dëgjuar në mediat, në televizione apo në gazeta. Zyrtarisht, unë si kryetar po ju tregoj Kuvendi e kryen punën e vet sipas agjendës që e ka.

(Reagime nga salla, nuk dëgjohen për transkriptim)

Unë edhe një herë po ju them, nuk kam kurrfarë obligimi t'ju njoftoj me politikën që është udhëhequr gjatë fushatës zgjedhore, një.

Dy, ne si Kuvend kemi përgjegjësinë me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të Punës. Ne e kemi rendin e ditës, prandaj vazhdojmë me rendin e ditës. Ju dëgjoni konstatimet e mia hyrëse.

(Reagime nga salla nuk dëgjohej për transkriptim)

Unë, si kryetar i Kuvendit, tregova çka ka ndodhur. Unë s'jam i obliguar t'i komentoj veprimet që kanë ndodhur jashtë institucionit të Kuvendit. Unë e kam një rend dite të miratuar nga Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare dhe unë po e procedoj këtë sipas

rendit të ditës të miratuar si zakonisht. Asnjë obligim tjetër s'kam për veprimet që bëhen jashtë Kuvendit nuk jam i obliguar t'i komentoj.

(Reagime nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

Ne sot jemi ardhur me rend të ditës lidhur me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010. Ky është rendi i ditës që e keni marrë. Rend të ditës unë tjetër s'kam.

Është shtyrë për shkak të dy grupeve, konsultimeve që ka pasur Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe Partisë Demokratike, për tjetër send nuk është shtyrë Kuvendi. Vazhdojmë. Ku është ministri për Ekonomi dhe Financa? Mirë. Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektbuxhetin për vitin 2010.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar Kryetar!
Të nderuar parlamentarë,
Dhe gjithë të pranishëm,
Kam nderin që para jush ta prezantoj Projektbuxhetin.

(Reagime nga salla, nuk dëgjohen për transkriptim)

Okej, unë jam edhe Kryeministër edhe kryetar partie dhe mund të japë.

(Ndërpritet incizimi)

Okej, e lexoj pastaj menjëherë.

KRYETARI: Pauzë prej 30 minutash, grupet parlamentare merruni vesh një herë.

Pauzë 30 minuta.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë seancën.
Fjalën e ka kërkuar shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Konsideroj që materiali për buxhetin ka ardhur bukur vonë dhe mendoj që sot seanca duhet shtyrë për të hënë në orën 10,00, që t'i kemi edhe këto ditë pak në dispozicion që ta përpunojmë më mirë dhe të jemi më në nivel ditën e hënë, në orën 10,00.

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka në emër të LDK-së, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së fillimisht e kishte kërkesën që sot me mocion të shtyhej seanca për javën e ardhshme për shkak të kohës së pamjaftueshme për ta lexuar buxhetin. Është shumë e rëndësishme që ka ardhur me kohë buxheti, por deri në afatin ligjor besoj që do të kemi kohë për të punuar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë kemi një mocion dhe votojmë për mocionin.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Kemi mocionin dhe ne me Rregullore të Punës jemi të obliguar ta hedhim në votim.

Kush është “për”, regjia i numëron votat. Faleminderit. Kush është “kundër”? Me shumicë votash seanca shtyhet për të hënë në orë 10,00. Mirë u pafshim!

* * *

E hënë, më 23 nëntor 2009, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë prezentë 82 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar punës.

Kjo seancë ishte paraparë për 20 nëntor 2009, por që me propozimin e grupeve parlamentare të PDK-së e LDK-së është shtyrë për sot, andaj vazhdojmë punimet sipas rendit të ditës të propozuar.

Rendi i ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010**

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit i ia ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në parim Projektligjin për buxhetin e vitit 2010.

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektbuxhetin për vitin 2010.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Kryetar i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi,

Të nderuar parlamentarë, Kabinet qeveritar,

Gjithë të pranishëm, përfaqësues të përfaqësive, ambasadave diplomatike, përfaqësues të ICO, EULEX-it, të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë që jeni sot të pranishëm, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot kam nderin që para jush ta prezantoj buxhetin për vitin 2010, të përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim të ngushtë dhe i harmonizuar me të gjitha ministritë dhe agjencitë tjera relevante.

Më lejoni të theksoj se ky është buxhet i zhvillimit ekonomik, i vazhdimit të reformave dhe integritetit evropian. Në këtë kohë kur bota po ballafaqohet me efektet e krizës ekonomike- globale, ne presim që ekonomia jonë gjatë vitit 2010 të shënojë një rritje rreth 5%, që padyshim paraqet një sukses të konsiderueshëm. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve është ndërtuar edhe ky projektbuxhet, i cili duhet të konsideruar si një rritje e re në mesin e sukseseve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ky buxhet do të jetë i orientuar në drejtim të implementimit të politikave zhvillimore për të mirën e gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës e në veçanti përkrahjen e atyre politikave të cilat janë vlerësuar prioritare në këtë fazë të zhvillimit të shtetit tonë.

Buxheti i paraparë për vitin 2010 do të jetë në nivelin prej një miliard e 461 milionë euro, që përfshinë të gjitha ndarjet buxhetore, me një rritje prej rreth 6%, krahasuar me buxhetin e vitit 2009.

Ndarjet primare në strukturën e këtij buxheti janë paraparë të jenë, pra një miliard e 146 milionë, që paraqet një rritje prej 8%, krahasuar me nivelin e paraparë të shpenzimeve primare për vitin 2009.

Brenda buxhetit është paraparë rruajtja e rezervave fiskale në vlerë prej 200 milionë euro, e cila rezervë u jep kredibilitet politikave tona për përballimin e rreziqeve potenciale.

Gjithashtu edhe servisimi i borxhit të jashtëm është pjesë e ndarjeve buxhetore për vitin e ardhshëm.

Kjo rritje e shpenzimeve buxhetore është mundësuar përmes dy faktorëve, parashikimit për rritjen e të hyrjen buxhetore si dhe shfrytëzimin e bilancit të akumuluar bankar nga vitet e kaluara.

Për dallim nga viti 2009, kur pati një rritje në nivelet të ardhurave nga grumbullimi i të hyrave të njëhershme, rritja e të hyrave buxhetore për vitin 2010 vjen si rezultat i zgjerimit të bazës tatimore dhe paraqet ngritje në trendin e të hyrave.

Duke ruajtur ngritjen e përgjithshme buxhetore që ne si Qeveri e filluam dy vjet më parë kemi arritur që edhe përmes këtij buxheti të sigurojmë fonde shtesë dhe të mbështesim edhe fushat më fuqishëm si në vijim.

Në sektorin e shëndetësisë janë rritur fondet për sigurim të barnave esenciale si dhe ai për trajtim të pacientëve jashtë vendit. Po ashtu është planifikuar kompensim shtesë për personalin mjekësor për punën jashtë orarit, rritjen e përkrahjes financiare për kategoritë e dala nga lufta, në veçanti për invalidët e luftës.

Kemi mundësuar fonde të nevojshme për zbatimin e platformës së re të gradimit konform Ligjit për Policinë e Kosovës.

Po ashtu kemi dhënë mbështetje shtesë për punonjësit në Shërbimin e zjarrfikësve.

Janë afruar dispozitat financiare dhe buxhetore për themelimin e Universitetit të Prizrenit, Universitetit të dytë publik në Republikën e Kosovës.

Në të njëjtin kohë është rritur mbështetja maksimale financiare për Universitetin e Prishtinës.

Mbi të gjitha në pajtueshmëri me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës ne kemi mbajtur investimet kapitale mbi 400 milionë euro, shumë kjo që ka ndikim direkt në gjenerimin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mundësive të reja.

Duke pasur parasysh përgatitjet tona për tërheqjen e kapitalit privat të huaj dhe vendor, si përmes procesit të privatizimit ashtu edhe përmes procesit të konsisionimit, ne mbetemi të përkushtuar që ta rrisim vlerën e investimeve kapitale përmes të ardhurave nga këto procese.

Rritje të mëtejshme janë bërë edhe në projekte tjera të cilat janë paraqitur në tabela të cilat i kemi para jush.

Do t'ju përkujtoja këtu për një mori të projekteve infrastrukture që do të vazhdojë të jenë të njohura opinionit e posaçërisht edhe juve.

Në veçanti për fillimin e autostradës Vërmicë – Morinë – Prizren, drejtimi i Prishtinës, pastaj vazhdimi i ndërtimit të shkollave të reja dhe mbështetje e vazhdueshme e komunave përmes grandeve qeveritare, duke përfshirë këtu edhe formimin e komunave të reja në përputhshmëri me dokumentin e Presidentit Ahtisari dhe me zgjedhjet që janë mbajtur më 15 nëntor.

Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu vazhdon të ndërtojë dhe të plotësojë institucionet e shtetit sovran. Në këtë drejtim është paraparë: financimi i blerjes së ambasadave të reja, funksionalizimi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, fuqizimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës si dhe shumë institucione tjera që do të sjellin më afër përmbushjes së objektivave tona si Qeveri dhe shtet.

Në përgatitjen e këtij projekti, ne kemi pasur mbështetjen e plotë dhe konsultimet e këshillat e vlerësuara të partnerëve ndërkombëtarë siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore si dhe Komisioni Evropian.

Aftësia jonë për të realizuar një planifikim të tillë të buxhetit ka qenë një nga parakushtet për transferin e ndihmave të shumta financiare, si të atyre të premtuara në Konferencën e Donatorëve ashtu edhe fonde shtesë që presim të përfitojmë si anëtarë të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Me aprovimin e këtij buxheti ne dëshmojmë se veprimet tona si Qeveri janë në pajtueshmëri me planet strategjike të paraqitura në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe njëkohësisht shfaqim pjekurinë tonë si menaxhues të mirë të parashë publike.

E gjithë ky sukses është arritur para së gjithash nga instalimi i qeverisjes së mirë, efikase dhe efektive, rritjes së transparencës, sundimit të ligjit, faktorit gjithëpërfshirës, reformave demokratike të shumanshme dhe shumë të fuqishme, luftës së pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e dukurive tjera, përgjegjësisë së lartë të Qeverisë në nivel qendror dhe lokal, ky buxhet është buxhet i të gjithëve dhe do të jetë në shërbim të gjithëve. Ky buxhet është buxheti i zhvillimit ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës, i reformave demokratike dhe perspektivës evropiane euroatlantike të Republikës së Kosovës.

Prandaj, të nderuar parlamentarë, Kabinet qeveritar,
Si Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës ky buxhet e ka mbështetjen time të plotë, është buxhet i konsultuar me faktorët politikë, është buxhet i konsultuar me gjithë faktorin më të rëndësishëm vendimmarrës edhe me faktorin këshillëdhënës në këtë drejtim mendoj që do të jetë një debat i mirëfilltë. Ju falënderoj, për çdo sugjerim, këshillë, rekomandim të cilin do ta jepni dhe do të propozoja që para jush në detaje buxhetin për vitin 2010 ta paraqesë edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Shala. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta arsyetojë Projektbuxhetin e vitit 2010.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar Kryetar i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë, media, të gjithë të pranishëm,

Kam kënaqësinë dhe nderin e veçantë që sot para jush ta prezantoj Projektbuxhetin për vitin 2010, të aprovuar paraprakisht në Qeverinë e Republikës së Kosovës, i cili është si rezultat i përmbylljes së një procesi të rëndësishëm planifikues e që ka zgjatur me muaj të tërë.

Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje të plotë me programin qeveritar dhe prioritetet e përcaktuara të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili ka synim paqësor, mbështetjen e politikave zhvillimore të cilat adresojnë fuqishëm nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe rritjen e mirëqenies së tyre në gjithë territorin e Republikës.

Më saktësisht struktura e buxhetit respekton prioritetet kryesore e që janë: Rritja ekonomike, zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, qeverisja e mirë dhe stabiliteti social.

Dëshiroj të theksoj se ky buxhet nga njëra anë adreson nevojat e ekonomisë së vendit ku rruajtja e nivelit të lartë të shpenzimeve kapitale, përkatësisht investimeve kapitale, për të mos lënë keqkuptime, synon krijimin e një ambienti stimulues për investime të sektorit privat dhe zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme për fuqizimin e po këtij sektori, ndërsa në anën tjetër respektohet parimi i ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale. Kjo do të thotë se janë përcaktuar kufijtë buxhetorë nga parashikimi i të hyrave buxhetore për vitin 2010, nga shfrytëzimi i bilancit të akumuluar bankar i vitit 2009 dhe nga ndihma e premtuar financiare e partnerëve tanë ndërkombëtar.

Plani i shpenzimeve mbase mund të quhet edhe ambicioz duke pas parasysh që tejkalon nivelin e të hyrave të rregullat për vitin e ardhshëm, por besoj se boshllëku i planifikuar buxhetor prej 3% të bruto prodhimit vendor, do të shërbejë si shtytje dhe vlerësim i mundësive alternative të financimit dhe të njëjtën kohë menaxhimit më të mirë, më efikas të shpenzimeve duke shfrytëzuar çdo rast rritje të efektivitetit dhe kursimeve të brendshme buxhetore.

Më lejoni të elaboroj në hollësi strukturën e buxhetit.

Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2010 janë parashikuar të jenë në vlerë prej një miliard e 29 milionë apo rreth 8% më të larta se të hyrat e rregullta për vitin 2009. Në rrethana krizash, siç e tha edhe Kryeministri konsideroj se ky është një planifikim dhe një buxhet mjaft ambicioz.

Të hyrat e përgjithshme për vitin 2010 janë natyrisht në terme absolute për vlerën e dividendës së Postës më të ulëta, por si tërësi të hyrave të grumbulluara, siç e thashë është mbi 8% më e lartë se sa në vitin 2009.

Është inkurajues fakti që edhe përkundër prezencës së krizës ekonomike të hyrat vendore dhe ato nga kufiri nuk do të kenë ndikime pozitive.

Performanca e të hyrave buxhetore gjatë këtij viti ka qenë mjaftë e kënaqshme, gjë që ka krijuar një bazë solide mbi të cilën janë bërë parashikimet për vitin e ardhshëm. Vlerësimet nga institucionet relevante ndërkombëtare flasin për fillimin e tejkalimit të kësaj krize dhe tashme fillimit të rimëkëmbjes së saj gjithë andej.

Natyrisht që kjo, medoemos do të ketë ndikim pozitiv edhe në performancën e të hyrave buxhetore në vendin tonë.

Përveç vlerësimeve për zvogëlim të efekteve negative të krizës globale ne kemi ndërmarrë edhe masa tjera shtesë administrative që do të kenë efekt direkt në ngritjen e nivelit të inkasimit të hyrave në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Tanimë jemi në fazën finale të pajisjes të gjitha bizneseve me numra fiskal, që ndër të tjera na krijon mundësi për identifikimin e të gjitha bizneseve aktive në Kosovë. Është një hap që konsideroj po i sjell efektet e veta të para pozitive.

Po ashtu futja e arkave fiskale proces, i cili filloj javën e kaluar dhe që do të vazhdojë me licencime dhe me zbatim praktik të këtij procesi në të ardhmen ka filluar dhe do t'i japë efekte të veta pozitive në vitin 2010.

Përpos këtyre të hyrave të rregullta buxhetore pritet që të trashëgojmë gjithashtu një bilanc pozitiv bankar nga ky vit, çka do të përdoret si burim shtesë i financimit për vitin 2010.

Duhet thënë se thelbi i buxhetimit kualitativ qëndron në balancimin e të hyrave dhe shpenzimeve në një vit. Në këtë frymë ne do të jemi të kujdesshëm në shfrytëzimin e bilancit bankar, për më shumë ne jemi të përkushtuar në ruajtjen e rezervës fiskale prej 200 milionë euro, rezervë kjo që na shërben si masë mbrojtëse ndaj efekteve të krizave eventuale me të cilët mund të përballohet vendi ynë.

Në bazë të rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Republika e Kosovës ka rritur rezervën buxhetore nga 50 milionë në 200 milionë euro, rezervë kjo që shërben si mbrojtje ndaj tronditjeve të mundshme ekonomike siç e thashë më lart.

Fatmirësisht kjo rezervë nuk u shfrytëzua gjatë vitit 2009, falë angazhimeve dhe impulseve të fuqishme të investimeve publike, zvogëlimit të shpenzimeve dhe normës së ulët të normave tarifore.

Por duke marrë parasysh se niveli i riskut sistematik është ende i lartë, Qeveria ka vendosur ta alokojë të njëjtën shumë edhe për vitin 2010.

Natyrisht se klasifikimi i kësaj ndarje në kategorinë e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore është shumë praktik, sepse jep mundësi Qeverisë së Republikës së Kosovës që të vlerësojë riskun në baza vjetore dhe eventualisht kur ky risk zvogëlohet ta riallokojë këtë rezervë drejt projekteve zhvillimore të nevojshme.

Duhet theksuar se ne jemi në konsultime të vazhdueshme me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me institucione tjera të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat kanë dhënë rekomandimet e veta gjatë hartimit të këtij buxheti.

Unë jam shumë i lumtur të raportoj këtu para jush, që Fondi Monetar Ndërkombëtar, pas negociatave të shumta përmbajtjesore dhe jo të lehta është ndarë i kënaqur dhe është pajtuar plotësisht me strukturën e këtij buxheti dhe ne kemi shumë arsye të presim që në të ardhmen e afërt Kosova të ketë një qasje në programet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Është theksuar edhe më parë se ne duhet të kërkojmë dhe të gjejmë edhe burime tjera alternative të financimit të projekteve të nevojshme në Kosovë.

Në këtë drejtim dua të potencoj se hyrja në programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar ku delegacioni i Fondit pritet të vijë diku në fund të janarit, do të na mundësoj që në mënyrë substanciale të kontribuojmë në zhvillimin e përgjithshëm të vendit duke tejkaluar kufizimet që vinë nga të hyrat buxhetore.

Gjatë përgatitjes së këtij buxheti ne jemi përballuar me kërkesat dhe presione të shumta konkurruese nga organizatat e ndryshme buxhetore. Mirëpo objektivi ynë ka qenë ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe kredibiliteti planifikues duke respektuar përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ofrimin e një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Buxheti si tërësi afron shumën e përgjithshme të shpenzimeve publike prej një miliard e 461 milionë euro e që shënon një rritje prej mbi 6%, krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Ky buxhet siguron stimulim fiskal që Kosova të ketë një rritje të projektuar ekonomike, që është mbi 5%, gjatë vitit 2010, me të cilin nivel të rritjes është pajtuar në parim edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Rreth 35% e shpenzimeve primare të këtij buxheti apo mbi 400 milionë janë dedikuar për shpenzime kapitale duke mbuluar nevojat kryesore dhe më prioritare të vendit. Jemi shumë të sigurt se kjo qasje jep buxhetit komponentin zhvillimor e cila si e tillë ofron shtytje të vazhdueshme për rritjen ekonomike në vend, krijimin e vendeve të reja të punës dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit privat.

Disa prej fushave kryesore që do të përfitojnë nga ngritjet në këtë projektbuxhet të radhitura sipas prioriteteve të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë si vijon.

Transporti: Buxheti i vitit 2010 ofron 112 milionë e 500 mijë euro prej të cilave 58.9 milionë euro për rehabilitimin e rrugëve, 1,8 milionë euro për sinjalizimin e rrugëve, 3 milionë euro, për ndërtimin e urave, 12,1 milionë euro projekte për bashkëfinancim me kuvendet komunale, duke përfshirë edhe bartjen prej vitit 2009, si dhe 20,5 milionë euro si për fillim të ndërtimit të autostradës që lidh, kalon një shumë prej 50 milionë euro në vitin e ardhshëm. 6 milionë euro për shpronësimin e pronave për ndërtimin e autostradës, të cilat janë të buxhetuar në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Për më tutje mund të them se Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar infrastrukturën e nevojshme ligjore për përfshirjen e investitorëve privatë në fushën e transportit ku presim që një pjesë e konsiderueshme, mbase më e madhja e investimeve në këtë fushë të realizohet përmes partneritetit publiko- privat të formave të ndryshme të konsesionit.

Sektori i Energjisë. Investimet e deritashme në sektorin e energjisë kanë siguruar që përkundër sistemit të vjetruar energjetik të ofrohet një nivel optimal i furnizimit me

energji elektrike në vendin tonë. Me këtë buxhet janë ndarë rreth 50 milionë euro si subvencione për sektorin e energjisë

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën ministrit.

MINISTRI AHMET SHALA: Pra, siç e thashë me këtë buxhet janë ndarë edhe 50 milionë euro si subvencione për sektorin e energjisë me qëllim të sigurimit të furnizimit kualitativ me energji elektrike.

Sidoqoftë subvencionimi për import të energjisë do të zvogëlohet krahasuar me buxhetin e vitit 2009.

Edhe përkundër zhvillimeve pozitive në sektorin e energjisë në këtë drejtim të rritjes së prodhimit të energjisë dhe të shkallës së faturimit dhe inkasimit gjatë këtij viti janë bërë progrese të jashtëzakonshme.

Këto ditë tanimë janë përcaktuar edhe hapa konkret që do të ndërmerren në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike. Gjithashtu janë ndarë edhe 80 milionë euro në formë të kredisë për investime në sektorin e energjisë që përfshinë investimet e vazhdueshme në minierën Sibovcit, riparimin e ekskavatorëve e të tjerë.

Sektori i Arsimit: Në kuadër të prioritetëve të Republikës së Kosovës, siç është thënë edhe më lart, është sektori i arsimit, i cili me të drejtë konsiderohet të jetë bazë e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, pasi që ofron edukim dhe arsimim për gjeneratat e reja.

Ky projektbuxhet, në mes të tjerash, do të financojë edhe themelimin e Universitetit të Prizrenit, me një vlerë prej mbi 2 milionë euro për fillim, si dhe do të zgjerojë kapacitetin e Universitetit të Prishtinës edhe për 4000 studentë të rinj. Ne mbetemi të përkushtuar që të financojmë tërheqjen e profesorëve më kualitativ për mësimdhënie në nivelet më të larta universitare të Prishtinës dhe me këtë rast kemi ngritur edhe pagat e tyre.

Po ashtu përmes këtij buxheti do të ndahen edhe 26 milionë euro për ndërtimin e shkollave të reja, si dhe 2 milionë euro për programin e trajnimit të mësimdhënësve.

Sektori i Shëndetësisë: Buxheti i vitit 2009 ishte 66,3 milionë euro, kurse i vitit 2010 për fillim është 71,9 milionë euro ose kemi një rritje të shprehur në përqindje prej 8,4%. Është rritur financimi i programit për barëra esenciale në shumën prej 20 milionë euro ose 20% më të larta se buxheti fillestar i vitit 2009. Shpenzimet kapitale për t'i përmirësuar kushtet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës do të jenë 14% më të larta apo 5,6 milionë euro.

Vlen të theksohet edhe projekti i ri Emergjencia- Blloku operativ, në shumë prej një milionë euro, kurse punonjësit e sektorit shëndetësor do të përfitojnë shumë prej 1,5 milionë euro që janë ndarë për kompensimin e punës jashtë orarit si dhe shtesave të tjera.

Sektori i Mirëqenies Sociale: Buxheti për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2009 ishte 159 milionë 900 mijë euro, kurse për vitin 2010 është planifikuar që të jetë 173,6 milionë euro ose 8,6% më i lartë.

Rritje më e lartë në skemat pensionale dhe sociale të cilat do t'i paraqes konkretisht janë:

- Pensionet bazike të vjetërsisë 5,8 milionë ose rritje prej 10%,
- Pensionet kontributdhënës 4,9 milionë ose rritje prej 19,7%,
- Pensionet e invalidëve të luftës 1,4 milion ose rritje prej 7,1%,

Pos skemave pensionale kjo ngritje ofron mbështetje familjeve të personave të zhdukur si dhe mbështetje për invalidët e luftës. Po ashtu me këtë buxhet ne vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për familjet me asistencë sociale.

Sektori i Sigurisë dhe i Drejtësisë. Ky sektor si një nga prioritet e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të ketë mbështetjen buxhetore të konsiderueshme duke krijuar të gjitha mundësitë për funksionalizimin e plotë të këtij sektori. Do të mbështetet fuqishëm Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pastaj përmirësimin e kushteve për punë për Policinë e Kosovës, 3 milionë euro për paga shtesë në mbështetje të implementimit të Ligjit për policinë dhe skemës që i ka përgatitur Ministria e Punëve të Brendshme.

Funksionalizimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, reformimin e sistemit të Prokurorisë dhe të gjyqësisë së Kosovës, në vazhdim të mbështetjes për funksionalizimin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës e kështu me radhë.

Ky sektor pra në vitin 2010 ka një ngritje prej 14,2%, krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2009, ndërsa një ngritje të konsiderueshme e kemi bërë për Policinë e Kosovës, prej 14,6%.

Bujqësia. Një karakteristikë tjetër e këtij buxheti është mbështetja e sektorit bujqësor dhe rural duke përfshirë këtu 4,7 milionë euro subvencione për mbështetjen e bujqësisë, krahasuar me 1,5 milionë euro që ishin në vitin 2009. Një rritje e tillë për më tepër se 300%, krahasuar me një vit më parë, paraqet një hapë shumë kualitativ në drejtim të rritjes së mbështetjes së fermerëve. Dhe, duke qenë se ky sektor ka potencial të madh, por edhe duke parë efektin që ka arritur kjo masë te fermerët Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për vazhdim të mbështetjes të këtij sektori edhe në vitet e ardhshme.

Për vëmendjen tuaj deputetë të nderuar, dëshiroj të ju njoftoj se buxheti i ndarë për Ministrinë e Bujqësisë në vitin 2010 nuk përfshinë Agjencinë e Veterinarisë dhe Ushqimit, i cili ka kaluar në nivel të Kryeministritës kështu që në qoftë se krahasohet vit për vit shihni se rritja është mbi 14%.

Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme vazhdon të llobojë për njohje të reja të Kosovës përmes themelimit të përfaqësive diplomatike në qendrat më të mëdha botërore. Buxheti për vitin 2010 për këtë Ministri është 23,3 milionë euro, që krahasuar

me buxhetin e vitit 2009 ka shënuar një rënie , por duke qenë se tani më janë themeluar ambasadat dhe nuk pritet ndonjë investim kapital i madh.

Ministria për Tregti dhe Industri, do të vazhdojë që të mbështesë zhvillimin e sektorit privat, posaçërisht në zhvillimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla përmes rritjes së aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve vendore, parqeve industriale dhe promovimit të investimeve private.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë 8,8 milionë euro në vitin 2010 për investime kapitale që krahasuar me buxhetin e vitit 2009 është më i ulët për faktin se projekti i ndërtimit të parkut industrial do të përfundoj në vitin 2010- tanimë.

Gjithashtu duhet cekur që në buxhetin e vitit 2010 kjo Ministri do të përfitojë nga projekti i Bankës Botërore për punësimin e qëndrueshëm një vlerë prej 1,5 milionë euro.

Ministria, përkatësisht Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve ka paraparë një buxhet për vitin 2010 të jetë 2,2 milionë euro, që krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2009 në shumë prej 11 milionë euro paraqet një rritje të ndjeshme.

Përmes këtij buxheti do të financohet projekte kyçe në këtë lëmi siç është projekti i prezantimit të zhvillimit të trashëgimisë kulturore, zhvillimit të mëtutjeshëm të infrastrukturës sportive dhe ndërkombëtarizimit të sportit.

Zhvillimi i Planifikimit Hapësinor dhe Mbrojtja e Mjedisit. Buxheti i paraparë për këtë lëmi do të jetë 8,04 milionë euro, e që krahasuar me buxhetin e vitit 2009 në shumë prej 12 milionë euro, paraqet një zvogëlim që kryesisht vjen si rezultat i përfundimit të punëve në projektin e Hadës.

Planifikimi Hapësinor është duke u trajtuar shumë seriozisht në të gjitha komunat e Kosovës dhe kjo shihet edhe përmes hartimit dhe miratimit të planeve regullative dhe zhvillimore e urbane.

Mbrojtja e mjedisit, po ashtu është në fokus të angazhimeve tona dhe kjo do të arrihet, ndër të tjera edhe përmes përmirësimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, ndërtimit të objekteve për izolim të përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme, vendosjen e rrjetit monitorues të cilësisë së ajrit, ndërtimit të fabrikave sterilizuese për mbeturina, si dhe pastrimit dhe rregullimit të lumenjve.

Ministria e Komunitetit dhe e Kthimit, për vitin 2010 do të ketë një buxhet të paraparë prej 8,72 milionë euro, që afërsisht është e njëjtë me buxhetin e ndarë të vitit 2009. Përkrahja për minoritetet sigurohet përmes krijimit të kushteve për qëndrim dhe avancim të pozitës së tyre, përmes programeve subvencionuese dhe mbështetjeve të kthyerve përmes Ministrisë së Kthimit dhe zyrave të krijuara për minoritete në Presidencë dhe Kryeministri.

Më lejoni tani në pika të shkurtra të paraqes buxhetin komunal.

Financimi komunal nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetjake të komunave arrin afërsisht 2/4 e buxhetit të Republikës së Kosovës, përkatësisht 283 milionë euro. Ky financim u siguron komunave nivelin e duhur për ta mbështetur zhvillim ekonomik lokale dhe përmirësimin e shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të komunave të tyre.

Ndonëse buxheti komunal do të financohet në masën deri në 80% nga grandet qeveritare, përkatësisht 233 milionë euro nga niveli qendror, komunat kanë treguar përkushtim të vazhdueshëm drejt rritjes së të hyrave vetjake që planifikohen të jenë mbi 50 milionë euro.

Financimi total për komuna për vitin 2010 është 283 milionë e 210 mijë euro, grand i përgjithshëm 94,260 milionë euro, grand specifik për arsim 109 milionë e 291 mijë e 318 euro, grand specifik për shëndetësi 27 milionë e 318 mijë e 682 euro, grand specifik për shërbime sociale një milion e 930 mijë euro dhe të hyrat vetjake 50,4 milionë euro.

KRYETARI: Edhe 2 minuta t'i vazhdohet.

MINISTRI AHMET SHALA: Përmes financimit Qeveria planifikon t'i ofrojë mbështetje të fuqishme për prioritetet e saj në sektorin e arsimit para universitar, arsimit pa rafillor, fillor dhe i mesëm. Njëkohësisht grand i shëndetësi do të ofrojë mbështetje për zhvillimin e shëndetësisë primare, me qëllim të promovimit të standardeve të përmirësuara, financimin për shërbimet arsimore dhe aspekte të tjera zhvillimore.

Të nderuar deputetë,

Si ministër për Ekonomi dhe Financa ju rekomandoj që ta aprovoni këtë buxhet dhe kërkoj mbështetjen nga të gjithë ju, në mënyrë që të marrim hapa të rëndësishëm drejt zhvillimit ekonomik të Kosovës. Investimet e bëra gjatë këtij viti dhe ato të planifikuara për vitin 2010, në infrastrukturë dhe në projekte tjera kapitale janë një fundament i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik si çdoherë që është në funksion të mirëqenies së qytetarëve.

Po ashtu siç e theksova edhe më lart aprovimi i këtij buxheti hap dyert drejt përfitimit të mbi 210 milionë euro nga donatorët që besoj se pas vulosjes nëse mund të them në parim të këtij buxheti nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore kanë dhënë sinjale se do të mbështesin fondet 150 plus 60 milionë euro që do të derdhen gjatë viteve në vijim.

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe duke ju uruar që sot pas analizave të thukëta të mbështetnin këtë buxhet, ju falënderoj edhe një herë për vëmendje! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Radhën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, më 18 nëntor ka shqyrtuar në parim Projektbuxhetin për vitin 2010 të Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që këtë projektbuxhet ta miratojë në parim. Dua të theksoj këtë fakt se në Komisionin për Buxhet dhe Financa, pjesa e opozitës është dakorduar që të shqyrtohet në Kuvend, por të mos miratohet në parim, ndërsa shumica e Komisionit ka prurë vendimin se ky projektbuxhet do të duhej të miratohej në parim me qëllim të përmirësimit në fazat e procedimit të mëtejshëm të buxhetit.

Komisioni po ashtu ka konstatuar se të katër prioritetet themelore të parashtruara të Qeverisë janë të reflektuara në kuptimin e përgjithshëm në ndarjet buxhetore dhe po ashtu Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar dhe kërkon edhe këtu në këtë seancë që vërtet gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të shikohen vërtet pozicionet e disa agjencioneve buxhetore dhe të harmonizohen me shpenzimet ose me dinamikën e shpenzimeve të bëra për vitin 2009, në mënyrë se nga ajo që tha edhe ministri kemi shumë agjenci buxhetore që në këtë vit kanë një buxhet ose një kërkesë më të shtuar, ndërsa në realizimin e buxhetit për vitin 2009 janë shumë mbrapa dhe në këtë mënyrë Komisioni konsideron se do të duhej për të mos thënë sanksionohen po të vihet bllokada buxhetore dhe të nxiten që ajo që projektohet dhe të realizohet në shkallën dinamikën e vet të projektuar.

Një çështje që po ballafaqohet po them, që është shumë esenciale Komisioni për Buxhet dhe Financa është çështja lidhur me agjencitë e pavarura ose me rregullatorët ekonomikë, që në këtë projektbuxhet sikur janë bërë disa shkurtime, arsyetime të cilave do të duhej t'i dëgjoni nga ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe që këto shkurtime pengojnë realizimin dhe ushtrimin e funksionit të tyre në vitin 2010. E kam fjalën për Autoritetin Rregullativ të Telekomunikacionit, pastaj të Komisionit të Pavarur për Media, Komisionit për Miniera dhe Minerale dhe disa agjencioneve tjera që në këtë fazë ne kemi mjaftë kërkesa të tyre që buxhetet e tyre të miratohen dhe të realizohen në shkallën që ata kanë kërkuar, dhe jo të mos bëhen ato shkurtime që janë bërë me këtë projektbuxhet.

Ne sigurisht do të kemi gjatë fazës së shqyrtimit dhe të amendamentimit të këtij projektbuxheti, do të gjejmë forma dhe mundësi që të plotësohen kërkesat e arsyeshme të gjitha agjencioneve rregullative edhe ashtu ne jemi deklaruar rreth pavarësisë buxhetore të tyre.

Dhe një çështje tjetër që ndoshta buxheti deri më tani nuk është marrë, është çështja e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës, ju e dini që është krijuar një gjendje ndoshta jo e këndshme rreth financave të qëndrueshme të Radiotelevizionit të Kosovës. Prandaj, Qeveria në këtë rast do të duhej të kishte një projekt rreth daljes nga kjo gjendje në një farë mënyre të bllokimit të financimit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe zhblokimit në forma të ndryshme në forma të mundshme që do të mund të krijonin ushtrimin dhe funksionimin e mirëfilltë të këtij mediumi publikë.

Këto janë për fillim, zoti Kryetar, e ruaj të drejtën të flas si deputet në pjesën tjetër të debatit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Unë jam i obliguar t'ju njoftoj që deri më tani janë paraqitur për debat 38 deputetë. Nëse jeni dakord unë kisha shkua për shefat e grupeve parlamentare nga 10 minuta, deputetët nga 5 minuta. Unë po e hedh në votim ju votoni, vendimi është i juaj, por unë po ju tregoj që janë, bile tani janë 45 deputetë të lajmëruar për diskutim.

Atëherë shkojmë në votim. Kush është që përveç shefave të grupeve që i kanë nga 10 minuta deputetët t'i kanë për diskutim nga 5 minuta. Sekretaria. Faleminderit! Kush është “kundër” Faleminderit!

Konstatoj se me 53 janë “për”, 20 janë “kundër”, në sallë janë 85 deputetë. Do të thotë votuat që diskutimet të jenë 5 minuta. Mendoj që 5 minuta, nëse diskutimet janë racionale janë të mjaftueshme për t'i thënë gjithë atë që duhet thënë.

Vazhdojmë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: I nderuar zoti Kryetar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Nëse analizojmë me kujdes Projektbuxhetin vërejmë se është bërë një punë shumë serioze nga ana e Ministrisë së Financave dhe e ministrive të tjera në përgatitjen e këtij projekti në tërësi dhe mund të themi se është buxheti që më së miri është përgatitur ndonjëherë.

Projektbuxheti i vitit 2010 është buxhet me transparencë të duhur, qoftë në planifikimin e shpenzimeve, qoftë në planifikimin e të ardhurave. Është shumë e rëndësishme se rrjedha e përgatitjes së këtij buxheti nuk i është shmangur debatit publik. Është debatuar dhe miratuar korniza afatmesme e shpenzimeve në Kuvend që i ka paraprirë këtij dokumenti dhe është shumë e rëndësishme që ky projektbuxhet shoqërohet me parametra makroekonomik në bazë të cilëve është konstruktuar strukturat e të hyrave buxhetore.

Projektbuxheti që na është ofruar në shqyrtim është i harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtarë, është një dokument i rëndësishëm që i përmbush obligimet që Qeveria i ka vu vetes për rritje ekonomike, qeverisje të mirë, zbutje të varfërisë, për fuqizim të institucioneve, për përmirësimin e gjendjes në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, në bujqësi e të tjera.

Të nderuar deputetë,

Të hyrat buxhetore të projektuara për vitin 2010 janë një miliard e 29 milionë euro, apo 7.5% më të larta krahasuar në vitin 2009, duke arritur kështu 23.9% të bruto produktit vendor.

Të hyrat nga dogana parashihen të rriten për 38.5 milionë edhe përkundër krizës globale që mbizotëron në mbarë botën.

Kurse të hyrat vendore rriten për 35 milionë dhe kjo vjen si rezultat i vlerësimit për rritjen ekonomike mbi 4% dhe si rezultat i ngritjes së efikasitetit të Administratës Tatimore të Kosovës në grumbullimin e të hyrave, nxitjen e investimeve dhe zgjerimin e bazës së tatimit duke zvogëluar ekonominë informate dhe evazionin fiskal.

Nëse i analizojmë me një qasje objektive shifrat vërejmë se janë ulur shpenzimet operative dhe mjetet janë përqendruar në projekte të rëndësishme kapitale.

Shpenzimet e përgjithshme të planifikuara buxhetore janë një miliard e 146 milionë, ku prej tyre 25% shkojnë në paga e mëdijve, 17% në mallra dhe shërbime, 21% në subvencione, kurse pjesa më e madhe e mjeteve ndahet për investime kapitale, 400.5 milionë euro apo 34% të buxhetit, që paraqet një rritje 3%, krahasuar me vitin 2009.

Rritja e investimeve kapitale në vitin 2008 dhe në vitin 2009 dhe parashikimi për rritje edhe në vitet në vijim i hap rrugë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Krijimi i institucioneve të reja, ngritja e pagave të policisë në përputhje me gradat e tyre si dhe rritja e pagave të punonjësve të shëndetësisë, si dhe pagesa e tyre për punën shtesë, ka bërë që kategoria e pagave dhe mëdijve të rritet për 7%, në krahasim me vitin 2009.

Në kategorinë në mallra dhe shërbime vërejmë se në të gjitha ministritë ka shkurtime të shpenzimeve administrative, në përgjithësi për 2%, në krahasim me vitin 2009, me qëllim të rritjes së shpenzimeve kapitale ku përfitojnë qytetarët, nxitet zhvillimi ekonomik dhe rritja e punësimit.

Grupi Parlamentar i partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se vota pro e këtij buxheti është votë për ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, është votë për ngritjen e nivelit të pagesave për kategorinë e invalidëve të luftës, për mbështetjen e familjeve të personave të pagjetur, si dhe përkrahje pensionistëve dhe shtresave sociale, sepse këtë projektbuxhet e karakterizon rritja e transfereve sociale dhe ulja e subvencioneve për 8%, krahasuar me vitin 2009 për ndërmarrjet publike.

Vota pro e këtij buxheti është votë për fuqizimin e shtetit, votë- rritje ekonomike e shoqëruar me ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, eliminimin e barrierave administrative, ofrimin e lehtësirave për biznes me zonat industriale për të cilat janë paraparë 2 milionë e 493 mijë euro dhe lehtësirave fiskale, eliminimin e informalitetit në ekonomi që mundësojnë thithjen e investimeve të jashtme, stimulimin e prodhimit vendor me destinim eksportin, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e bilancit të tregtisë së jashtme.

Vota pro e këtij buxheti është votë për ndërtimin dhe renovimin e 73 shkollave të mesme dhe fillore për çka janë ndarë 24.7 milionë euro, për shtimin e kapaciteteve të Universitetit të Prishtinës për 4000 studentë, për përmirësimin e cilësisë së arsimit, për kompjuterizimin e shkollave dhe për ndërtimin e Universitetit të dytë publik të Prizrenit, për të cilën janë paraparë 2 milionë euro.

Vota pro këtij buxheti është votë për reforma në sistemin shëndetësor, për sigurimin e shërbimeve shëndetësore, ku në fokus parashihen të jenë pacientët dhe kostoja e shërimit të tyre. Vetëm për furnizim me barëra janë planifikuar afër 20 milionë euro, për përmirësimin e kushteve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë ndarë 5,6 milionë euro apo 14% më shumë se në vitin e kaluar. Kurse spitalet regjionale, institutet dhe përkujdesi primar shëndetësor përfitojnë 5.5 milionë euro për investime kapitale. Punonjësit shëndetësorë do të përfitojnë edhe 1.5 milion euro që janë ndarë për kompensimin e punës jashtë orarit dhe shtesave të tjera.

Vota pro e këtij buxheti është votë për t'i përmirësuar politikat bujqësore, sepse ky projektbuxhet jep mbështetje sektorit rural duke përfshirë këtu 4.5 milionë euro subvencione që kryesisht mbështesin fermerët, krahasuar me 1.5 milionë euro sa ka qenë në vitin 2009.

Me këtë buxhet vazhdohet me rehabilitimin e sistemit të ujitjes ku janë planifikuar 2 milionë euro, që reflekton në realizimin e objektivit që të gjitha tokat bujqësore të futen në sistemin e ujitjes, që do të ndikoj në rritjen e rendimenteve bujqësore.

Vota pro këtij buxheti do të thotë të garantohet mbështetje fuqishme financiare për Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Vota pro e këtij buxheti është votë për shpërndarjen e njëtrajtshme të investimeve në të gjitha komunat. Është rritur dukshëm buxheti i komunave nga 253 milionë euro sa ka qenë në vitin 2009, në 283 milionë euro ku vetëm për investime kapitale janë planifikuar 109 milionë euro apo 24.5 milionë euro më shumë se në vitin 2009.

Nga ky material vërehet se Qeveria është e gatshme për të investuar në projekte ku përfiton taksapaguesi, ku rritet mirëqenia dhe hapet perspektiva e qytetarit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah projektbuxhetin duke i mundësuar Qeverisë t'i realizojë objektivat e saj në thellimin e reformave për zhvillim dhe për integrimin e shtetit të Kosovës. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e donë fjalën, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: I nderuar Kryetar i Parlamentit të Kosovës,
Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush vlerësimin tim në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës për përmbledhjen e buxhetit të vitit 2010.

Jam i bindur se ky buxhet përfaqëson një hap të rëndësishëm në progresin fiskal, ekonomik të Kosovës. Përkundër vlerësimit të përgjithshëm për procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2010, mendoj se respektimi i orarit buxhetor duhet avancuar më shumë me qëllim që deputetët dhe të gjitha komisionet e Kuvendit të kanë më tepër kohë për diskutim që njëkohësisht do të mundësohet që procesi buxhetor të jetë më transparent dhe më i kuptueshëm.

Buxheti për vitin 2010 bazohet në mundësitë reale ekonomike dhe përmban disa elemente pozitive, parashikimet makroekonomike që mbështeten te indikatorët makroekonomik të cilët janë harmonizuar dhe me faktorë të rëndësishëm financiar. Buxheti i vitit 2010 bën ndërlidhjen e procesit të planifikimit të buxhetit në serinë e prioritetëve të larta të Qeverisë për realizimin e synimeve të saja, sidomos në zhvillimin e infrastrukturës rrugore që është prioritet në tri buxhete radhas e që mendohet të ndikojnë në përkrahjen e sektorit privat, në rritjen ekonomike, si dhe mbajtjen stabile të pozicioneve që kanë të bëjnë me politikat sociale.

Buxheti i vitit 2010 bazohet mbi sistemin e parave të gatshme, i cili sistem mundëson një menaxhim më efikas të shpenzimeve publike dhe njëkohësisht është një disiplinë më e madhe fiskale.

Ky buxhet parasheh të sigurohet jo përmes rritjeve të tatimeve më të larta, por përmes përmirësimit të mbledhjeve të hyrave për të cilat është siguruar paraprakisht infrastrukturë e mirë ligjore.

Po ashtu vërehen se gjatë hartimit të këtij projektligji janë shfrytëzuar politika dhe standarde të mira. Sipas projektligjit të propozuar të hyrat buxhetore për vitin 2010 do të jenë një miliard e 29 milionë e 200 mijë euro, që siguron një balancë të hyrave dhe shpenzimeve me një deficit prej 117.4 milionë euro.

Buxheti i autorizuar i shpenzimeve është një miliard e 146 milionë e 600 mijë euro, ndërsa shumat tjera janë jashtë buxhetore. Kjo shumë do të sigurojë mbështetjen për aktivitete të rëndësishme të institucioneve për zhvillimin e Kosovës në të gjitha fushat e saj këtu përfshirë edhe decentralizimin dhe formimin e komunave të reja.

Megjithatë përveç fakteve pozitive të lartpërmendura duhet theksuar edhe disa aspekte të tjera të rëndësishme për buxhetin e Kosovës.

Sa i përket buxhetit të planifikuar për vitin 2010 nuk kemi ndonjë rritje buxhetore dhe na paraqitet deficit i ndjeshëm. Të hyrat më të mëdha buxhetore janë edhe më tutje nga doganat, përafërsisht 70%, ndërsa 30% janë të hyra të brendshme. Kjo tregon se duhet edhe më shumë të punohet në realizimin e inkasimit të taksave dhe tatimeve të parapara në ligjet në fuqi. Prandaj Qeveria duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim duke hartuar

politika më të mira dhe strategji të nevojshme për të ndërmarrë veprime me të cilat do të ndryshohet ky raport i të hyrave.

Totali i shpenzimeve buxhetore për vitin 2010 është i pranueshëm, ndërsa është diskutabile buxheti për 2011 dhe 2012, sepse na sjellin në suficit primar shumë të lartë që mund të ndikojë në keqësimin e situatës fiskale dhe buxhetore për periudhën afatmesme.

Edhe për vitin 2008 edhe atë 2009 e shoh nga Qeveria se do të ketë mbështetje buxhetore mbi 100 milionë euro, kjo nuk ka ndodhur dhe Parlamenti duhet të ketë një përgjigje pse kjo nuk ka ndodh, ndërsa parashikimet e Qeverisë për 2010, 2011, 2012, që do të mbështeten nga 70 milionë për secilin vit, përkatësisht 210 milionë për tri vjet ka krijuar përshtypjen se po krijohet një buxhet mbi bazën e supozimeve joreale.

Struktura e buxhetit është ndryshuar dhe ky buxhet do të jetë më pak zhvillimor se ai i vitit 2009, arsyeja është se janë zvogëluar investimet kapitale për 70 milionë euro.

Logjika e planifikimit në këtë buxhet për shpenzime në projekte kapitale është që projektet që mund dhe duhet të përfundojnë brenda afatit njëvjeçar ato janë parcializuar dhe janë planifikua për tri vjet, që nënkupton paraprakisht politikë sektoriale për ndarje buxhetore.

Kthimi i kredisë së KEK-ut në shumë prej 167 milionëve nuk figuron fare në buxhet. Në aspektin ligjor ajo ende trajtohet si kredi aktive se nuk është marrë ende asnjë vendim për shlyerjen e asaj, të këtij borxhi. Përveç kësaj çështja me KEK-un është një problem që po na përsëritet vazhdimisht, ndarja e fondit për importin e energjisë mund të kuptohet edhe si një pengesë e përshpejtimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike për interesat e dyshimta.

Pozicioni i rezervës në shumë prej 200 milionë euro nuk duhet të figurojë fare në buxhet, sepse nuk është pjesë e autorizimit të shpenzimeve. Kjo na paraqitet vazhdimisht si bartje dhe krijon një përshtypje, domethënë një mashtrim optik në buxhet.

Është shqetësuese skema sociale, sepse nuk tregon se do të ketë rritje të pensioneve e as të skemës për raste sociale përpos që do të ketë një rritje të ndjeshme për invalidët e luftës, ndërsa sa u përket pagave, Qeveria nuk ka një politikë të qëndrueshme dhe nuk ka paraparë të financojë koston e plotë të Ligjit për shërbime civile, ashtu siç nuk ka paraparë të financojë edhe Ligjin për kryeqytetin, gjegjësisht për Prishtinën, që është e paraparë edhe me Kushtetutën e Kosovës dhe kjo do të jetë një pengesë serioze për aprovimin e këtij ligji në tërësi.

Pajtohem që të ndodhë procesi i privatizimit sa më parë në formën e duhur, por kërkoj, që paratë e privatizimit të mos përdoren për shpenzimet e rregullta, e më së paku të vazhdueshme buxhetore dhe kërkoj që për këto mjete të vendos Parlamenti i Kosovës për përdorimin në projekte nacionale. Ndërsa, Qeveria, duhet të marrë masat e nevojshme për të gjitha mjetet e lira, të cilat nuk qarkullojnë në Kosovë, por mbahen

në formë të depozitave apo letrave me vlerë në Bankën Qendrore ose në bankat jashtë Kosovës.

Mjetet e buxhetit, mjetet e Trustit Pensional, mjetet e privatizimit e tjera që këto duhet të jenë në shërbim të ekonomisë së Kosovës, që do të ndikojë edhe në rritjen e buxhetit. Pajtohem që infrastruktura rrugore dhe ajo e arsimit të jenë prioritet për Qeverinë, mirëpo për momentin mendoj se dy fusha të cilat duhet t'i kushtohet shumë më shumë vëmendje janë ato e sektorit të sundimit të ligjit dhe politikës së jashtme, sepse të gjitha raportet, veçanërisht raporti i progresit dhe raporti i BE-së, kërkojnë nga ne që ky sektor të avancohet për t'u krijuar një ambient i volitshëm për investime. Pa u forcuar ky sektor, nuk mund të luftohet as korrupsioni, as krimi ekonomik, asnjë dukuri tjetër negative.

Ministria e Punëve të Jashtme, ka nevojë për një shtrirje më të madhe të ambasadave për lobime për njohje të reja si dhe për lobimin që është shumë me rëndësi për lobime, për investime të jashtme që janë të domosdoshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të Kosovës.

Unë, do të dëshiroja që Qeveria të jetë e bindur se ky buxhet është që i përket të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mbi bazën e kësaj, të kemi një buxhet aq sa është e mundur proporcional të shtrirë në gjithë Kosovën. Kjo nuk ka ndodhur, veçanërisht në dy ministri që kanë shuma më të mëdha të investimeve kapitale, fjala është për Ministrinë e Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit dhe për Ministrinë e Arsimit.

Projektligji i buxhetit për vitin fiskal 2010 përkrahet në parim dhe në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, kërkoj që të vihet vëmendje në disa nene, sidomos në nenin 5, alinea 7.1...

KRYETARI: Mirë, vazhdo edhe 1 minutë.

... me ligjin bazë. Neni 11, alinea 11.2 duhet të përmirësohet sa i përket përqindjeve të avanseve, sidomos për muajin nëntor dhe muajin dhjetor.

Neni 12, alinea 12.6 ose duhet të gjendet një çelës që e ruan strukturën, ose duhet të hiqet krejt ky fond ose eventualisht të zvogëlohet sa më pak. Fjala është për fondin që ndajnë ministrinë për komuna.

Alinea 12.8, duhet të riformulohet dhe nuk mundet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të marrë obligime ligjore ndaj KEK-ut.

Neni 14, alinea 14.6, ka të bëjë me autonominë financiare të komunave. Këtu duhet të bëhet një ndërhyrje si dhe alinea 15.4 që ka të bëjë me një planifikim të dobët, sepse qysh tash paralajmërohet se do të ketë, që do të ndodhë rishikimi. Ju falënderoj për vëmendjen që keni pasur!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet! Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Diskutimin për buxhetin 2010 e vështirësojnë dy çështje që janë të pranishme në këto ditë. E para, mungesa e raportit nëntëmujor të buxhetit për vitin 2009, si material që do të shërbente paraprakisht si bazë për të diskutuar vitin 2010 dhe e dyta, mungesa e diskutimit të këtij dokumenti në Komisionin për Buxhet dhe mungesa po ashtu e pranisë së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në ditën kur ka qenë në rend dite dokumenti i buxhetit për vitin 2010 në Komisionin për Buxhet.

Grupi Parlamentar i Aleancës e respekton korrektësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet, kur thotë se një pjesë e anëtarëve të Komisionit për Buxhet nuk e kanë mbështetur, për mbështetje në parim këtë dokument, sepse ky dokument në fakt nuk është diskutuar fare në Komisionin për Buxhet, as nuk ka qenë kurrkush i pranishëm, as ministri as zyrtarët e lartë të Ministrisë në ditën kur ka qenë në rend dite ky material. Sido që të jetë, na konsiderojmë që pjesa tekstuale e këtij dokumenti, pra e Ligjit për buxhetin 2010, me përjashtim të nenit 12.8 në parim është e pranueshme me ndonjë ndërhyrje të vogël, mund të rregullohet.

Te pjesa tabelare, tabela numër 1 të hyrat, ka një pështjellim të dhënave dhe një humbje gjurme e një shume të madhe parash publike. Më duhet të kthehem te raporti 2008 për të ardhur te shifra në të cilën po mendoj që është megjulluar.

Sipas raportit të vitit 2008, të dhënat në bilancin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës, nuk përputhen me të dhënat në tabelën 1 të këtij dokumenti që po e diskutojmë sot. Po ashtu, të dhënat që na i jap auditori gjeneral për fundin e vitit 2008, bilanci në buxhetin e konsoliduar të Kosovës ishte 469 milionë e 80 mijë euro e jo 414 mijë euro, siç paraqitet në këtë pasqyrë të këtij dokumenti. Pra, ndryshimi vetëm në këtë pikë është për 54 milionë e 980 mijë euro. Këto mjete janë bartur në buxhetin e vitit 2009, por jo shuma prej 54 milion 980 mijë euro.

Po të bazohemi në buxhetin e aprovuar me rishikim, gjithsej mjetet në disponim, në këtë vit do të ishin 1 miliard e 625 milionë e 680 mijë euro, pra, bashkë me të hyrat vijuese të këtij viti. Kur kësaj shume i zbriten shpenzimet totale të cilat bashkë me rezervën, kapin një shumë prej 1 miliard e 63 milionë plus 21 milionë, disa pagesa borxhe të jashtme, plus 200 milionë rezerva, diferenca duhet të jetë, jo 172 milion e 400 mijë euro, siç është në tabelën numër 1, por është 320 milionë e 680 mijë euro. Varianti sipas auditorit gjeneral ose sipas raportit të Ministrisë së Financave, do të ishte 265 milionë. Pra, ose 94 milionë janë humbur ose 148 milionë janë zhdukur dika dhe nuk futen në mjetet e bartura në vitin 2010. Cila prej këtyre tri shifrave që vetë Ministria i ofron ose auditori gjeneral, është e vërtetë? Pa e sqaruar këtë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do ta votojë këtë dokument, sepse, atëherë mund të bëhet pjesë e një keqpërdorimi kaq të madh të parasë publike.

Po ashtu, të dhënat në tabelën 1 për vitin 2009, nuk janë shifra zyrtare të buxhetit të aprovuar me rishikim. Shikoni, janë bërë disa shifra sipas dëshirës këtu. Nëse është vlerësim i shpenzimeve deri në fund të vitit 2009, këtu thuhet vlerësim- jo aktuale, sepse aktuale është buxheti i aprovuar zyrtarisht në këtë Kuvend.

Të hyrat e projektuara për vitin 2010, pa i llogaritur të hyrat e njëhershme janë 7.6% më të mëdha se sa në vitin 2009 dhe 9.2% më të mëdha se sa në vitin 2008, që do të thotë për tri vjet kemi rritje vetëm 9.2%. T'ju përkujtoj se në mandatin e kaluar për tri vjet kemi pasur rritje prej 100%. Kjo rritje është një inercion i përcjelljes së rritjes së bruto- produktit vendor dhe nuk ka asnjë ndryshim në pengimin e qarkullimit të mallrave të kontrabanduara, siç është nafta e cila hyn në pikat 1 dhe 31 dhe depërton të shitet në të gjitha pikat e karburanteve, bile, bile deri në Han të Elezit. Kemi apeluar shumë herë për mbrojtjen e doganave dhe të Administratës Tatimore nga përzierja e jashtme në punët e këtyre dy institucioneve, por si duket kjo është institucionalizuar dhe prandaj nuk mund të presim rritje më dinamike të hyrave buxhetore.

Shpenzimet në total kapin shumë prej 1 miliard e 146 milionë e 600 mijë euro. Po e përsëris, kufijtë e shpenzimeve nuk janë siç i prezantoj, zoti Kryeministri dhe ministri i Financave 1 miliard e 461 milionë, por 1 miliardë e 146 milionë, që do të thotë janë shumë më të ulëta, sepse rezerva e projektuar nuk hyn në kufijtë e shpenzimeve të projektuara.

Nëse këtu e përfshijmë edhe shifrën 200 milionë, prapëseprapë kemi një shpërputhje të këtij kufirit të proklamuar dhe ndryshimin me atë çka shkruan në buxhet.

Me këtë projektbuxhet është paraparë një ndryshim në mes të hyrave dhe shpenzimeve që mbulohet nga një mbështetje buxhetore e jashtme. Përgjithësisht kufijtë e shpenzimeve në vitin 2010, propozohen të jenë më të ulët se sa të buxhetit të rishikuar për 4.7%, pra kemi zvogëlim të kufijve të shpenzimeve në krahasim me këtë vit, ose për 56 milionë e 700 mijë euro. Jo vetëm zvogëlim, por kemi përkeqësim të strukturës së buxhetit pasi që pagat rriten 6%, kurse investimet kapitale zvogëlohen për 15% në krahasim me këtë vit, nga 450 milionë në 400 milionë. Edhe këtë vit vazhdon subvencionimi i ndërmarrjeve publike, importi i energjisë e tjera. Edhe në pjesën e shpenzimeve, kemi gabime materiale në tabela ose mospërputhje të dhënave. Shihni tabelën nr. 2, totali dhe tabelën nr. 1. Tash mos të humb kohë e keni materialin përpara.

Po ashtu, në këtë dokument që është pjesë e një plani zhvillimor trevjeçar, nuk janë respektuar prioritetet e proklamuar nga vetë Qeveria, kurse nga prezantimi u tha që po respektohen ato. Kështu buxheti i është zvogëluar, pjesa për investime, po flas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë të Postë-Telekomunikacionit, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Energjetikës dhe të Minerave, Ministrisë së Drejtësisë e tjera. Siç shihet, Qeveria nuk dëshiron të mbështetë materialisht sektorët të cilët vetë i ka përcaktuar prioritar, siç janë: rritja ekonomike, infrastruktura ekonomike, energjia, sundimi i ligjit, arsimi, bujqësia dhe prioritetet tjera si qeverisja e mirë dhe stabiliteti social.

Zoti Kryeministër, më vjen keq që nuk është këtu, por, megjithatë është kthyer, por qenka habitur, profesorëve të Universitetit ju keni premtuar rritje pagash deri në 1000 euro. Me këtë buxhet që keni propozuar, paga mesatare në Universitetin e Prishtinës është bruto 392 euro. Pjesa e të ardhurave që ata e realizojnë nga të hyrat vetjake ka qenë një e drejtë që ka filluar të realizohet që nga viti 2007 dhe është e drejtë e tyre. Ndoshta, ky premtim është një lloj shakaje e ngjashme me një prillin para zgjedhjeve, por me dokumentin e buxhetit 2010 kemi përkeqësuar ose një stagnim në këtë drejtim edhe për punëtorët e Qendrës Klinike Universitare, për të cilët është paraparë paga bruto mesatare 260 euro për vitin 2010, për gjyqtarët 295 euro, bruto, për pjesëtarët Forcës së Sigurisë, 243 euro dhe për Policinë e Kosovës, 330 euro bruto.

Në qoftë se kishin për t' u gjetur ato shumat që i përmenda në fillim rreth 150 milionë euro që janë megjulluar, do të thotë, mund të zgjidhshim problemet ashtu edhe siç është dëshiruar të zgjidhen, por këtu kemi një shmangie nga kjo sepse para...

KRYETARI: Haki, a e do një minutë fjalën? Mirë, regjia edhe 1 minutë deputetit Haki Shatrit, përkatësisht dy minuta.

HAKI SHATRI: Në këtë dokument ka edhe disa shpërputhje tjera që t'i bie shkurt, kemi shpërputhje në veçanti të pjesa e investimeve kapitale, projektet kapitale që janë paraparë në realizim në disa komuna, ekskluzivisht janë paraparë për komunat ku pushtetin e ka vetëm PDK-ja. Po me vjen keq që po bie në këtë nivel e po e them, por është fakt që shkruan në tabelën numër 31 dhe kjo shihet dhe mund të shihet nga çdo lexues i rëndomtë. Mund të them që ka edhe probleme tjera, për shembull 47 projekte kapitale nga Ministria e Arsimit komplet barten në vitin 2010, rreth 20 tjera që janë futur, janë futur në një vijë lineare shumë pa pid kod, pa asnjë përgatitje tjetër të domosdoshme për t'u renditur në këtë dokument që është shumë me rëndësi. Prandaj, duke u nisur nga tërë këto vërejtje, Grupi Parlamentar i Aleancës, përkundër vullnetit të tij për ta shtyrë këtë dokument përpara si shumë të rëndësishëm, nuk mund të bëhet pjesë nëse e voton e atyre që thjesht mund të quhen manipulim dhe malverzim me paranë publike. Nëse jepen sqarime, atëherë ne mund të vazhdojmë në bashkëpunim deri në finalizim të këtij dokumenti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet Shatri! Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar,

I nderuari Kryeministër,

Ministra të nderuar,

Të nderuar kolegë,

Do të doja në fillim ta përgëzoj Ministrinë që së paku një dokument teknikisht e ka ofruar të mirë, sepse në të kaluarën kemi pasur problem për ta lexuar edhe po iu kam lakmi edhe Kryeministrit dhe Ministrit për këtë optimizëm që e thanë dhe po dua me i pyetur nëse para vetes kanë një dokument tjetër, sepse ajo të cilën po e thënë këta edhe

ajo të cilën po e shohim në këtë dokument, janë krejt larg njëra tjetrës, aq larg sa që është vështirë për ta perceptuar.

Unë në fillim do të them që Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk do ta mbështetë këtë projektbuxhet, jo për shkak se ne jemi kundër buxhetit, por për shkak se konsiderojmë se ky projektbuxhet nuk garanton zhvillim ekonomik të vendit, ajo të cilën u tha deri më tash. Së pari buxheti është zvogëluar në pjesën zhvillimore dhe kjo dëshmon se Qeveria në vend që të shënoj shkallë të rritjes në pjesën zhvillimore në krahasim me vitin paraprak, ajo e zvogëlon dukshëm këtë. Në secilin sektor ka zvogëlim të investimeve kapitale dhe nuk di se si pra mund të jetë buxhet për zhvillim ashtu sikur u tha edhe nga ministri edhe nga Kryeministri.

Buxheti nuk është ndarë sipas prioriteteve, çka tregon se koalicioni qeveritar edhe më tutje nuk ka një strategji të zhvillimit të vendit. Projektbuxheti nuk ka ose ka më mirë të them ndarje jo proporcionale nëpër komuna me çka Qeveria edhe e prishë balancën në mes të komunave dhe nëpër ministri.

Në këtë projektbuxhet keni vazhdim kryesisht të projekteve ekzistuese dhe nëse shikohet mirë një shkolle për t'u përfunduar po i duhen një tri, katër ose 5 vjet. Dhe, nuk konsiderojmë se problemet në arsim zgjidhen vetëm me ndërtimin e objekteve shkollore, sepse disa prej atyre të cilat janë ndërtuar dhe madje kanë kushtuar mjaft shumë, kanë nga katër, pesë ose gjashtë nxënës, nuk kanë më tepër.

Një vërejtje që e kemi në këtë projektbuxhet është, sepse agjencive që i përgjigjen drejtpërdrejtë Kuvendit, Qeveria nuk mund t'ua përcaktojë buxhetin, ajo mund të rekomandojë, por nuk mund të vendos, sepse ky është në autoritetin e Kuvendit, nuk mund të ndërhyjë në përgjegjësitë dhe obligimet e Kuvendit.

U tha edhe për rezervën që është paraqitur këtu dhe nuk mund të paraqitet, sepse nuk hyn si shpenzim të kësaj. Struktura e buxhetit duhet të përmirësohet dhe të jetë më e mirë. Unë besoj që edhe kolegët e mi të grupit parlamentar do t'i kenë vërejtjet e veta, por si grup parlamentar nuk e mbështesim këtë projektbuxhet si tillë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, shefi i Grupit, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari do të ishte mirë që këtë ekspozitë që e dëgjuam sot prej Qeverisë, Qeveria ta ketë të qartë atë çka ka thënë para një viti, dhe nëse e marrim transkriptin e seancës plenare kur është bërë ekspozimi i Projektbuxhetit për vitin 2009, mund të vijmë në përfundim se çka ka ndryshuar. Jemi në të njëjtën pikë dhe nuk ka lëvizje nga ajo çka është premtuar para një viti.

Dua të theksoj me këtë se Qeveria nuk e ka përmbushur obligimin me këtë rast dhe detyrimet kryesore sa i përket prezantimit të këtij projektbuxheti, u tha nga parafolësit, kishte qenë e rrugës që ta kemi përpara edhe një raport të shpenzimeve nëntëmujore, por

ajo çka është esenciale për deputetët e Kuvendit të Kosovës, t'i kemi sqarimet shitesë që në vend të kësaj, është ofruar shifra para opinionit dhe që është shumë vështirë të kalkulojen.

Me këtë projektbuxhet, qytetarët e Kosovës duhet ta kenë një gjë të qartë se kemi ngelur në të njëjtin pozicion aty ku kemi qenë para një viti, përjashtojmë hyrat e njëhershme kur kanë qenë nga Posta, dividendë e PTK-së, dhe çka mund të vijmë në përfundim se të ardhurat për vitin 2010, do të jenë po ato të ardhura që janë realizuar në vitin 2009. Kjo dëshmon se mungojnë kapacitetet qeverisëse, mungon aftësia e kësaj qeverisje për t'i mbledhur taksat dhe për ta luftuar ekonominë informale. Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore, ekonomia informale në Kosovë kalon shifrën 35%. Prandaj, krejt kjo pse e kemi këtë gjendje, e kemi si rezultat i mungesës së politikave efikase të Qeverisë se të krijojnë një mjedis të shëndoshë. Është tejet shqetësuese prej krejt asaj çka u tha edhe nga parafolësit, mendimin që e përcjell këtë Qeveri dhe këtë projektbuxhet, sikur se këto janë mundësitë e Kosovës për të krijuar këtë buxhet. Dhe, ne themi jo, sepse mundësitë e Kosovës janë shumë më të mëdha për të realizuar të hyrat dhe për të krijuar buxhet funksional.

Kryeministri i Kosovës, por edhe Qeveria e kanë të qartë se sot mjetet e Kosovës flenë jashtë Kosovës, mjetet e Trustit Pensional, mjetet e privatizimit, ndërsa në anën tjetër Qeveria nuk ka dhënë asnjë shenjë të kuptojë se ka ndonjë plan për të mobilizuar këtë kapital në favor të burimeve ekonomike. Normalisht, se për ta bërë një gjë të tillë, kërkojnë vizion dhe politika efikase, por edhe guxim.

Ministri i Financave, në ekspozitën e tij, por edhe në materialin që e kemi përpara thotë se investimet private do të shtohen në mënyrë të qëndrueshme si rezultat i krijimit të një mjedisi të favorshëm që është krijuar në Kosovë për zhvillimin e biznesit. Zotëri, ministër duhet ta ketë një gjë të qartë. Në raportin e fundit të Bankës Botërore, në raportin Duing Biznis për vitin 2009, Kosova është në vendin e fundit për nga krijimi i mjedisit për zhvillimin e biznesit, është prapa Shqipërisë, prapa Malit të Zi, është prapa Maqedonisë, është prapa Serbisë dhe si ka guxim dikush dhe të krijojnë ose të lëshojnë një deklaratë të tillë politike, se duke pasur konsideratë mjedisin që e kemi krijuar, do të kemi ngritje dhe do të kemi investime direkt, pra kjo nuk mund të quhet ndryshe përpos vetëm një deklaratë politike që zë vetëm aq sa kohë mund të prononcohet.

Te planifikimi. Një gjë është shumë e qartë dhe është e njohur. Të dështosh në planifikim është e barabartë sikur të planifikosh dështimin. Nëse e krahasojmë Projektbuxhetin që ka qenë në vitin 2009, me projektbuxhetin që është tash për vitin 2010, a mund të merrni me mend se cilat projekte po përsëriten? E kemi të njëjtin projektbuxhet, i kemi projektet të cilat bartën prej viti në vit dhe nuk realizohen dhe çka është në pyetje? Dikush, një koleg parafolës tha ndoshta duhet të sanksionohen ato agjenci buxhetore. Jo zotëri i nderuar, këtu duhet të sanksionohet qeverisja, kemi të bëjmë me mungesën e kapaciteteve qeverisëse për ta ekzistuar, për ta ekzekutuar, për ta realizuar buxhetin, për t'i implementuar programet. Prandaj, kemi një gjendje çfarë e kemi. Me këtë buxhet, u tha nga parafolësit, nuk është zhvillimor dhe nuk mund të jetë zhvillimor, është buxhet i mbijetesës. Dhe, fatkeqësisht rrethi vicioz që po na përcjell

me këtë Qeveri, do të krijohen edhe mundësi të reja për t'i vështirësuar sfidat, për të vështirësuar edhe segmentet tjera. Po e them varfëria, papunësia, vështirësitë e panumërta që do të shfaqen në vitet në vijim, për jetë normale, do të jemi pjesë që do të na kaplojnë, do të jenë pjesë e ditës tonë.

Ajo çka mund të themi se Grupi Parlamentar i LDD-së, jo që nuk e përkrah, po kërkon nga Qeveria, po njëkohësisht edhe nga deputetët që të jenë të vëmendshëm për atë se çfarë hapi duhet ndërmarrë, duke pasur parasysh se Kosova ka kapacitete shumë më të mëdha të realizojë të hyra dhe të kemi një buxhet funksional. Ky buxhet nuk është zhvillimor. Ky buxhet është kontraproduktiv dhe krijon një destabilizues . Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit për respektimin e kohës! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” Enis Kervan apo Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA SHINIK:

Teşekkür ederim,

Sayın Meclis Başkanı, sayın başbakan ve yardımcıları, bakanlar ve milletvekilleri 2010 yılının Bütçe planlaması için bugün burada, 2010 yılı Bütçe Yasa Tasarısı görüşülmektedir. Oldukça iyi bir şekilde hazırlanmış bir Yasa Tasarısı olarak karşımıza çıkmaktadır. Ancak eklenmesi gereken çok şeyin de olduğu görülmektedir. Örneğin Topluluklar ve Geri Dönüş Bakanlığında planlanan 2 milyon euro ayırışma strüktürünün belirtilmesi gerekmektedir. Kapalı bir şekilde gösterilen bu 2 milyon euronun ayrıntılı açıklanmasının yapılması gerekmektedir.

Çevre ve Alan Planlama Bakanlığında Bütçenin az olduğu görülmektedir. Hatta bu bakanlığın bütçesine ek olarak, çevreci derneklerin desteklenmesi için niceki yeşili koruma, çevreyi koruma, okul bahçe düzenlemeleri için ek bütçenin planlaması gerekmektedir. Tarıma elverişli alanların olduğu Kosova Cumhuriyeti'nde, tarıma çok büyük önem verilmesi gerekmektedir. Ancak var olan subvensiyonların yetersiz olduğu da görülmektedir. Geçen yıla nazaran bu yıl bütçenin daha az planlaması, anlamsız görülmektedir. Diğer yandan Ulaştırma ve Telekomunikasyon bakanlığında Dula-Suha Reka yolunun yeniden yapımı için bütçe planlanmasına alınması gerekmektedir.

Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığı'nda, birinciden dokuzuncu sınıfa kadar ders kitapları için öngörülen 500 bin euronun çok az bir mevla olduğu göze çarpmaktadır. Bu miktarın yeniden görüşülmesi gerekmektedir. Onun dışında Belediye eğitim müdürlüklerinden okullara sunulan temizlik malzemeleri ve okullardaki yıpranan araçların yenilenmesi için gerekli bütçenin planlanması gerekmektedir. Bundan mada, ilkokullarda eğitimin iki devreye geçebilmesi için ek okul binalarının yapılması için bütçe planlanması gerekmektedir. Bu konuda kırsal kesimde, hükümetimizin sunmuş olduğu desteği selamlarken, şehir merkezlerinde de aynı şeyin yapılması gerektiğine inanmaktayız.

Kosova Cumhuriyeti Kültür, Gençlik ve Spor Bakanlığı'nda da planlanan bütçenin yetersiz olduğu görülmektedir. Burada halkımızın tamamen bilinçlendirilmesi konusunda ve tarihi kültürel mirasın ortak olduğunu göz önünde bulundurmakla, var olan müze ve

tarihi eserlerin bakımıyla ilgilene çalışanların maaşı için ek bütçenin yapılması gerekmektedir. Onlardan biri de Prizren'deki tarihi namazgahın bakımlarını yapan çalışanların ödeneklerinin planlanması gerekmektedir. Diğer bazı bakanlıkların da bütçe planlamasının yeniden görüşülmesi gerekirken Kosova Cumhurbaşkanı'nın himayesinde faaliyetlerini sürdüren Topluluklar Danışma Kurulu bir yıldan bu yana çalışmalarını sürdürmektedir. Ancak bütçesiz planlanan çalışmalar eksik kalıyor, gerçekleşmiyor. Bundandır, Topluluklar Danışma Kurulu için bütçenin öngörülmesi gerekmektedir.

Bütün bu saydıklarımızın dışında halkımız, çalışanlarımız haklı olarak hükümetimizden daha fazla destek beklemektedir. Örneğin çok kutsal, kutsal olduğu kadar da zor bir görevi üstlenmiş polislerimizin, değeri ölçülmez, hepimizi yetiştirmiş ve yetiştirmekte olan öğretmenlerimizin, eğitimdeki çalışanlarımızın, sağlık çalışanlarımızın ve hayatını Kosova'da çalışarak Kosova'nın gelişmesine katkı sunarak geçiren çok değerli büyüklerimizin, yani emeklilerimizin maaşlarında planlanandan, daha fazla bütçenin planlanması gerekmektedir.

Yapılan önerilerle birlikte, 7+ Parlamenter Grubu olarak, 2010 yılına ait Yasa Tasarısı'nın birinci okunuşunu kabul ediyoruz ve çalışmalarınızda başarılar diliyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të grupit parlamentar "7+", Deputeti Slllobodana Petroviq

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala predsedniče!

Uvaženi premijeru i kabinetu Vlade,

Poštovani narodni poslanici,

Dame i gospodo,

Ono što je Samostalna liberalna stranka dala kao doprinos jeste kroz Komisiju za budžet, naime naš član je kroz preporuke i amandmane dao doprinos iz naše poslaničke grupe. Ono što sam želeo pre svega ispred Samostalne liberalne stranke da Ministru za finansije izrazim zahvalnost na iscrpnom izlaganju i preporuci za ovaj budžet. Svakako ono što moram da iznesem kao nešto što se sa naše strane vidi kao problem jeste da se upravo Ministarstvo za povratak i zajednice i u ovom budžetu zasniva na istoj cifri, što je sigurno nešto što nije pohvalno. S druge strane, ako imamo za primer da u prošloj Vladi, odnosno prošli ministar je imao duplo veći budžet za ovo ministarstvo, svakako da je to nešto što je sa naše strane neprihvatljivo, a s druge strane smo svesni činjenice da i Vlada i ministar finansija nisu madjioničari i nisu ljudi koji mogu da podele budžet veći nego što jeste i iz tog razloga želim da dodam jedno priznanje Ministarstvu za budžet i finansije koje je uspelo da i u ovim uslovima menadžira nešto što je jako bitno za naše budućnost, bez obzira što mi nismo u potpunosti zadovoljni. Svakako da ima puno momenata i načina gde je potrebna veća finansija, samim tim što se upravo sada i broj opština povećao, to je još jedan dodatni elemenat za dodatnu investiciju. Ono što je stav Samostalne liberalne stranke jeste da razume situaciju, razume i potrebu onih koji kritikuju budžet, znači sa stanovišta

Samostalne liberalne stranke mi čemo u načelu podržati ovaj apredlog ministra za financije. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë ju kërkoj falje për mungesën e përkthimit gjatë diskutimit të deputetës Mufera Shinik, por realisht ka qenë një angazhim ndoshta nga vetë deputetët për përkthyesit, kështu që nëse jeni të interesuar, mund ta përsëritni edhe një herë diskutimin që të përkthehet. Mirë, atëherë vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Projektbuxhetin që e paraqiti Qeveria sot para Kuvendit është një fakt i dhimbshëm se nuk ka për të pasur përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve të Kosovës. Qeveria ka rritë shpenzimet, por të vetat. Vetë ministri Shala në hyrje të dokumentit të buxhetit thotë: “Plani i shpenzimeve mund të quhet edhe ambicioz”. Zoti ministër, buxheti duhet të ishte hartuar në përputhje me nevojat e njerëzve të Kosovës, e jo të Qeverisë.

Me Projektbuxhetin për vitin 2010 dhe projeksionet deri me 2012, Qeveria ka dështuar të ballafaqohet me problemet e qytetarëve dhe t’i zgjidhë ato. Kjo do të thotë se në jetën tonë reale do të vazhdojë papunësia, varfëria, mungesa e rrymës, edukimi cilësor, shëndetësia dhe gjyqësia e dobët. Prandaj, Qeveria ka treguar paaftësi, joefikasitet dhe keqmenaxhim.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që vlerësimet e mia t’i mbështes me numra:

1. Nga projeksioni e të të hyrave të buxhetit del se buxheti i Kosovës prej vitit 2010 deri në 2012 do të jetë i varur nga të hyrat në doganat më shumë se 70%. Kjo e bën buxhetin të paqëndrueshëm. Me projeksionet e këtij buxheti, Qeveria tregon se nuk parasheh zhvillim ekonomik deri më 2012. Pra, gjatë tri viteve të ardhshme, Kosova nuk do të ketë asnjë përmirësim të parametrave makro-ekonomikë, nuk ka politika zhvillimore, nuk ka zhvillim ekonomik. Të gjitha projeksionet e bruto produktit vendor mbesin në nivelin 70% shërbime dhe tregti dhe 30% industri dhe bujqësi. Këta janë tregues se nuk do të ketë zhvillim.

Në këtë projektbuxhet nuk kanë mund të gjenden specifikime sa u përket të hyrave tatimore, po ashtu se sa janë kamatat në 260 milionë euro letra me vlerë që i mbanë Qeveria jashtë Kosovës.

2. Sa u përket investimeve kapitale, është e dukshme se këto investime janë për 70.5 milionë më pak se sa në vitin 2009 apo shprehur në përqindje, në vitin 2009, këto kanë qenë 41% për vitin 2010 janë 38.9%. Pra, nuk krijoni ambient stimulues për investimet private dhe të huaja, siç e keni shkruar në dokument, zotim ministër.

Sa u përket shpenzimeve kapitale prej 400 milionë euro, të parapara për buxhetin 2010, në të vërtetë 212 milionë euro janë të bartura nga projektet e vitit 2009, e realisht vetëm 190 milionë euro janë investime kapitale për vitin 2010.

3. Sektorët: Kryeministria. Sa i përket ndarjes së buxhetit, vërehet rritje spektakulare e buxhetit të Kryeministrit prej 4.9 milionë euro më 2009, është projektuar në 8 milion e 850 mijë më 2010. Kërkoj sqarim pse është bërë kjo rritje.

Ministria e Transportit, do të përqendrohet në një projekt të veçantë, që është vlера e projektit të rehabilitimit të rrugës Pejë-Prishtinë, që parashihet për vitin 2010 më shumë se 38 milionë euro, por duke marrë parasysh se 20 milionë të tjera janë gjithë vlера e projektit, atëherë del se 1 kilometër rrugë është 2 milionë e 600 mijë euro. Shifër spektakulare.

Për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale janë paraparë më shumë se 9 milionë euro. Konsideroj se po të ishin ndërtuar sipas standardeve, nuk do të kishte nevojë të bëheshin shpenzime kaq të mëdha. Dëshiroj të kujtoj dhe frikësohem se në të ardhmen, për shkak të ndërtimit të tillë të rrugëve që shkojnë shumë afër shtëpive, mund të na ngjajnë tragjedi si ajo e Suhodollit të Mitrovicës, ku tre fëmijë vdiqën dhe shtatë u lënduan sepse shoferi i kamionit për shkak të defektit humbi kontrollin dhe u fut në shtëpi të banimit.

Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, ka një buxhet prej 71.8 milionë euro, që krahasuar me vitin 2009, është diku 5.6 milionë euro më shumë. Por, ajo çka duhet për qytetarët e Kosovës, buxheti i ndarë për barëra është shumë i vogël në vlerë prej 19 milionë euro, që i bie se çdo muaj parashihen diku mbi 1 milion e 500 mijë apo 0.80 centë për kokë të banori. Nuk ka rritje të pagave të punëtorëve shëndetësorë dhe as buxhet të paraparë për Ligjin për sigurimet shëndetësore, që e bën shëndetësinë të dobët.

Sa i përket Universitetit, do të fokusohem në arsimim, në Universitetin e Prizrenit, ku parashihen 2 milionë euro. Personalisht i gëzohem jashtëzakonisht shumë hapjes së Universitetit në Prizren, mirëpo më brengos fakti pse kjo nuk bëhet në Pejë, duke marrë parasysh traditën e edukimit të lartë dhe ekzistimin e Fakultetit të Biznesit në Pejë, i cili është degë e Universitetit të Prishtinës. Insistoj që buxheti të parasheh ndërtimin e fakultetit edhe në Pejë.

4. Komunat. Politika diskriminuese nuk vërehen kund më shumë në këtë buxhet se sa në komuna. Në Pejë investimet nga Qeveria janë paraparë 2 milionë e 900 mijë, në Prizren 7 milionë...

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Po të shihej afiniteti im, me kënaqësi do t'ju zgjatja kohën unë personalisht, mirëpo nuk kam mundësi se... Ju faleminderit shumë.

Zonja Zylfije Hundozi e ka fjalën, le të bëhet gati zonja Donika Kadaj-Bujupi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ndër fjalitë e para në fjalimin e sotëm të kryeministrit ishin se ky buxhet sjell zhvillim ekonomik dhe avancim të agjendës evropiane. Kur analizohet buxheti i vitit 2010 dhe sidomos mjetet e ndara për agjendën evropiane, do të kuptojmë se janë në kontradiktë me fjalët e kryeministrit, gjegjësisht as në buxhet e as në kornizën afatmesme të shpenzimeve nuk parashihet se sa do t'i kushtojë Kosovës realizimi i agjendës evropiane.

Gjithashtu, në buxhet nuk parashihen shpenzimet për zgjidhjen e çështjeve të ngritura në Raportin e progresit dhe sa do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës zgjidhja e këtyre problemeve.

Gjatë analizës së projekteve kapitale, në buxhetin e vitit 2010 shihet se Raporti i progresit nuk është marrë për bazë gjatë planifikimit. Si rezultat, asnjë sfidë që parashihet në lëmin e bujqësisë dhe pylltarisë nuk është adresuar. E njëjta gjë është për sfidat në fushën e transportit dhe të posttelekomunikacionit, e sidomos ato me hekurudhat e Kosovës nuk janë adresuar fare në buxhetin e Kosovës. E njëjta gjë vlen për sfidat në ruajtjen e ambientit, gjë që është prioritet për Unionin Evropian.

Buxheti nuk i adreson sfidat të cilat lidhen me politikën e riatdhesimit, të azilit, të shpëlarjes së parasë, të drogës, të luftimit të krimit të organizuar dhe të terrorizmit e të mbrojtjes së të dhënave personale. Jo vetëm që nuk ka vlerësim për koston e agjendës evropiane, por gjithashtu nuk tregohen se sa përbind do të jetë e financuar ko agjendë nga Komisioni Evropian nëpërmjet të IPA-s. Edhe fusha e koordinimit të donacioneve ka qenë dështim total. Edhe pse është premtuar që Qeveria gjatë vitit 2008, do ta vendosë databazën e koordinimit të donacioneve, një gjë elementare për ta filluar punën, këtë gjë nuk e ka bërë gjer në ditën e sotit, për çka më tepër as nuk duhet të presim.

Për shkak të rritjes së vëllimit të punëve në agjendën evropiane, është planifikuar që numri i personelit të agjencionit të ngritet prej 34 në 65 punëtorë, por buxheti për vitin 2010, ka paraparë paga vetëm për 34 punëtorë, kështu që personat që janë shkolluar nga ana e Komisionit Evropian në universitetet prestigjioze të Evropës Perëndimore për ta ndihmuar Kosovën në këtë agjendë, mbesin ende pa punë. Nga krejt kjo çka u tha, shumë lehtë mund të kuptojmë se faktikisht, do me thënë deri më tash këto premtime kanë mbetur vetëm premtime në letër dhe asgjë më tepër. Kjo nuk është porosi e mirë për Unionin Evropian, se tregon që nuk ka seriozitet në punën e Qeverisë sa i përket procesit të integritimeve evropiane, edhe pse ka deklarata të bollshme për integrimin tonë në këtë proces.

Por, edhe për kundër deklaratave dhe dëshirave tona, pa punë do të mbetemi edhe më tutje në nivelin zero të këtij procesi shumë të rëndësishëm, për të cilin të gjithë kemi konsensus.

Në Raportin e progresit, i jepet vërejtje edhe Kuvendit të Kosovës për mungesë të kapaciteteve administrative dhe nevojës që komisionet e tij të kenë ekspertë që të ndihmojnë punën e tyre. Shpresoj që Kuvendi gjatë ndarjes së buxhetit do ta ketë

parasysh këtë vërejtje se vëllimi i punëve gjatë fazave të ardhshme të procesit të integritimeve evropiane do të rritet.

Nëse merret parasysh që Qeveria e ka shpallur prioritet kohezionin social në buxhet, nuk ka mbulesë për këtë prioritet, kështu që edhe kjo do të mbetet një dëshirë e Qeverisë, e shkruar vetëm në letër. Kjo gjë mund të vërtetohet shumë lehtë nëse analizohet buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë. Edhe këtu nuk ka ndryshime nga viti i kaluar, pos që shtohen 4 milionë për barëra. Buxheti për barëra është rritur edhe gjatë rishikimit të buxhetit të vitit të kaluar, por në...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Hundozi! Fjalën e ka zonja Donika, të bëhet gati zoti Driton Tali.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Derisa Kryeministri i Kosovës, i cili ikë prej këtu çdo herë kur flet Aleanca, thotë që ky projektbuxhet ka të bëjë me një politikë zhvillimore, unë ia përkujtoj që pikërisht kjo politikë “zhvillimore” ka bërë që Kosova të humbë 800 milionë euro në sferën e energjetikës në dy vitet e fundit dhe kjo për shkak të ngecjes së projektit “Kosova C” me të cilin u morën një vit për t’ia ndërruar emrin dhe për ta bërë “Kosova e Re” e që në fund dështoi. Do të thotë, Kosova për shkak të këtij dështimi dhe kësaj ngecjeje humb mbi 800 milionë euro. Importohet energji elektrike, po e shohim edhe në këtë projektbuxhet që janë ndarë mjete për import të energjisë elektrike, import i cili kushton shumë shtrenjtë dhe unë kam një pyetje për ministrin e Financave dhe kryeministrin se kush po përfiton nga ky import i energjisë elektrike për faktin se dështimi është bërë me qëllim ose, të paktën, deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës nuk u është dhënë asnjë arsye pse ky projekt po dështon dhe pse Kosova po i humb 800 milionë euro.

E dyta, ne po flasim apo ju po pretendoni që ky projektbuxhet është një projektbuxhet i politikave zhvillimore, derisa në bujqësi investimet kapitale janë përgjysmë më të vogla se në vitin e kaluar. Derisa ndodhë kjo, shohim se kemi një rritje për inventar, do të thotë për mobile luksoze, do të thotë komoditet të qeveritare nëpër ministri të ndryshme prej 3.5 milionë euro. Kjo nuk është politikë zhvillimore, është larg prej politikës zhvillimore.

E treta, buxheti është i të gjithë qytetarëve të Kosovës, u tha edhe nga vet ju dhe është i tillë, mirëpo si ndodhë që në Ferizaj ndahen për investime kapitale 6 milionë euro. Nuk kam asgjë kundër, por mendoj se nuk është në rregull që në Deçan ndahen 1.5 milionë euro. Kemi thënë shumë herë, edhe Deçani është pjesë e Kosovës, është komunë e Kosovës dhe do të duhej të kemi ndarje proporcionale për të gjitha komunat e Kosovës.

E treta, kam një pyetje për të parin e Qeverisë, që iku nga vendi i ngjarjes. Ku mbetën 120 milionë euro të Gjakovës, 100 milionë euro të Gjilanit, 150 milionë euro të Ferizajit, 150 milionë të Mitrovicës e tjera, e tjera, e tjera. Ato nuk ndodhen në këtë Projektligj të buxhetit të paraparë për vitin 2010. Ku mbetën? A kanë qenë pjesë e fushatës

zgjedhore, a është gënjeshtër normë e kësaj Qeverie, çka po ndodhë? Do të thotë, këto janë disa nga pyetjet për të cilat konsideroj se sot duhet të marrim përgjigje në këtë Kuvend edhe ne si deputetë, por edhe qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Driton Tali, të bëhet gati zoti Sabri Hamiti, sepse Ismet Beqiri ia ka lëshuar radhën.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Kur e dëgjova fjalimin e kryeministrit sot, pash se edhe fjalimin, fjalimshkruesit, u mor vesh, nëse ka, nuk ia kishin ndryshuar fare, ishte identik me atë të vitit të kaluar. Kujt i intereson, le ta merr fjalimin e kryeministrit, të cilin e mbajti në Kuvend më 25 nëntor të vitit të kaluar, pra edhe dy ditë për një vit, dhe do ta shihni se çfarë fjalimi ka qenë atëherë, është i ngjashëm me të sodit, me disa ndryshime. U mor vesh, sot nuk na premtoj silicon valley. Ngjashëm edhe me fjalimin e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, e kemi në transkript, faqe 2 deri në faqen 17, do ta shihni se dy fjalimet ishin identike. Çka na tregon kjo? Pos shumë gjërave tjera, na tregon se edhe ky buxhet është projektuar në bazë të logjikës së njëjtë, që nënkupton që edhe ky projektim do të ketë po ato huqje, po ato gabime që i pati ky i vitit të 2009, do me thënë se Qeveria pas një katër, pesë muajve përsëri do të na sjellë me ndryshime këtë projektligj, që në realitet do të jetë Ligji i buxhetit të Kosovës, sepse ky Projektligj do të votohet ngase, siç e dimë, koalicioni qeveritar nëse ka ymër deri atëherë, do ta votojë, i ka votat e mjaftueshme, po edhe ministri i Ekonomisë dhe i Financave do të na tregojë se të huqen statistikat 60% apo edhe 90%, nuk është ndonjë gabim i madh, sepse edhe ministrat e Britanisë, të Gjermanisë e të Japonisë gabojnë në projektimin e buxheteve të tyre për edhe gati tetë herë. Shyqyr që nuk e ka ndie ministri i Japonisë, se do ta kishte paditur në gjyq.

Shikoni, ju lutem, nëse e marrim Projektbuxhetin për vitin 2010, unë do të ndalem vetëm te të hyrat tatimore, do të shohim se për vitin 2010 parashihen 891.6 milionë euro. Në vitin 2009, me rishikim është planifikuar 821 milion euro. Të hyrat nga tatimet vendore 235 milionë për vitin 2010, për vitin 2009, 200 milionë me rishikim, u mor vesh, dhe të hyrat nga kufiri 683.6, gjersa në vitin 2008, me rishikim u patën paraparë 645. Mirëpo, nëse e marrim dhe e shikojmë atë buxhetin që e patëm diskutuar më 25 nëntor, vjet, do të shohim se të hyrat tatimore për vitin 2009, patën qenë të planifikuar 840.8 milionë euro. Tatimet në kufi, siç quheshin atëherë, 665.3 milionë euro, do me thënë për më pak se 4 muaj Qeveria i uli për 20 milionë të hyrat tatimore, për aq e kishte huq.

Problemi është se ato nuk do të realizohen, sipas të dhënave nga doganat edhe këto, do me thënë 800 e sa, do me thënë 665 milionëshi që është rishikuar, nuk do të realizohet sepse të dhënat nga doganat për nëntëmujorin e parë, do me thënë janar-nëntor, shihet se në dogana sivjet kanë mbledhë 1.5 milionë më pak se në vitin e kaluar, do me thënë edhe në atë nivelin e buxhetit 2008 nuk do të inkasohen, nuk do të bëhen tatimet me dogana, e lëre më rritje për 8%, siç është paraparë. Ngjashëm është edhe me Administratën Tatimore, ku ka vjelje të tatimeve më pak për këtë 9 muaj, krahasuar

me nëntëmujorin e vitit 2008, do me thënë edhe nivelin e 2008, pra pa marrë parasysh ato planifikime të rritjes që janë bërë.

Për të njëjtën periudhë, Administrata Tatimore, sa për t'ia shpjeguar ministrit është, do me thënë janë 136.7 milionë euro, që janë 12 milionë euro më pak se në të njëjtën periudhë të vitit 2008, kur u patën inkasuar për të njëjtën kohë 136.7 milionë euro. Pra, jo që nuk ka pasur rritje, por ka ulje të të hyrave tatimore apo rritje në buxhet.

Unë do t'ia rikujtoja ministrit, por edhe juve, zotëri kolegë këtu, si dhe opinionit të gjerë kosovar, se një gjë të tillë e pata theksuar fuqishëm në këtë foltore, më 25 nëntor, në seancën kur u bë shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin, merreni e shiheni kush është i interesuar, do ta shihni. Pata pas kundërshtuar për shkak se logjika e hartimit të ...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Tali! Fjalën e ka zoti Sabri Hamiti, le të bëhet gati zoti Numan Baliq.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues, Kryeziu,

Zoti zëvendëskryeministër,

Kolegë të nderuar,

Kohën e bëmë me votë, të shkurtër, prandaj unë do të përpiqen, ndonëse në princip deputetët zakonisht po lypin të diskutojnë shumë, sot thanë jo, me votë.

Unë do t'i bie shkurt në disa pika. Komisioni i ndarjes së grandeve për komuna nuk funksionon, prandaj kemi një buxhet të padrejtpeshuar në financimin e komunave të Kosovës. Ky mosdrejtpeshim prishet edhe më tepër në pjesën që ministritë e veçanta i çojnë në komuna të veçanta. Kjo mund të dokumentohet më së miri me Prishtinën, për të cilën Qeveria qendrore nuk ka ofruar asgjë, për më tepër, nuk ka marrë parasysh projektet më të fuqishme zhvillimore që lidhen me kryeqytetin. Prishtina është me Kushtetutë kryeqytet i Kosovës, Prishtina është vend ku kalojnë brenda ditës, mos të them jave, gjysma e Kosovës, e banorëve për të punuar, për të jetuar ose për të kërkuar shërbime. Është e pajustificueshme që një qeveri qendrore pretendon të silllet në këtë formë me kryeqytetin e vet. Unë vetëm po shtoj që ky buxhet do të jetë i kushtëzuar sa i përket LDK-së me ardhjen në procedurë në Kuvend të Ligjit për Prishtinën. Kjo le të dihet që sot, në mënyrë që mos të flasim me figura pa lidhje, sepse ligji pa arsye është shtyrë që 6-7 muaj. Më në fund, këtu kemi edhe zëvendëskryeministrin, që solemnisht në një pyetje timen më është përgjigjur se qysh para zgjedhjeve ai ligj do të jetë i kaluar në Kuvend. Pse e them këtë? Sepse direkt statusi i Prishtinës është i lidhur me këtë ligj, i cili i ofron Prishtinës me kushte momentale edhe nja 8 milionë, sa i kam llogaritur unë, të grandeve për kryeqytetin.

Tutje, duhet të merret parasysh të financohet një spital publik për Prishtinën, që është di domosdoshëm. Tutje, Ministria e Arsimit, unë i thërras tre ministrat e Arsimit, të Kulturës dhe të Telekomunikacionit të japin shpjegime, unë besoj se do të kthehet. E Arsimit - pse nuk zbatohet Ligji për shkencën, pse nuk jepet asgjë për shkencën dhe thuhet se jemi shoqëri e dijes. Përkundrazi, kjo do të thotë se jemi shoqëri e analfabetëve,

sepse nëse ligji ekziston dhe nuk zbatohet dhe për shkencë nuk jepet asgjë, do me thënë fjalët nuk kanë kuptim. Akademia e Shkencave financohet, instituti më i lartë me një shumë që është qesharake përreth 400 a 500 mijë. Në anën tjetër, për hulumtime dhe shkollime të kuadrove të forta në dije, në shkencë, nuk ka asgjë. Në kulturë jepen nja 100 mijë euro më shumë se herën tjetër, por për ata që quhet kulturë e gjallë që prodhohet, që nënkupton artistë të të gjitha lëmive, nuk ka kurrfarë financash. Edhe shtetet shumë më të forta e më të kulturuara se ne, financojnë kulturën elitare, këtu nuk ka asgjë për teatër, për film, për fushat tjera të krijimtarisë, për libër.

Unë kërkoj dhe do të bëjmë amendament, që në këto pika ne të kemi shumat e caktuara. Dhe, në fund, u përmend disa herë Fondi Monetar Ndërkombëtar. Unë nuk besoj që Fondi Monetar Ndërkombëtar rekomandon që zhvillimi i këtij vendi të mendohet vetëm me shtrimin e asfaltit, bile shtrimi i asfaltit vetëm në një krahinë, bile edhe në rrugët që janë dhiare, nuk janë rrugë që prodhojnë nevojë qarkullimi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Hamiti. Fjalën e ka Numan Baliq

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Selam svima koji su prisutni su sali i rečiću nekoliko stvari koje ću nastojati da kažem nešto oko budžeta, mada govoriti o budžetu, godišnjem budžetu za jednu zemlju je jako odgovorna stvar, treba puno znanja i vodiću računa da budem oprezan da doprinesem ovoj diskusiji a ne da je otežam. Ovo oko nekih ključnih stvari je vrlo kratko. Vlada je napravila odredjene pomake koji su očigledni i oni se tiču selektivnog povećanja plata koje je usmerena prema policiji i sljedi ono povećanje koje je prošli put bilo kod obrazovanja. Radi se o jednom selektivnom povećanju koje je vezano za gradiranje službenika u ovo ministarstvo, odnosno u policiji. Jeste ambiciozno, ali je nedovoljno i smatram da bi povećanja plata moralo biti za sve civilne službenike Kosova. Mislim da ne bi bilo previše ambiciozno ako bi Vlada napravila konačan taj iskorak, koji sam spominjao i prošli puta, a to je u stvari jedan odlučujući iskorak, gde bi svim civilnim službenicima na Kosovu plate bile povećane za najmanje 50%. Bez takvog povećanja plata ne može biti govora o povećanju plata službenika. Naravno da imam u vidu ograničenje Medjunarodnog monetarnog fonda i sve druge priče koje su vezane uz ovo, ali takodje imamo primer koji smo ponavljali mnogo puta da u cijelom okruženju imamo mnogo veće plate nego što su kod nas i više nema potrebe argumentirati ovo pitanje.

U vezi sa prihodima i sa budžetom, odnosno punjenjem budžeta, mislim da se on uglavnom i dalje zasniva na carinama, dok su drugi sistemi punjenja budžeta zapostavljeni, posebno sistem ubiranja, efikasnog ubiranja poreza i taksi na svim nivoima, koji nije razradjen niti efikasan i, naravno, opštinski prihodi koji bi morali biti mnogo veći jer mi, nažalost, imamo situaciju da kao što je ministar i premijer, kao što su spomenuli, da je 80% sredstava u opštinama finasirano iz centralnog budžeta. Dakle, praktično opštine, čak i one najjače, zavise od vladinog budžeta. Ovde bih podržao potpuno zahtjeve nekoliko poslanika da budžet prema opštinama mora biti potpuno ravnopravno podeljen pa da se ne dešava da neke opštine, kao što je Peć ili neke druge koje su spomenute, budu zaista zapostavljene u odnosu na druge. Treba pravedno podeliti budžet koji imamo.

Sada çu se taçi malo pitanja koje se tiçu adminsitracije drugih zajednica i Ministarstva za administraciju i lokalnu upravu. Mislim da ona mora podstaknuti razvoj lokalnih kancelarija, mesnih kancerlarija, koje su jako zapostavljene u celom Kosovu, posebno u krajevima gde žive malobrojne zajednice, odnosno takozvane manjinske zajednice, iako one nisu ustavna kategorija. Mnogi dijelovi u Peći, Prizrenu, Mitrovici pa i u onim dijelovima gde su Albanci, da tako kažem, manjina u sjevernom dijelu Kosova i u enklavama, mora se potaçi razvoj mjesnih kancelarija koje bi stimulisale razvoj manjinskih zajednica. Vezano za Ministarstvo za povratak, smatram da je budžet za Ministarstvo za povratak neoprostivo mali i da je zaista, moram da kažem, apsolutno neprimjereno da ovo ministarstvo za sve zajednice ima tek 0,5% budžeta od celog budžeta Kosova. Zamislite, govorimo o multietničkom Kosovu, a Ministarstvo za zajednice ima pola procenta budžeta. Neoprostivo, to se mora popraviti! Budžet mora biti dvostruko, trosotruko veći! Naravno da o ovome treba govoriti oni koji su kompetentni, oni su to danas izgleda izostavili ili zaobišli.

Vezano za zdravstvo, smatram da je vrlo bitno da u zdravstvu konačno moramo uraditi prave stvari. Zdravstveni sistem na Kosovu i dalje pati od hroničnog slabog mendžiranja, koji je ključni sistem, ključni faktor u jednom dobrom i efikasnijem zdravstvu, ali takodje i u dobrom finansiranju. Mi i dalje nemamo Fond za zdravstveno osiguranje. Bez osnivanja Fonda za zdravstveno osiguranje nemamo efikasnog zdravstva. Sve zemlje u cijeloj Evropi i u Zapadnom Balkanu imaju sistem zdravstvenog osiguranja, Kosovo ga nema. Vlada mora naçi odgovor na to pitanje. Vlada mora uspostaviti sistem za zdravstveno osiguranje. Takodje, naravno da je ohrabrujuće da imamo prekovremeni rad, koji će biti plaćen i dodatak od 1,5 milion evra, potom neke druge mjere koje su preduzete... Da, povećanje novca za esencijalne lijekove, ali molim vas, nije dovoljno ako mi damo 20 miliona evra za esencijalne lijekove, a da su rafovi u Kliničkom centru, u svim bolnicama nigde nema lijekova. Pa gde je tih 20 miliona evra? I Vlada, i ministarstva, i opštine moraju dati odgovor šta je sa 20 miliona evra utrošene na lijekove, a pacijenti kupuju lijekove, molim vas. To je neoprostivo, nedopustivo, jednostavno se moraju naçi načini ne samo za povećanje i finansiranje, koje jeste ohrabrujuće, ali jedno katastrofalno loše menadžiranje koje ostavlja pacijente bez lijekova.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Baliq! Zoti Ismet Beqiri, le të përgatitet zoti Ibrahim Gashi.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, po i përmendi shumë shpejt, për shkak të limitimit të kohës, atë që edhe unë bëj pjesë në grupin e deputetëve që pyes Qeverinë, kryeministrin dhe ministrin e Financave me të cilën drejtë, kush ua ka dhënë atë të drejtë që të heqin ose të mos figuron borxhi, gjegjësisht kredia e KEK-ut. Kjo do përgjigje tash ose më vonë, sigurisht. Pastaj, shumë shpejt kaloj nëpër atë se si trajtohen disa sektorë të ministrive të ndryshme, trajtimi i bujqësisë s'është aspak zhvillimor, i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme kurrfarë në aspektin buxhetor, mirëqenia sociale, ruhet status-kuoja pa kurrfarë perspektive, sektori i drejtësisë është jo funksional, kurse më së paku janë marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e tyre. Për kulturën, arsimin, rininë e sportin mos të flasim, është

totalisht një buxhet diskriminues, pa perspektivë dhe mundësi të zhvillimit dhe të plotësimit të nevojave të kësaj ministrie. Ministria e Punëve të Jashtme, hapja e ambasadave të reja, të konsullatave e shumë nevoja të tjera, e të ndahen 6 milionë euro, kjo është tërësisht e pamjaftueshme. U tha edhe më herët nga ministri dhe absolutisht nuk e përkrahi atë, sepse nuk janë kryer punët atje në kuptimin e nevojave për mjete financiare. Po ashtu, edhe te arsimi shumë shpejt, vetëm është interesant se si fillohen dhe përfundojnë projektet. Një shkollë fillon me 30.000 euro, 70.000, zgjatë 3 vjet dhe po ua përmendi, për shembull, një shkollë në Prishtinë. Planifikohet të fillojë ndërtimi i saj, 70.000 fillimisht në vitin 2010, 725.000 në 2011 dhe është 939.000 në vitin 2012. Vërtet është qesharake një shkollë 3 vjet të zgjatë të ndërtohet ose t'i pritët shiriti kur duhet t'i pritët për nevoja të dikujt.

Po ashtu, tek Ministria e Transporteve është një debalanc total i shpërndarjes së mjeteve, një disproporcion i cili nuk i përgjigjet aspak asaj që është munduar të bëhet një ndarje e drejtë nga grandet e Qeverisë. Unë nuk do të ndalem këtu, sepse ata që dëshirojnë ta shohin, mund ta shohin se çfarë disproporcioni dhe diskriminimi bëhet ndaj disa komunave.

Tek buxheti komunal do të koncentrohem pak më tepër. Fillimisht, nuk është e njëjta strukturë buxhetore në të gjitha komunat. Për shembull, një komune i qiten tek rubrika – zhvillimi ekonomik - të gjitha mjetet, ku mundësia e ndërrimit, por edhe e manipulimit me mjetet është shumë e madhe, kurse në komunat tjera ato ndahen në sektorë dhe nuk mund të ndërrohen pa procedura të caktuara. Pra, pse dy kute në komuna të ndryshme?

Po ashtu, ndarja e mjeteve, thashë, nëse komunat marrin grandet nga qeveria në një bazë që është ose kriter territori dhe numri i banorëve, kjo tërësisht, e thashë edhe më herët, priset me rastin e shpërndarjes së mjeteve nga ministrinë e caktuar.

Dhe, duke mos dashur të zgjatëm te të tjerat, më lejoni të them diçka për Prishtinën. Edhe unë e mbështes atë që e tha profesor Sabriu dhe vetëm më lejoni t'i them edhe disa të dhëna shtesë.

Prishtina në këtë buxhet fare nuk figuron dhe për mua është një turp i veçantë i kësaj qeverie që Prishtinën e diskriminon haptas në zhvillimin e saj. Pse po e them këtë? Lëre që nuk janë paraparë mjete të nevojshme, por edhe janë marrë ato që janë paraparë më herët, janë tërhequr dhe komuna e Prishtinës është dëmtuar në mënyrë drastike. Për shembull, është tërhequr ose s'janë dhënë mjetet që janë planifikuar për mbi 1.100.000 euro më herët, janë tërhequr për shkak se Ministria nuk ka shkuar të bëjë nënshkrimin e marrëveshjes. Po ashtu, mos të harrojmë këtë që Prishtina ose kryetari i komunës, zoti Mustafa ka u bërë kërkesë, më 8 shtator 2009, tri ministrive për projekte të veçanta dhe atë për vazhdim të Unazës së brendshme, pjesa lindore këtu u përmend, pastaj ndërtimi i rrugës Stallovë-Koliq-Dyz, që e lidh komunën e Prishtinës me komunën e Podujevës, vlera 2.5 milionë euro, zgjerimi i rrugës për Podujevë, që komuna e Prishtinës e ka kryer deri në fshatin Bardhosh, është kërkuar të vazhdojë kjo më tutje dhe s'ka përgjigje, normalisht s'ka as para. Po ashtu, është edhe kërkesa për ndarjen e 1 milion eurove për projektin nga Ministria e Planifikimit Hapësinor që ka të bëjë me vazhdimin e ndërtimit

të rrugës B dhe kolektorin e saj, të cilin në vitin 2009 e kemi financuar, e ka financuar komuna bashkërisht. Cila është përgjigja? Përgjigja s'është kurrkund. Dhe, mos të harrojmë, po e përmend edhe një fakt, që komuna e Prishtinës ka ndarë për institucionet shtetërore, Qeverinë dhe për të tjerët 25 hektarë tokë, ku do të realizohen projekte të ndryshme dhe e ka kryer obligimin ndaj shtetit. Po të ishte dhënë kjo tokë në partneritet publiko-privat, mund ta merrni me mend se çfarë të hyrash do të kishte komuna. Dhe si ia kthen komunës së Prishtinës Qeveria? Ia kthen me diskriminim të hapur. Dhe Qeveria ka bërë, po ashtu, disa ndryshime në Ligjin e buxhetit për vitin 2010, duke i vënë vetes, Qeverisë dhe Parlamentit kontroll mbi procesin e aprovimit të ndryshimit të buxheteve komunale, neni 14.6. Ndryshimet kanë obligime të rëndësishme sa i përket autonomisë së komunave duke u bazuar në këtë ...

KRYESUESI: Faleminderit zoti Beqiri. A po pajtoheni, Suzanë, që të flasë Ibrhaimi? OK. Faleminderit shumë! Urdhëroni!

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra prezentë,

Nëse Projektligji për buxhetin përbën një kaptinë të rëndësishme në politikën ekonomike të shtetit, atëherë Projektbuxheti ekskluzivisht duhet të jetë në funksion të rritjes ekonomike, të stimulimit të faktorëve ekonomikë përmes politikave të përshtatshme monetare. A po ndodh kjo, realisht, me këtë dokument që e kemi përpara? Ne e dimë se shtetet moderne janë shtete të taksave dhe të shpërndarjes, kudo në botë, por veprimtaritë taksative të qeverive gjithandej nëpër botë janë progresive, domethënë t'u marrësh të pasurve e t'u shpërndash të varfërve. Ndërkaq, në Kosovë kjo lloj politike ekonomike quhet veprimtari takstative regresive, që u merr të varfërve dhe u shpërndanë të pasurve. Këtë e them nëse i referohemi një pasazhi tek Raporti i progresit, thotë se në Kosovë punëdhënësi më i madh është Qeveria e Kosovës, që kjo flet sa të varfër jemi. Nëse krejt politikën ekonomike e mbështetim në politikë taksative dhe në procesin e shpërndarjes nuk mendojmë mirë se si t'i shpërndajmë këto, atëherë definitivisht jo që nuk i kontribuojmë zhvillimit ekonomik, por i kontribuojmë ngecjes. Kam frikën se duke pas parasysh këtë projektbuxhet që ka mungesë totale të subvencioneve, ka rënie drastike të investimeve kapitale dhe ka rritje të kategorisë së shpenzimeve dhe të mallrave të emërtuar si shpenzime operative, kam përshtypjen që ky projektbuxhet do të jetë në funksion të regresit ekonomik, në funksion të ngecjes ekonomike.

Unë nuk do të flas më shumë në këtë kontekst sepse nuk jam shumë ekspert, por do të ndalem te dy ministratë, te Ministria e Arsimit dhe tek Ministria e Punëve të Jashtme. Tek Ministria e Arsimit, u tha edhe nga kolegu Hamiti, kur përmendi, investimet në shkencë janë zero. Dhe, tek vendet në zhvillim, tek vendet e reja qysh jemi ne me këtë stad të zhvillimit ekonomik, investimet më të mira janë në arsim dhe në shkencë dhe kur ke parasysh që Kosova e ka vetëm këtë resurs të cilin mund ta zhvillojë, nuk ka resurse tjera, ne mund t'i bëjmë qejfin vetit, ne po e shohim KEK-un, kemi rezerva atje dhe për çdo vit ndajmë nga 50 e më shumë milionë për të blerë energji. Kjo po shihet se nuk riaktivizohen këto resurse të mëdha dhe i vetmi resurs që mund të riaktivizohet me një politikë të mençur ekonomike, janë resurset, është resursi human dhe resursi human

përmes arsimimit dhe në arsimin e kemi zero, edhe në shkencë. Pjesën më të madhe të investimeve i kemi investime kapitale në fushën e arsimit, që nuk nënkuptojnë rritje e cilësisë së mësimnxënies dhe të mësimdhënies, por nënkupton krijimin e një infrastrukture, e cila është po ashtu e domosdoshme, por nuk është krejt, do me thënë, esenca e projekteve zhvillimore në arsim.

U përmend Universiteti i Prizrenit. Unë sa lexova, nuk pash, kryeministri tha 2 milionë euro. Unë pash vetëm 1.260.000 euro investime kapitale dhe ato janë këtu kategoritë, janë vendet ku do të shkojnë ato investime. Unë në njëfarë mënyre pajtohem që duhet të vazhdojnë ato projekte, mirëpo ajo që edhe te Ministria e Punëve të Jashtme, edhe te Ministria e Arsimit, po edhe te agjencionet e pavarura përshkruhen aktivitetet si total, përshkruhet shuma e totalit që do të ndahet, por nuk specifikohet secili aktivitet sa e ka koston dhe sa pare i ndahen dhe atëherë kjo prapë, nëse janë në pyetje, për shembull, te Ministria e Punëve të Jashtme 7 milionë dhe shërbime operative, ka rritje për 7 milionë dhe zvogëlim në investime kapitale, atëherë nuk ka asnjë përshkrim me asnjë fjali se ku do të shkojnë ato 7 milionë, vetëm janë përmendur aktivitetet. Por, për mendimin tim, ajo lë tepër shumë hapësirë për të manipuluar me ato mjete që për një zë buxhetor janë dhënë më shumë, që ndoshta për hatër të dikujt apo për diçka tjetër, po e zëmë për një...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi! Radhën e ka zonja Muzejene Selmani, të bëhet gati zoti Fatmir Rexhepi.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues! Kërkoj që tjera herë, kur i merret fjala dikujt, të qiten emrat në tabelë atje dhe të dihet rendi e jo të anashkalohen opozita dhe pozitës t'i jepet mundësia. Faleminderit, për fjalën!

Duke marrë parasysh se ky Kuvend i Kosovës para 4 muajve ka miratuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në atë Kornizë afatmesme të shpenzimeve është ditur mjaft mirë se çfarë Projektbuxheti i vitit 2010 do të projektohet, atëherë kemi pasur një pasqyrë të qartë dhe tash ky Projektbuxhet i vitit 2010 është i njëjti projektbuxhet i vitit 2009, ku shifrat nga rishqyrtimi i Projektbuxhetit 2009 mund të them se kanë qenë 1.139.000 euro, kurse Projektbuxheti i vitit 2010, i cili prezantohet në Kuvend sot, është 1.190.000 euro. Këtu shihet se çfarë rritje të buxhetit kemi, kur dihet mjaft mirë se Kosova po shkon drejt një mos zhvillimi më të madh ekonomik. Duke marrë parasysh se ky projektbuxhet është më shumë projektbuxhet shpenzues dhe nuk është projektbuxhet për zhvillim për arsye të mos funksionimit të mirë të planifikimit të këtij projektbuxheti dhe duke ditur mjaft mirë se për Buxhetin e vitit 2010 nga vetë partnerët e koalicionit është paraparë që të ketë edhe ngritje të pagave, këtu shihet mjaft mirë - të pagave të punëtorëve të shëndetësisë dhe të arsimtarëve, ku shihet mjaft mirë se nuk mund të ketë rritje më shumë se 3%, i gjithë Buxheti 2010 nuk mund të mbërrijë rritje të bruto-produktit vendor deri në 4%, ku do të ishte një përparësi e madhe. Ministri e di mjaft mirë, edhe gjatë miratimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve, sa do ta ketë rritjen e zhvillimit Kosova.

Të hyrat e buxhetit për vitin 2010 nga doganat janë në rënie, ku në vitin 2009 kanë qenë 646 milionë euro, ndërsa tash i kemi të mbledhura 683 milionë euro. Dihet mjaft mirë çfarë gjendje të mbledhjes së tatimit nga doganat kemi, dy partnerët e koalicionit këtë gjendje e dinë mjaft mirë dhe për këtë arsye bëhet ky planifikim i projektbuxhetit. Të hyrat nga ATK-ja gjithashtu janë në rënie, minus 15%, ndërsa kredi që do të jepet prapë për import të energjisë dhe për projekte brenda KEK-ut, gjë që nuk është e mirë për një vend i cili mendon të zhvillohet. Rritja në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale nuk është shumë e gëzueshme, edhe pse ka rritje në këtë ministri, për arsye se me një vend të zhvilluar nuk duhet të ishte barrë që qytetari i Kosovës të mbahet me ndihma sociale nga Qeveria, por t'i gjendet një vend i punës dhe ai të zhvillojë një punë dhe të mbajë familjen e vet, jo të ngarkohet buxheti i Kosovës me ndihma sociale. Investimet kanë rënë. Rënia e investimeve është bërë edhe me vërejtje të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku Ministria e linjës, do të thotë, Ministria e Ekonomisë dhe Financa e di mjaft mirë se të gjitha projekt-investimet kapitale nuk janë realizuar në kohën e duhur dhe për këtë arsye nga vërejtjet e Fondit Ndërkombëtar është marrë që të zvogëlohet, që të zvogëlohen investimet kapitale në përgjithësi. Mund të them se nuk mund të përkrah një buxhet jo zhvillimor, apo më mirë të them një buxhet që do të shkojë më shumë në ndihma sociale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Muzejene. T'ju përkujtoj se punën në Kuvend, sidomos rendin e deputetëve e cakton Kryetari i Kuvendit, përkatësisht kryesuesi, megjithëse unë e kam bërë me konsensus dhe shumë transparent këtë çështje, për çdo rast. Radhën e ka zoti Fatmir Rexhepi, të bëhet gati zoti Agim Veliu, pastaj Suzana. Urdhëroni, zotëri...

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje, Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Debati në parim lidhur me politikat buxhetore, projeksionet buxhetore është i rëndësishë së veçantë nëse mundemi ta vlerësojmë drejt se a i përmbush ato objektiva makro-ekonomike. Prandaj, shikuar nga synimet që i ka shtruar Qeveria, unë i përkrah ato, por tash brenda këtij, projeksionet buxhetore mendoj që duhet të kenë sqarime plotësuese dhe të punojmë më shumë deri në leximin e dytë. Duke u nisur nga të hyrat e planifikuara buxhetore për të cilat u dhanë shumë vërejtje këtu, për të mos i përsëritur, dallimet dhe mundësitë reale deri te shpenzimet e planifikuara buxhetore, të cilat po ashtu dallojnë shumë, ashtu qysh u tha këtu, prandaj s'po e përsëris as atë, por do të ndalem në dy çështje themelore që kanë të bëjnë lidhur me politikën e investimeve kapitale dhe politikat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe ambientin për biznes. Kur jemi këtu, atëherë vlerësimet e mia dallojnë dhe mund të ketë rishikime tjera sa i përket vërejtjeve në parim tek ministrinë përkatëse. Bie fjala, te ekonomia dhe financave do të ishte mirë që projektet për hekurudhat prej 3.000.000 eurosh të shikohet edhe mundësia e një projekti ideor për një pjesë, pra vetëm projekti ideor i pjesës së hekurudhës për Ferizaj-Viti-Gjilan. Administrata publike mendoj që është tepër kur mendohet për inventarizim të Rilindjes dhe protokollit apo të Blinajës atje, një motel, të ndahen 5-6 milionë në këtë fukarallëk të madh, ky nuk është prioritet. Prandaj, mendoj që duhet të kalojmë te tregtia, te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për të parë mundësinë e një parku

regjional për biznes, për zhvillim ekonomik, pra parku, bëhet projekti ideor në pjesën Gjilan-Kamenicë -Viti në vend të atyre projekteve me prioritet që i keni vënë ju.

Unë mendoj që u tha, me të drejtë këtu, se është viti i tretë sa u përket politikave të investimeve kapitale, sidomos në sferën e infrastrukturës rrugore dhe investimeve tjera kapitale që u përmendën. Këtu kemi një politikë selektive, pra diferencuese, regjionale dhe komunale, financim i cili nuk balancon zhvillimin harmonik të vendit dhe le të jetë vërejtja që po përsëritet që tri vite. Po të shikoni rehabilitimin e rrugëve prej 60 milionë eurove dhe kategorizimin, rrugë nacionale pajtohem plotësisht që mund të jetë Merdar-Prishtinë, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Ferizaj, por kurrë nuk mund të pajtohem as unë, besoj, asnjë deputet, asnjë qytetar i Kosovës që rrugë me karakter nacional të jetë rruga Bresalc deri në Gadime. Nuk ma merr mendja që është kjo politikë e drejtë, përderisa andej parashihen do të thotë diku me dhjetëra, dhjetëra milionë euro, unë mendoj që duhet të ulemi dhe drejt të shikojmë këtë projekt. Nëse ka rrugë nacionale me interes, ju e dini, Kosova lindore ka një projekt dhe ai duhet të jetë rruga, ose krahu lindor i autostradës Prishtinë-Gjilan-Bujanovc dhe mos të manipulojmë me këso projektesh, se askush nuk është kundër ndërtimit të asaj rruge. Ajo është një rrugë pesë metërshe nëpër mal, por t'i thuhet rrugë nacionale, të lejojë këtë Qeveria, të lejojë ky Parlament, sinqerisht po ju them, unë për veti nuk do të mund ta kaloja kurrë. Pra, s'ka kuptim kjo. Prandaj, lus Qeverinë, lus partnerin në koalicion, lus deputetët që këto të mos përsëriten. Ka mundësi të korrigjohen. Rrugë nacionale është rrugë pra e Kosovës Lindore, arteria për të cilën kemi folur disa herë. Ose kjo të ndryshohet tjetra që u tha, janë tri projekte..., tri vite, më falni. Po t'i shikoni programin për komunat bashkëfinancim, ndërtimin e rrugëve të reja, kjo çon te ajo që Kosova është zvogëluar nga 11.000 kilometra katrorë ka ardhur në 2.000 kilometra katrorë. Ju lutem, korrigjojeni! Nuk është kjo politikë e mirë. Nuk na bën nder, duhet të korrigjohet. Merreni, shikoni, u tha edhe nga kolegët deputetë këtu më herët, unë s'po i përmendi sepse po bëhet tepër disi, por po më duket që po teprohet, por shikoni se ku çon kjo. E keni zvogëluar Kosovën prej 11.000 kilometrave në 2.000 kilometra katrorë, të gjitha investimet përbrenda 3 viteve, qitni milionat, këqyrni sa është investuar në një regjion, sa në regjionin tjetër.

Po ashtu, u tha shumë mirë këtu sa i përket disa ministrive, kur është pyetja ajo e Shëndetësisë, e Rinisë dhe e Kulturës, po ashtu nuk ka projekte të reja për 5 komunat në atë anë. Është vetëm një projekt që bartet nga 2009, apo Ministria e Arsimit, po ashtu që u tha, nga 24 milionë projekte të reja, 60.000 euro për krejt atë komunë, që nuk është korrekte dhe mendoj që Ministria e Ambientit ka një problem të madh....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhepi. Radhën e ka zoti Agim Veliu, të bëhet gati zonja Novobërdali.

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse prioritetet strategjike dhe politike duhet të përcillen me ndarjen e mjeteve financiare, atëherë ky buxhet nuk reflekton prioritetet. Buxheti i vitit 2010 mbetet buxhet shpenzues me qasje jo zhvillimore. Buxheti ka probleme në disa aspekte, probleme në

strukturë dhe në qasje. Mungojnë fondet për financimin e masave për ndërtimin dhe funksionalizimin e arsimit të lartë, për avancimin e proceseve të filluara dhe për zbatimin e autonomisë së shtuar të institucioneve të arsimit të lartë. Në fushën e kërkimeve shkencore nuk ka përkrahje për kurrfarë programi zhvillimor shkencor. Edhe me këtë buxhet Kosova për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe institutet ndahen më pak se 1 milionë euro, çka do të thotë se është 50 herë më pak se mesatarja e Evropës. Nuk ka përkrahje të nevojshme arsimit profesional, arsimit special mbetet në të njëjtën gjendje sikurse në vitin e kaluar. Ngritja e cilësisë nuk garantohet me këtë përkrahje buxhetore. As edhe 1 cent nuk parashihet për ngritjen e kabineteve dhe të laboratorëve në shkollat e mesme të Kosovës dhe në ato fillore. Investimet kapitale në arsim për këtë vit janë të parapara 26 milionë, shumica absolute e këtyre mjeteve janë për objekte shkollore që kanë filluar viteve të mëhershme, por është interesant se parashihet fillimi i 22 objekteve të reja shkollore në Kosovë, pra në vitin 2011 dhe është interesant se këto objekte fillohen me shuma prej 30 deri në 70.000 euro, çka do të thotë gjithsej 1.300.000 euro parashihen që këtë vit të fillojnë ndërtimin e 22 objekteve shkollore. 12 objekte shkollore parashihet të fillohen me 70.000 euro, 4 objekte shkollore me 60.000 euro, 2 objekte shkollore me 50.000 euro dhe 4 objekte shkollore me 30.000 euro.

Ky buxhet vazhdon të ketë shpërndarje jo të drejtë edhe për komunat e Kosovës. Ta zëmë, Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit programin me bashkëfinancim të komunave prej 12.000.000 eurove, 50% e kësaj shume parashihet të investohet në vetëm 4 komuna të Kosovës dhe jam plotësisht dakord me atë që e tha parafolësi, kolegu im, se Kosova po fillon të zvogëlohet, sipas kësaj Qeverie dhe ne të tjerëve, komunave që janë të diskriminuara, na mbetet t'i themi Qeverisë se edhe ne jemi Kosovë. Ministria e Kulturës dhe e Sportit prej 6 milionë eurove investime nëpër komuna, komunën e Podujevës nuk e prek me asnjë cent. Po ashtu, Ministria e Arsimit, janë dy projekte që kanë filluar vitin e kaluar, asnjë objekt i ri shkollor nuk fillohet këtë vit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor prej 5 milionë e 900 mijë, 6 milionë investime kapitale në komunën e Podujevës nuk e parasheh asnjë projekt, po ashtu edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka asnjë projekt për komunën e Podujevës, kështu që unë do t'i paraqes edhe vërejtjet konkrete në procedurat e mëtutjeshme me propozime konkrete për amendamentim, sepse kështu si është, ky buxhet nuk është në rregull. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Veliu! Zonja Novobërdali, le të bëhet gati zoti Zef Morina.

SUZAN NOVOBËRDALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në analizat tona ky buxhet nuk është hartuar në mënyrë profesionale dhe, si i tillë, nuk iu përgjigjet nevojave zhvillimore të Kosovës. Këtu po i përmendi disa argumente, në mënyrë që të merren parasysh nga shumica parlamentare.

E para, për vitin 2010 planifikohet një buxhet i pamjaftueshëm për investime kapitale. Ndërhyrja nga ana e buxhetit të Kosovës për ndërmarrje publike, pa një kusht paraprak që

këto ndërmarrje të tregojnë performancë të mirë në planet e tyre biznesore, buxhetin e Kosovës po e çojnë drejt një qorrrokaku, me çka ndërmarrjet publike po bëhen të varura nga ky buxhet.

Së dyti, në Ministrinë e Kulturës është një numër shumë i madh i të punësuarve të rregullt që paguhet nga subvencionet dhe ky numër shkon gati mbi 200 persona. Po ashtu, një pjesë e mirë e buxhetit shpenzohet edhe në konsulencë ndërkombëtare, kështu pra kemi një rritje të shpenzimeve për paga dhe mëdijtje, pa përmendur nevojën që është paraparë edhe për ngritjen e institucioneve tjera.

Së treti, ky projektbuxhet nuk realizon premtimet e kësaj qeverie dhe këtu po përmend vetëm një sektor, në të cilin është bërë shumë zhurmë, e që është sigurimi i cilësisë në arsim. Shikoni mirë grafikonet dhe do të shihni sa është investuar në këtë drejtim. Akoma shumica e buxhetit po shkon në drejtim të ndërtimit të shkollave, ka edhe tenderë, ku në këta tenderë dikush diçka përfiton.

Së katërti, kjo Qeveri mes tjerash ka fituar pushtetin duke premtuar se do të ulë shpenzimet për mallra dhe shërbime. Po të shihni kolonën e mallrave dhe të shpenzimeve, shihet se nuk ka ulje, me çka po e zvogëlon aftësinë e buxhetit që do të ndikojë më shumë në kategoritë shoqërore.

Edhe ky buxhet nuk e trajton si duhet rininë e Kosovës. Dhjetë herë më shumë shpenzohen para për telefona të kabinetit qeveritar, se sa ndahen për rininë e Kosovës. Buxheti i cili po rritet për rininë, është vetëm 10 centë për kokë të një të riu në vit. Po ashtu, me këtë buxhet nuk parashihen rritje të pagave për policë, punëtorë shëndetësorë, gjykatës e prokurorë, e sidomos rritje pensionesh për pensionistët tanë. Me fjalë tjera, ky buxhet nuk krijon mundësi zhvillimi, por varfërimi, nuk është buxhet i rinisë, por i tenderëve dhe i ndërmarrjeve publike. Edhe në këtë vit për KEK-un ndahen 50.000.000 euro. Deri kur ky buxhet do të përdoret për të mbajtur shpirt për ato ndërmarrje të cilat nuk e kanë jetën e gjatë, sepse janë para privatizimit apo koncensionimit.

Edhe unë, sikur edhe Grupi im Parlamentar, nuk do të mbështes këtë projektligj për buxhetin, sepse nuk i përmbush as 50% të asaj çka ju premtuat me të madhe e që, aq më pak, nevojat elementare të qytetarëve nuk i përmbushni me këtë buxhet, sepse ata kanë nevojë për një seriozitet më të madh nga ana juaj dhe ata presin dalje nga varfëria që po e kaplon Kosovën çdo ditë e më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Novobërdali! Radhën e ka zoti Zef Morina, të bëhet gati zoti Gjini, para Armend Zemajt.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Projektbuxheti për vitin 2010 është përgatitur në mënyrë profesionale nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili paraqet kërkesat programore të agjenciioneve

shpenzuese, të institucioneve të Republikës së Kosovës duke filluar nga Parlamenti, Presidenca, Qeveria e deri tek kuvendet komunale. Është inkurajues fakti që për vitin 2010 ka rritje të shpenzimeve kapitale në vlerë rreth 400.000.000. Pra, rreth 1/3 e buxhetit të përgjithshëm.

Rreth $\frac{1}{4}$ e buxhetit është planifikuar t'u ndahet komunave, që tregon se ende komunat nuk janë në gjendje të gjenerojnë të hyra vetjake të mjaftueshme për zhvillimin e qëndrueshëm të komunave. Transporti dhe infrastruktura edhe për vitin 2010 parashihet të kenë investime të duhura në infrastrukturën rrugore në vlerë prej rreth 121.000.000 euro të orientuara kryesisht në rrugët magjistrale dhe regjionale, përfshirë edhe autostradën që lidh Republikën e Kosovës me Republikën e Shqipërisë. Mjetet për bashkëfinancim me komunat në vlerë prej rreth 12.000.000 euro, që në tërësi është rreth 10% nga buxheti i Ministrisë, mendoj se janë të pamjaftueshme sepse rrugët lokale janë ende në gjendje jo të mirë. Kemi shumë qytete dhe fshatra me rrugë të paasfaltuara. Kërkoj nga Ministria që shpërndarjen e grave ta bëjë në mënyrë të drejtë duke u bazuar në projektet dhe mbështetjen financiare që komunitetet dhe komunat i ofrojnë Ministrisë.

Për rindërtimin dhe rehabilitimin e urave janë ndarë vetëm 3.000.000 euro. Mendoj se kjo vlerë duhet rritur, sepse është e pamjaftueshme. Vetëm ura e cila është në gjendje jo të mirë statike, pra ura e Tabakut, që lidhë dy rrugët me Shqipërinë, kushton 3.000.000 euro, ndërsa kemi edhe shumë ura të cilat kanë nevojë të rehabilitohen dhe të rindërtohen.

Hekurudhat. Për hekurudha janë ndarë mjetet shumë të pamjaftueshme duke pasqyruar gjendjen e hekurudhave të Kosovës, veçanërisht gjendjen e binarëve dhe kryqëzimin e hekurudhave me rrugët automobilistike.

Mjetet e dedikuara për sigurimin e barnave në sektorin e shëndetësisë, për barnat esenciale në vlerë prej 20.000.000, është inkurajuese që vendi nuk do të ketë mungesë të këtyre ilaçeve.

Mendoj që për shërim jashtë vendit është dashur të ketë mjete të veçanta dhe të mjaftueshme, duke pasqyruar parasysh që për sëmundje të caktuara, të cilat nuk mund të kurohen në Republikën e Kosovës, pacientët duhet të shkojnë jashtë vendit për shërim, kurse ata që nuk kanë mjete mbesin pa shpresë për t'u shëruar.

Për QKUK mendoj se duhet të ndahen mjete më tepër për investime kapitale, duke pasqyruar parasysh gjendjen teknike të spitaleve të QKUK-së. Gjithashtu, edhe për punonjësit e sektorit shëndetësorë duhet të ndahen minimum 2.7 milionë euro për kompensim të punëve jashtë orarit dhe shtesave të tjera.

Sektorit të arsimit i është dhënë rëndësi e duhur si në investimet kapitale, ashtu edhe në mundësinë e krijimit të kushteve më të mira për inkurajimin e kuadrove profesionale, të profesorëve me kualifikime të larta, por mendimi im është që për mësimdhënësit e arsimit të mesëm dhe të ulët duhet të ketë ngritje të ardhurave, sepse në këtë mënyrë niveli i

mësimi do të jetë më i lartë dhe me pagat e tilla sigurisht se nuk do të kemi cilësi në mësim.

Sektorit të bujqësisë kësaj radhe i janë ndarë 3.000.000 euro më shumë nga viti 2009, por për stimulim më të mirë të këtij sektori është dashur të ndahen mjete më tepër, të paktën 10.000.000, sepse në këtë mënyrë do të mundësonim që bujqit dhe fermerët të krijojnë ekonomi familjare, me ç'rast do të krijohen vende të punës.

Buxheti për mirëqenie sociale ka ngritje, i cili sadopak mund t'u ofrojë mbështetje shtresave të nevojshme të shoqërisë, duke përfshirë edhe pensionistët edhe pse pensionistët nuk janë të trajtuar si duhet, por kjo duhet të rregullohet me ligj.

Në përgjithësi, Projektbuxheti i vitit 2010 është në kuadër të plotësimit të kapaciteteve të shoqërisë kosovare, andaj unë si deputet e mbështes projektbuxhetin duke shprehur se këto vërejtje në leximin e dytë do të implementohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zef! Fjalën e ka zoti Gjini, le të bëhet gati zoti Zemaj.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë rrallë kam mundësi të flas si deputet për shkak se jam kryetar i Grupit Parlamentar dhe sot do të provoj të flas pak, edhe sikur deputetët tjerë të flas pak edhe për vendin prej nga vi, për buxhet.

Tani aspekti për të cilin do të flas është ky: Shtetet më të fuqishme në botë, më të zhvilluara në botë janë asisoj për shkak se kanë arritur të krijojnë solidaritet në mes njerëzve, jo në mes regjioneve, jo në mes njerëzve të regjionit, por në mes njerëzve të gjithë vendit. Vendet që kanë krijuar asi solidariteti, nuk po flas për lëmoshë, por po flas për ndjenjat solidare të njerëzve në gjithë vendin, ato janë vende më të zhvilluara. Vendet ku nuk ka solidaritet në mes njerëzve të regjioneve brenda shtetit, janë vendet më të dështuara, janë vendet më të dobëta në botë. Nëse dyshoni në këtë që e thashë, mund të gjeni shembuj sa të doni, është shumë lehtë, shumë lehtë. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë është se buxheti është vendim politik. Kemi dëgjuar shpesh këtu, edhe herën e kaluar na ka thënë dikush – mos e politizoni. Çka do që vendoset në Kuvend të Kosovës, është 100% politik dhe s'ka qysh të politizohet. Është njëjtë sikur të thuhet mos e lagni ujin. Është politik 100% dhe s'ka qysh të politizohet. Tani vendimi politik mundet të jetë i mirë ose i keq. Edhe Qeveria, gjithmonë Qeveria nacionale, Qeveria qendrore ka obligim të ndikojë përmes buxhetit, përpos politikave tjera, po esencialisht përmes buxhetit që të ndërtojë këtë homogjenitet, këtë solidaritet për ta bërë shtetin më të mirë.

Tani po ju jap një ose dy shembuj, se cili është solidariteti që ndërtohet përmes këtij buxheti. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, i ndanë diku 5.3 milionë euro investime për komunën e Skenderajt për vitin 2010, i ndanë 500.000 për Gjakovën. Nëse

e shihni numrin e banorëve dhe këtë dhjetëfishim, del që për 1 banor në Skenderaj Qeveria e Kosovës investon 20 herë më shumë se për 1 banor në Gjakovë.

Tash unë po ju pyes juve, a është e drejtë? A mendoni ju që kjo është e drejtë të mendohet kështu? Sa për t'ju treguar që s'kemi kurrë kundër, unë mund t'ju them se kur kam qenë ministër, për një vit kam investuar 1 milionë në Skenderaj, 400.000 në Gjakovë. Unë e di që duhet në Skenderaj të investohet, ama jo 20 herë më shumë, Jo 20 herë më shumë! Merrni listën, shihni projektet. Ose këqyrni Gjakovën, këqyrni Deçanin, më falni, lëne Gjakovën, këqyrni Deçanin, zero, asnjë euro. A është drejt? A ndërton kjo mënyrë solidaritet në mes njerëzve, në mes shtetasve? S'po shkoj tjetër kund.

Dhe, pjesa e dytë, për të mos e zgjatur shumë, ka të bëjë me këtë që po dëgjojmë. Tani është hera e tretë që dëgjojmë prezantim për buxhet dhe kurrë nuk e dimë saktë sa është buxheti, a është 1.4 miliardë, a është 1.1 miliardë. E në dokument e kemi 1.1 miliardë, neve na thonë 1.4 miliardë. Tani na e dimë që populli i Kosovës nuk e lexon buxhetin, por mos t'i konfuzojmë, bre. I kemi listat përpara. Qysh 1.4 miliardë, kur ne e kemi përpara nesh 1.1 miliardë.

Tema e parë, a duam një herë bile të jemi të saktë çka po flasim, a duhet gjithmonë t'i kamuflojmë, t'i mbështjellim diqysh që askush mos të marrë vesh çka po bëhet.

Çështja tjetër është, cila bazë tatimore është rritur? Shihni kolonat! Shihni listat! Ku është rritur baza tatimore? Ku janë rritur tatimet? Çfarë baze tatimore është rritur në Kosovë. Prapë e dimë që populli nuk e lexon, veç na vyen neve këtu. Hajde, ne po flasim vetë, ku jeni kah e shihni ju atë rritje të bazës tatimore?

Çështja tjetër është, e fundit, cilat janë elementet ose komponentët e buxhetit që na tregojnë që ky është buxhet zhvillimor. Dikush thotë në foltore, ka komponentë të qarta që tregojnë se ky është buxhet zhvillimor. Unë po pyes, cilat janë ato komponentë. Vetëm një, a di dikush një komponent zhvillimor të buxhetit të ma thotë. Miq të mi, nuk ka! Nuk ka! Nuk ka as luftë pa kompromis kundër korrupsionit që e rritë buxhetin, nuk ka, as komponentë zhvillimor, nuk ka, as buxhet 1.4 miliardë, nuk ka, as rritje të bazës tatimore, nuk ka asnjë send që ne e kemi dëgjuar sot këtu. Krejt janë kontra prej asaj që ne e shohim, qoftë edhe në dokument, e lëre më në jetë, në jetë të përditshme.

Unë me këtë mendoj se duhet ta përfundoj. Po pyes edhe një herë, le t'më tregojnë sa është buxheti, se është mirë ta dimë këtu ne, para se të dalim prej kësaj salle. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini! Fjalën e ka zoti Zemaj, të bëhet gati zoti Rugova.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!
Zoti kryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Unë pak do ta ndërroj mënyrën e diskutimit. Nuk do të jap komente vlerësimi, por kam disa pyetje, kështu që i lus edhe kryeministrin edhe ministrat ta kenë lapsin nëse munden më vonë edhe të më përgjigjen.

Po filloj me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, krijimi i të hyrave dhe shpenzimeve e arsyeshme. Zoti ministër, mua më intereson të di më shumë për arkat fiskale. Keni paraparë një ndarje prej 200.000 eurosh. A është paraparë pagesa e borxhit të jashtëm?

Fondi për kuadro 1.100.000, mund të na thoni ndonjë shembull edhe si e keni planifikuar shpenzimin e tyre?

Rinia, 535.000 euro – subvencione. Nuk kam çka të shtoj koment, por është edhe një çështje tjetër – zgjidhja e çështjes së punëtorëve me kontratë në vepër.

Ministria e Drejtësisë, obligimi ligjor për implementimin e ligjit. Për shembull, formimi i Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar, funksionalizimi i shërbimit korrektues. Nuk ka rritje të pagave të oficerëve dhe nuk dallojnë prej njerëzve tjerë me uniformë. Në këtë rast unë e kam një vërejtje, sepse njerëzit ikin nga burgu me duar lirë, këtu shkaku është mendoj edhe te çështja e pagesës, nëse keni këtu ndonjë përgjigje.

Laboratori toksikologjik është paraparë, zonja ministre, në vitin 2012 të funksionalizohet, ndërsa ne kemi pasur rastin e fundit kur u paraqit një lloj apo improvizim i helmimit apo helmim i vërtetë dhe na është dashur që analizat të dërgohen prapë jashtë vendit.

Ministria e Punëve të Brendshme, prodhimi i dokumenteve. A do të kemi pasaporta biometrike në vitin e ardhshëm dhe a hyjnë këto shpenzime, a janë paraparë këto shpenzime?

Çështja tjetër, te komuna Mitrovicë, rindërtimi i shtëpive të djegura, në dy pozicione paraqitet, për vitin 2010, për 20011 dhe është – renovimi dhe pajisja e ambulancës së shkollës fillore “Branko Radiqeviq” kodi 810.80. Në shkollat tona defilojnë nga 3.000 nxënës në ditë dhe së paku nuk kemi psikolog, unë nuk e di çfarë ambulance dhe çfarë mjekësie është në atë shkollë fillore atje. Faleminderit! Këto ishin pyetjet që kërkoj përgjigje.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Radhën e ka zoti Rugova, të bëhet gati zoti Kervan.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Po e diskutojmë sot Projektligjin mbase më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Edhe nga ekspozēja e kryeministrit të vendit, po edhe ministrit shohim diskrepancë dhe mospërputhje në statistika. Zoti ministër, duhet të keni kujdes, sepse kjo shkakton konfuzion jo vetëm tek ne, por edhe te qytetarët. Kosova, thotë, do të ketë një rritje të projektuar ekonomike prej

mbi 4.0% gjatë vitit 2010. Në bazë të cilëve parametra dhe si do të arrihet kjo rritje ekonomike? Rritja ekonomike nuk arrihet kurrë me një buxhet të tillë që i mbulon nevojat e shërbyesve civilë, mallra dhe shërbime dhe me investime kapitale, të cilat për këtë vitin që po e lëmë prapa, nuk janë përmbushur as 50%.

Pastaj, më intereson të dijë, 20.000.000 euro për autostradën Merdar-Vërmicë tani. Cilat janë arsyeshmëritë, a është bërë ekspropriimi i pronave dhe si mund të fillojë ky projekt pa u definuar në mënyrë ligjore të gjitha ato që duhet të kryhen për fillimin dhe jetësimin normal të këtij projekti të rëndësishëm nacional.

Pastaj, tek energjia. 50.000.000 euro subvencione për sektorin e energjisë. Duam t'i kuptojmë këto. Ministria nuk qenka këtu, por çfarë garancie ju ofron ky buxhet dhe këto subvencione qytetarëve të Kosovës që do të kenë rrymë 24 orë, që ishte proklamuar e trumbetuar me të madhe këto 22- 23 muaj të kësaj qeverie dhe kur do të fillojë projekti "Kosova e Re" i cili po prolongohet që 2 vite dhe qytetarët e Kosovës, po mbase edhe gjysma e kabinetit qeveritar nuk kanë ide se çka po ndodh dhe kah po orientohet ai projekt.

Në shëndetësi, 20.000.000 euro për listën esenciale të barnave. Çfarë shëndetësie kemi, çfarë sistemi shëndetësor kemi, qysh po furnizohen institucionet shëndetësore me barna, mos të flasim për pacientë të lodhur të Kosovës. Edhe këtu mirë që është rritur buxheti për barnat, por nuk kemi përmirësim të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe nuk kemi furnizim me pajisje dhe shfrytëzim të këtyre 20 milionëve nga pacientët e lodhur të Kosovës. Sa për kushtet e punëtorëve shëndetësorë, edhe atë 44-eurshin që e keni premtuar, nuk po implementohet, ua keni lënë barrë komunave dhe po ka një diskrepancë të madhe.

Te mirëqenia sociale, cila është kjo mbështetje e njerëzve që janë të kategorive sociale të rrezikuara. Ku është buxheti për Ligjin për pensionistët që u premtuan me aq të madhe. Ku është buxheti për implementimin e Ligjit të punës dhe me këtë buxhet vetëm sa do të përkeqësohet kriza e rëndë sociale në vend dhe do të rritet varfëria. Për aspektet e krijimit të vendeve të reja të punës as që diskutohet, sepse që 2 vite gati të këtij buxheti asnjë cent i investimeve të huaja direkte nuk është investuar në Kosovë.

Kur është çështja te bujqësia, si një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, me 4.5 milionë euro subvencione për mbështetjen e bujqësisë nuk do të bëjmë asgjë. Është edhe ministri i Bujqësisë këtu, i cili është shumë i vetëdijshëm që me këtë buxhet nuk ka zhvillim të këtij sektori dhe të nënsektorëve tjerë që janë kushti themelor për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Sepse, edhe në agjendën evropiane parashihet që Kosova mund të konkurrojë dhe mund të depërtojë në tregun evropian vetëm me produkte bujqësore dhe me zhvillimin e këtij sektori, si dhe në sferën e ambientit dhe të mbrojtjes së mjedisit, ku kemi vetëm ndërtime të impianteve të ujërave të zeza dhe ndërtimin dhe pastrimin, rregullimin e disa shtretërve të lumenjve dhe asgjë konkrete në zonat e mbrojtura, në parqet nacionale dhe në zhvillimin e turizmit, eko-turizmit dhe respektimin dhe ndarjen e mjeteve për Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

Në përgjithësi, ky projektbuxhet jam skeptik që do të arrijë rritje ekonomike 4.0% dhe jam skeptik që këto investime kapitale prej 400.000.000 eurove do të mund të jetësohen pikë për pikë, sepse kemi ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rugova! Fjalën e ka zoti Kervan, le të bëhet gati zoti Ramadan Avdiu.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithë!

Unë do të flas vetëm për dy pika, të cilat mendoj se nuk janë shumë të qarta dhe natyrisht se dëshiroj pak sqarime.

E para, është lidhur me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përkrahja institucionale për kulturë, çështja e objektit të Ansambllit “Shota”, për të cilin parashihen 180.000 euro për ndërtimin e objektit. Absolutisht pajtohemi dhe e përkrahim ndërtimin e këtij objekti, por ku do të jetë pjesa tjetër e ligjit, i cili e garanton edhe për ansamblet tjera. Kur them ansamblet tjera, ansamble të cilat më tepër i përfaqësojnë komunitetet jo shumicë dhe të cilat janë të garantuara me këtë ligj.

Prandaj, për zbatimin plotësisht të këtij ligji a do të jetë diçka shtesë për ansamblet tjera, në këtë rast për komunitetet jo shumicë, apo edhe ansamblet tjera do të përdorin të njëjtin objekt, por në qoftë se përdorin të njëjtin objekt, mendimi im është që 180.000 euro nuk mjaftojnë për një objekt që i përfshin të gjitha ansamblet.

Pika e dytë, është lidhur me Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me Departamentin për përdorimin e dokumenteve. Në projektligjin në gjuhën shqipe thotë, avancimi i sistemit të letërnjoftimeve dhe pasaportave, kurse në gjuhën serbe flet vetëm për letërnjoftimet e jo për pasaportat, prandaj edhe ky duhet të harmonizohet. Dhe është dhënë një shifër prej 1.400.000 euro, do me thënë projekti nga vazhdimi i vitit 2009, kurse e njëjta shifër parashihet edhe në Buxhetin 2010. Prandaj, pyetja ime është që a do të zbatohet Ligji për letërnjoftime dhe për dokumente të udhëtimit apo të pasaportave, sepse kur është çështja për zbatimin e këtyre ligjeve, në vitin 2009 kemi pasur probleme lidhur me nenin 9 të këtij ligji, sepse ende dokumentet e udhëtimit, formularët dhe letërnjoftimet, mbishkrimet e letërnjoftimeve nuk parashohin gjuhën turke, e cila është e garantuar me ligj, prandaj ligji nuk zbatohet. Në këtë Kuvend dhe nëpër komisionet parlamentare të Kuvendit ministri i Punëve të Brendshme na ka shpjeguar zyrtarisht që problemi është vetëm te mungesa e buxhetit për të përfshirë këtë, për të zbatuar ligjin. Prandaj, nuk ka rritje në këtë shifër e cila parashihet edhe për vitin 2010. A do me thënë kjo që edhe në vitin 2010 qytetarët tanë nuk do të marrin letërnjoftimet ende në gjuhën turke, me mbishkrime në gjuhën turke, që e garanton ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kervan! Zoti Avdiu e ka fjalën, le të bëhet gati zonja Qamile Morina.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,
Kolegë të respektuar deputetë,
Materialin që po e shqyrtojmë sot pa dyshim se është materiali më i përgatitur ndonjëherë i ardhur në Kuvend lidhur me buxhetin jo vetëm nga ana formale, por edhe nga ana përmbajtjesore e tij.

Unë dëshiroj që diskutimin tim ta përqendroj në disa pika. Duke pasur parasysh se organizatat buxhetore, kërkesat e tyre i kanë bërë me shuma shumë më të mëdha se sa që realisht ka pasur mundësi t'u shpërndahet, unë e vlerësoj punën e hartuesve të buxhetit në shpërndarjen proporcionale të mjeteve financiare për të gjitha organizatat buxhetore si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal.

Dëshiroj të theksoj lidhur me Prishtinën që u ngrit se Prishtina është e anashkaluar tek ndarja buxhetore. Ky konstatim nuk qëndron sepse 2/3 e buxhetit të komunës së Prishtinës janë grande qeveritare, kurse Prishtina ka kapacitete dhe ka mundësi shumë më të mëdha të gjenerimit të hyrave vetjake, kështu që ajo nuk qëndron sepse edhe investimet nga buxheti i këtij viti ose edhe nga viti paraprak, të vitit të kaluar, shihet se ka pasur një shumë të konsiderueshme të investuar në territorin e komunës së Prishtinës, prandaj do të duhet t'i kushtohet vëmendje. Edhe për komunat tjera që u ngrit, qoftë për Deçan, për shembull, ku thuhet është zero euro, nuk qëndron. Nuk qëndron sepse 4.500.000 euro janë të hyra, domethënë janë grande qeveritare, kurse vetëm 500.000 euro Deçani ka të hyra vetjake. Prandaj, unë dëshiroj t'i theksoj këto shifra në mënyrë që të mos shfrytëzohet foltorja e Parlamentit për krijim të konfuzionit në opinionin publik ose edhe për shtrembërim të fakteve.

Ajo çka nuk u theksua dhe unë dëshiroj ta potencoj, që Qeveria do të duhej t'u kushtojë më shumë rëndësi investimeve në pjesën verilindore të Kosovës, ku veçanërisht Ministria e Ambientit do të duhej të përqendrohet dhe t'i kushtojë rëndësi më të madhe menaxhimit të ujërave, sepse ujërat janë duke shkuar drejt një degradimi. Rast konkret e marrim liqenin e Batllavës. Rast konkret e marrim liqenin e Batllavës, domethënë në liqenin e Batllavës nga i cili 1/3 e Kosovës furnizohet me ujë të pijshëm, është duke shkuar drejt degradimit në mungesë të një kanalizimi për trajtimin e ujërave të zeza të Orllanit i cili nuk ka, po ashtu Orllani nuk ka ujë të pijshëm. Domethënë e furnizon jo vetëm Prishtinën, por edhe Besianën, edhe një pjesë tjetër Obiliqin, Fushë-Kosovën, Lipjanin e furnizon me ujë, kurse vetë qytetarët që jetojnë në brigjet e liqenit të Batllavës nuk kanë ujë të pijshëm. Për këtë do të duhej të kujdeset Qeveria më shumë, e gjithashtu edhe në infrastrukturën rrugore, në pjesën veri-lindore që është një pjesë shumë strategjike dhe jashtëzakonisht e ngelur mbrapa në krahasim me pjesët tjera të vendit, do të duhej t'i kushtohet rëndësi zhvillimit të infrastrukturës. Rast konkret është rruga e cila u përmend më herët nga Stallova, Koliqi e Dyzi, që është një arterie shumë e rëndësishme që e lidh Gollakun me Llapin, por edhe me Karadakun, me atë pjesën... domethënë e lidh një brez të tërë që është, mund të them, edhe brez kufitar ku ajo pjesë e vendit tonë që janë 11% të territorit të Kosovës, është thuaja se e boshatisur në mungesë të infrastrukturës dhe në mungesë të projekteve të Qeverisë që do të duhej të jetë më e koncentruar në atë pjesë. Veçanërisht Ministria e Ambientit, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Transportit dhe

Telekomunikacionit do të duhej që të kenë projekte më shumë dhe të bashkëpunojnë me komunën, sepse edhe komunës i kanë munguar projektet lidhur me atë pjesë të vendit.

Në përgjithësi, buxheti është i hartuar mirë, ka një shpërndarje proporcionale, ekzistojnë kriteret se si bëhet shpërndarja e mjeteve nëpër komuna, kështu që ne e mbështesim dhe mund të them se efektet e shpenzimeve të buxhetit të Republikës së Kosovës më së shumti janë parë këto dy vitet e fundit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Avdiu. A ia ka përmendur emrin dikujt? Në qoftë se s'e ka përmend emrin, për fat të keq, nuk mundeni. Zonja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Projektbuxhetin e konsideroj si dokument më të rëndësishëm që miratohet në Kuvend ngase me të sigurohet baza materiale e shtetit dhe kjo kërkon përgjegjësi të lartë para qytetarëve tanë. Mirëpo, edhe këtë vit koalicioni qeverisës si duket nuk po krijon strategji të zhvillimit ekonomik që po e vërteton përmes këtij projektbuxheti, i cili do të duhej të krijojë bazë për zgjidhjen e problemeve, si luftimi i varfërisë, rritja e shkallës së punësimit, stimulimi i rritjes ekonomike, si dhe ngritja e cilësisë së sistemit shëndetësor çfarë e meritojnë qytetarët tanë. Ky projektbuxhet që ofrohet sot për miratim, nuk mund të quhet buxhet që do të bëjë reforma, por më tepër do të ruajë status-kuon në mënyrë që të mos shkaktohen trazirat sociale dhe thjeshtë nuk do të ofrojë zhvillim për vendin tonë.

Ngritja e buxhetit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbi 7-8 milionë krahasuar me vitin e kaluar do të kërkojë monitorim dhe reformim të programeve pensionale në mënyrë që të krijohet mundësi për qëndrueshmëri fiskale.

Vërejtjet e mia kryesisht do të përqendrohen më tepër sa i përket projektbuxhetit që ka të bëjë me sistemin shëndetësor. Buxheti në përgjithësi, edhe pse u tha që ka ngritje të buxhetit, mirëpo buxheti në përgjithësi për shëndetësi është më i ulët krahasuar me vitin e kaluar ngase me rishikimin e buxhetit për vitin e kaluar, buxheti për shëndetësi ka qenë mbi 74 milionë, kurse në këtë vit është 71 milionë. Edhe një herë koalicioni qeveritar po dëshmon se shëndetësinë nuk e ka prioritet dhe as që ka indicie për reforma të sistemit shëndetësor.

Ky projektbuxhet nuk sjell asgjë të mirë për shëndetësinë kosovare, po përsëritet e kaluara, nuk ka prioritete dhe racionalitet gjatë planifikimit të buxhetit. Një pjesë e madhe e buxhetit, është paraparë për furnizimin me barna për QKUK dhe spitalet rajonale. Ky buxhet do të jetë 20.000.000 euro, mirëpo edhe këtë vit e kemi pas 20.000.000 euro buxhetin për barna pas rishikimit të buxhetit dhe kurrë më pak nuk kemi pasur barna se sa këtë vit. Prandaj, rritja e buxhetit nuk është fare garanci se do të kemi furnizim më të mirë me barna për pacientët tanë. Në këtë mënyrë të organizimit të sektorit farmaceutik nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, duke filluar nga furnizimi, deponimi, distribuimi dhe shpenzimi i barnave dhe po ta kemi buxhetin 50 milionë për barna, problemet do të ishin të njëjta. Problemet e mëdha që po e përcjellin sektorin

farmaceutik ka vite me radhë që po identifikohen nga institucionet relevante dhe po propozohen rekomandime që, fatkeqësisht, asnjëherë nuk u zbatuan nga Ministria e Shëndetësisë.

Si investim për vitin 2010 parashihen pajisje për intervenim emergjent në radiologjinë kosovare. Ky projekt kalon të gjitha kufijtë e arsyeshmërisë dhe është tejet cinik për qytetarët dhe profesionistët e mirëfilltë. Zoti ministër nuk është këtu, mirëpo deputetë të nderuar, për këtë projekt vitin e kaluar kemi shpenzuar mbi 5.000.000 euro. Është ble CT funksionale e cilësisë më të lartë që ka Kosova dhe rajoni, është blerë rezonanca magnetike dhe akseleratori i dytë ende pa u fut në përdorim akseleratori i parë dhe çka po ndodh? Asnjë nga kjo aparaturë nuk është në shërbim të pacientëve tanë dhe pacientët tanë edhe më tej po kërkojnë trajtim jashtë vendit dhe Ministria e Shëndetësisë po shpenzon shumë të holla për trajtimin e këtyre pacientëve jashtë vendit. Kjo dëmton pacientët tanë dhe ekonominë e vendit me miliona euro të ngujuara në aparaturë që nuk funksionon dhe shpenzime të larta për trajtim jashtë vendit, andaj dështimi i këtij projekti të interesit të lartë kombëtar kërkon urgjentisht vëmendjen e koalicionit qeveritar.

Projekti tjetër që parashihet me projektbuxhet të vitit 2010 është zhvillimi i sistemit informativ, sistem pa të cilin askush ...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, e keni të drejtën 2 minuta, sepse Rregulla 22 thotë se në qoftë se i referohet diskutimit, ka të drejtë replike. Po kërkoj falje! Urdhëroni!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke u bazuar në atë rregull, desha t'i them zotëri Avdiut, sa herë të diskutoj, mundohem mos të diskutoj pa fakte. Nëse ka ai tjetër buxhet ose projektligj, është çështje e tij. Prej 45 projekteve për bashkëfinancim në infrastrukturë rrugore, asnjë projekt nuk e ke të komunës së Prishtinës. Zoti Avdiu, merre shikoje tabelën, asnjë projekt nuk është në komunën e Prishtinës. Shikoje, e nëse nuk e ke, unë ta jap atë pjesë të projektligjit dhe atë që e kam thënë, e kam thënë bazuar në fakte dhe në atë që unë i kam parë, prandaj nuk është mirë t'iu qitet mjegull qytetarëve, sepse vërtet nëse unë kam gabuar, unë do ta pranoj gabimin, por po ju them, tekstualisht, shikoni, 45 projekte janë të planifikuara me bashkëfinancim, asnjë projekt nuk është për Prishtinën.

Po ashtu, nuk është e vërtetë që s'ka pasur projekte. Unë i paraqita kërkesat e komunës së Prishtinës, këtu janë, që i kanë edhe projektet, por nuk është interesuar për këtë, sepse nuk e kanë ditur kush.... Për Prishtinën u krye, edhe katër vjet. Është mirë të përkrahet komuna e Prishtinës sepse është kryeqyteti ynë, prandaj këto që i thotë, asnjë cent mjete të zotuar nuk ka pasur suficit. Qeveria ka pasur suficit, nuk ka pasur komuna e Prishtinës, nëse ka aludime edhe të tilla. Unë po flas, i kemi kërkesat me projekte që s'janë mbështetur me asnjë cent për komunën e Prishtinës. Prej 45 projekteve, po e përsëris, për Kosovë, bashkëfinancim, asnjë projekt i vetëm nuk është për Prishtinën. Kjo është ajo.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdiu, e keni një minutë kundër replikë.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit! Kryetari i Komisionit për Buxhet në fillim e theksoi që ndoshta Ministria gjatë hartimit të buxhetit është dashur t'i shoh organizatat buxhetore të cilat nuk kanë qenë në gjendje ta shpenzojnë buxhetin e tyre. Lidhur me Prishtinën, zoti Beqiri, 31 milionë e 837 euro janë grande qeveritare, 19 milionë e 555.000 janë të hyra vetjake të komunës. Ju e dini që edhe unë jam i Prishtinës, domethënë jam i ... gjeneratës. Siqeva, Sharbani janë në komunë të Prishtinës. Është një projekt i cili..., domethënë e shihni, edhe unë e kam atë material që e keni ju dhe Siqeva e Sharbani janë në komunë të Prishtinës, aty do të ndërtohet rruga dhe unë do të insistoj që edhe rruga Koliq-Dyz të asfaltohet. Sigurisht se gjatë rishikimit të buxhetit këtë duhet ta kalojmë ne, sepse është me rëndësi dhe rrugë shumë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Avdiu! Unë po ju paralajmëroj se zoti ministri në fjalën e vet përmbyllëse do t'i referohet këtij diskutimi me sqarimet e veta dhe tani në radhë është zoti Sadik Idriz, të përgatitet edhe zonja Mimoza Ahmetaj, para se të shkojmë në një pauzë prej një orë e gjysmë. Urdhëroni, zoti Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna Grupa „7+“ je u najavi rekla da će podržati ovaj budžet i mi ćemo tako znači postupiti. Želim da ukažem na neke stvari u projekciji budžeta iz ugla manjinskih zajednica. Smatram da prisustvo Vlade, odnosno ministarstava u sredinama u kojima žive manjinske zajednice je dokaz da Vlada i institucije Kosova imaju evropski pristup po pitanju manjinskih zajednica. Koliko god su ulaganja u sredinama gde žive manjinske zajednice, to je veći kredit Vlade i to je samo na dobitku Vlade.

Želim da komentarišem neka ministarstva, odnosno budžet pojedinih ministarstava. Mislim da Ministarstvo za zajednice i povratak, projekti za zajednice od 2 miliona i 30.000 mislim da bi trebao da ta stavka bude više pomoć zajednicama, ne pojedincima i ne vladinim organizacijama koje dobijaju projekte, nego da to bude pomoć infrastrukturnim objektima gde žive zajednice, tamo gde ne stiže od opštinskih sredstava ili nekih drugih ministarstava, da to bude podrška, ne da to budu kao u prošlom periodu raspodela sredstava pojedincima, nevladinim organizacijama gde se stvaraju problemi na terenu. Mislim da su sredstva za ovo ministarstvo skromna na istom nivou, a da su potrebe značajne.

Ministarstvo za administraciju lokalne vlasti ili uprave ima jednu stavku koja govori o izgradnji mesnih zajednica i mislim da tu treba pažnja da se posveti i sredinama u kojima žive manjinske zajednice. Sredstva koja je prošle godine Ministarstvo poljoprivrede delilo kao subvencije za stočare i za poljoprivrednike, mislim da trebaju da se pojačaju jer je to bio nakon rata najznačajniji podstrek za naše poljoprivrednike i stočare koji su bili potpuno zaboravljeni i mislim da je to imalo pozitivnih efekata i da to treba da se nastavi i u narednom periodu.

Što se tiče Ministarstva zdravlja, mislim da je 20 miliona za nabavku lekova sa esencijalne liste značajna stavka. Možda je i prošle godine sa rebalansom bila tolika. U poredjenju sa peirodom kada sam ja bio ministar, to je bilo negde oko 6-7 miliona, to je značajan porast, sigurno da će i snabdevenost biti na boljem nivou. Međutim, kada su u

pitanju projekti iz primarne nege, nemamo nijedan projekat koji je ovde predvidjen za sredine u kojima žive manjine. Postoji program za manjine, međutim on nije za kapitalne investicije već samo za plate i mislim da Ministarstvo zdravlja bi trebalo na neki projekat, svake godine barem po jedan projekat centara familjarne medicine u sredinama u kojima žive pripadnici manjinskih zajednica. Ministarstvo transporta je dalo svoj projekat, ima znači odredjenih stavki koje se tiču i za sredine u kojima žive manjinske zajednice, međutim u narednom periodu ne vidim jedan veoma značajan putni pravac, a to je Restelica-Strezimir, to je granični prelaz prema Makedoniji, to je strateški pravac za Kosovo, to je otvaranje prema Makedoniji najbliža... znači Prizren i čitava dolina Dugadjska, približava se potpuno i Debru i Ohridu i Strugi na par sati, sat-dva i mislim da to treba svakako da bude kao prioritet ovog ministarstva. Na drugoj strani, veoma je malo posvećeno pažnje kranjem severu Kosova, odnosno opštini Leposavić u kojoj postoje znači sredine ne samo za većinsku zajednicu, tamo su Srbi većinska zajednica, međutim i za manjinske zajednice Bošnjake, Albance u Koštovu, Ceraji ili u Rvatskoj. Potrebno je da Vlada Kosova, odnosno Kosovo bude prisutno na krajnjem sjeveru sa investicijama i to bi bio znak znači da Kosovo od prilike ima kompletan integritet, odnosno na čitavoj teritoriji.

Mi ćemo znači podržati ovaj budžet uz odredjene promene koje bi svakako trebalo da doživi u daljoj fazi, odnosno između prvog i drugog čitanja, daćemo svoj doprinos u toj fazi. Hvala!

KRYSUESI: Faleminderit, zoti Idriz! E fundit për këtë pjesë të seancës është zonja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Nga debatet që i dëgjova deri tani nga parafolësit, desha vetëm të them që Projektbuxheti nuk është fontanë dëshirash, por është fontanë mundësish të cilat kjo qeveri dhe shteti i ka.

Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 12 janë parashikuar të jenë në vlerën prej 7.5% më të larta se të hyrat e rregullta të vitit 2009. Është inkurajues fakti që edhe përkundër prezencës së krizës ekonomike botërore, të hyrat vendore dhe ato nga kufiri nuk janë ndikuar negativisht nga kjo krizë. Përpos këtyre të hyrave, pritet që të trashëgojmë një bilanc pozitiv bankar nga ky vit, çka do të përdoret si burim shtesë për financimin. Thelbi i buxhetimit kualitativ qëndron në balancimin në mes të të hyrave dhe shpenzimeve të të njëjtit vit. Në këtë frymë, Qeveria ka qenë e kujdesshme në shfrytëzimin e bilancit bankar. Për më shumë, Qeveria ka ruajtur rezervën fiskale prej 200 milionë eurove rezervë, kjo që shërben si masë mbrojtëse ndaj efekteve të krizave eventuale me të cilat do të mund të përballej ekonomia e Kosovës. Duhet përmendur po ashtu që objektivi i Qeverisë ka qenë ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale, siç e thashë më herët, dhe kredibiliteti planifikues duke respektuar përkushtimin për ofrimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike. Buxheti si tërësi ofron shumë e përgjithshme të shpenzimeve prej 1.461 milionë euro, që shënon një rritje prej 6% krahasuar me buxhetin e vitit të

kaluar dhe se në shumën e lartpërmendur hyn totali i shpenzimeve prej 1.146.6 milionë euro, 200 milionë rezerva minimale bankare dhe 70 milionë euro që është llogaritur të jenë financimet e jashtme si mbështetje buxhetore. Kjo nënkupton se shuma prej 270.000.000 euro nuk është futur në kufijtë e shpenzimeve në Projektbuxhetin e vitit 2010. Kosova do të ketë rritje të projektuar ekonomike prej 4% gjatë vitit 2010 dhe rreth 35% e shpenzimeve primare të këtij buxheti apo 400.5 milionë janë dedikuar për shpenzime kapitale duke ofruar shtytje të vazhdueshme për rritje ekonomike të vendit.

Po i përmend vetëm disa nga fushat në të cilat është investuar. Tek Ministria e Transportit, buxheti i vitit 2010 ofron rreth 112.5 milionë investime në infrastrukturë rrugore përfshirë këtu edhe fillimin e Autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë. Ky buxhet për 9.1% më i lartë krahasuar me buxhetin bazë të vitit 2009. Me këtë Qeveria po i hap mundësi dhe është duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për përfshirjen e investorëve privatë në fushën e transportit, ku presim që një pjesë e investimeve në këtë fushë të realizohet përmes partneritetit publiko-privat.

Arsimi. Sektori i Arsimit është identifikuar të jetë burim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për atë që ofron prosperitet për gjeneratat e ardhshme. Ky projektbuxhet në mes tjerash do të financojë themelimin e Universitetit të Prizrenit prej 2 milionë euro, si dhe do të zgjerojë kapacitetet e Universitetit të Prishtinës edhe për 4000 studentë të rinj. Ne mbetemi të përkushtuar që të financojmë tërheqjen e profesorëve me kualifikimet më të larta për këto universitete duke u afruar atyre paga më të larta.

Po ashtu, përmes këtij buxheti do të ndahen edhe 24.7 milionë euro për përfundimin e shkollave të filluara, si dhe disa shkolle të reja në komunat e ndryshme të Kosovës. U përmend Universiteti i Pejës edhe pse nuk po ndërtohet, nuk po mendohet në ndërtimin e Universitetit të Pejës. Unë po e them që në këtë radhë kemi filluar me Universitetin e Prizrenit, do të vazhdojmë me Gjakovë, se sigurisht edhe deri te i Prizrenit do të mbërrijmë.

Shëndetësia. Në sektorin e shëndetësisë financimi i programit për barëra esenciale do të jetë 20 milionë euro. Më herët ish-ministri e përmendi që në Qeverinë e kaluar kjo listë ka qenë 6 deri 7 milionë euro. Dhe u përmendën ankesat se edhe më tutje nuk ka barëra të mjaftueshme, e unë mendoj që sot po bisedojmë për buxhetin dhe jo për menaxhimin dhe mënyrën se si menaxhohen ...

KRYESUESI: Faleminderit, zonja dhe zotërinj deputetë!

Unë uroj që orët tona personale ta tregojnë tamam treshin të gjithë, se do të vijmë tamam në orën tre këtu.

Edhe 30 vetë janë për të debatuar, kështu që të mos shtyhet seanca deri në orët e vona.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Me 46 deputetë, mendoj që mund t'ia fillojmë debatit. Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet Bahri Hyseni.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po e shqyrtojmë Projektligjin për buxhetin e vitit 2010. Projektbuxheti për vitin 2010 nuk do ta ndryshojë gjendjen ekonomike në vend, që do të thotë se ky buxhet në formën se si është ndarë, nuk do të mundësojë krijimin e mundësive për një zhvillim ekonomik. Ky buxhet do të jetë një miliardë e 460 milionë euro, vetëm 4% më shumë se buxheti i vitit 2009. Sipas këtij Projektbuxhetit, të hyrat vjetore do të jenë 1.2 miliardë euro, të cilat do të arketohen kryesisht nga doganat, administrata tatimore e Kosovës dhe paratë e pashpenzuara nga buxheti i këtij viti. Ndërsa 35% e buxhetit për vitin 2010 janë të dedikuara për shpenzime kapitale, shumë kjo që nuk është e mjaftueshme sepse vetëm investimet kapitale mund të krijojnë vende të reja të punës.

Unë mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të jetë më koshiente dhe të krijojë mekanizma të brendshëm për mbledhjen e të hyrave për buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse buxheti i Kosovës duhet të mbushet brenda territorit të Kosovës, ndërsa dogana duhet të jetë vetëm lehtësuese e këtyre veprimeve.

Unë po i referohem edhe Raportit të Komisionit Evropian për progresin e bërë në Kosovë, në të cilin thuhet se ka rritje të të hyrave nga doganat, por për ekonominë e vendit tonë nuk është e mirë që 65% e të ardhurave nga tasat të mblidhen në kufi dhe kjo tregon më së mirë për mungesën e mekanizmave të brendshëm për mbledhjen e tatimeve.

Tani të kaloj pak edhe te suficiti. Në këtë buxhet të vitit 2010 do të kemi edhe mbi 400 milionë suficit të pashpenzuara. Këto teprica buxhetore ndodhin në Kosovë me vite me radhë, kryesisht nga mungesa e planifikimit të duhur të projekteve të cilat rezultojnë me vonesë të projekteve e si rezultat edhe me vonesë të shpenzimeve buxhetore. Arsye tjetër pse kemi teprica të mjeteve buxhetore është edhe mungesa e kapaciteteve për të hartuar projekte dhe plane mbi të cilat do të shpenzoheshin këto mjete buxhetore. E kjo dukuri çon në stagnim ekonomik dhe assesi në zhvillim ekonomik.

Po ashtu, ekziston një rrezik potencial për jo stabilitet financiar pasi që suficiti i grumbulluar bashkë me 200 milionë euro të Postës dhe Telekomit të Kosovës, të parapara që të hynë në këtë buxhet, do të krijojnë deficit buxhetor. Dua të theksoj se në këtë projektligj për këtë buxhet të vitit 2010 nuk janë të parapara mjete as për Ligjin e sigurimeve shëndetësore dhe as për atë të punës, gjë që është premtuar nga Qeveria e Kosovës se këto mjete do të ndahen për këto dy projektligje.

Po ashtu, nëse e shohim shumë 44 euro e cila është premtuar për punonjësit shëndetësorë, unë nuk po e shoh që është në paga dhe mëditje, që konsideroj që duhet të jetë e fokusuar në paga dhe mëditje në mënyrë që këta punonjës shëndetësorë t'i marrin pagat me rregull edhe këtë shumë prej 44 euro. Kjo tregon edhe një herë mungesën e seriozitetit të Qeverisë së Kosovës në qasjen ndaj këtyre kategorive të cilave u premtohet vetëm para fushatave dhe asgjë nuk merret konkretisht.

Duke e parë rëndësinë e ministrive, unë e shoh këtu që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka një buxhet mjaftë të vogël që nuk do t'i plotësojë kërkesat e rinisë dhe të kulturës në vend.

Po ashtu, nëse e shohim ndarjen e buxhetit, grandeve qeveritare në nivelin komunal, atëherë shohim se nuk janë trajtuar njëtrajtshmërisht apo nuk janë përfillë kriteret të cilat do të duheshin të përfilleshin për të gjitha komunat njëjtë. Kemi 283 milionë euro të ndara për buxhetin komunal, do të thotë grandeve qeveritare, që nuk përkojnë me premtimet që janë bërë paraprakisht nga Qeveria e Kosovës.

Unë, duke i parë të gjitha këto fakte, shoh që nuk ka indikacione të një zhvillimi të mirëfilltë ekonomik duke pas parasysh që shteti ynë ballafaqohet me një mungesë të madhe të zhvillimit ekonomik dhe me plotësimin e nevojave elementare të vendit tonë dhe të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputetja Myrvete Pantina.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht që po diskutojmë për një projektligj të një rëndësie të veçantë për Kosovën dhe qytetarët e saj - Projektligjin për buxhetin, prandaj është mirë ndoshta në aspektin e përgjithshëm të flasim për të mirat dhe të mundshmet që ka mundësi t'i arrijë buxheti për vitin 2010.

Së pari, unë përgëzoj Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, natyrisht, së bashku me Qeverinë për dokumentin që ka sjellë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, sepse është dokument i parë i cili së paku në aspektin teknik nuk ka vërejtje, është një dokument në të cilën kemi pasur mundësi ne deputetët në aspektin përmbajtësor të kemi mundësi që gjatë kësaj periudhe sa e kemi pasur dokumentin në fjalë ta shqyrtojmë çështjen e buxhetit. Pse do ta votoj buxhetin dhe pse do ta kisha votuar buxhetin pavarësisht se cila Qeveri do ta kishte hartuar këtë dokument. Janë nja 3 - 4 aspekte të cilat do të mundohem pa i lexuar, pa i përsëritur shifrat, t'i bëj disa dallime.

Së pari, çdo shtet i cili tregon stabilitet në financa dhe në zhvillim ekonomik, ka një rritje të buxhetit në mënyrë graduale. Nga vetë fakti që buxheti i Kosovës po rritet në mënyrë graduale, po dallon nga vitet e mëparshme ku kemi pasur ngritje të theksuar, tregon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, varësisht prej kapaciteteve që i kemi si shtet, por po tregon një stabilitet i cili garanton që qytetarët e Kosovës, institucionet e Kosovës do të arrijnë ta kenë jetën më të mirë, natyrisht me infrastrukturë më të qëlluar gjatë kësaj periudhe për të cilën po bisedojmë. Do me thanë, ngritja graduale është parametër që tregon një stabilitet. Nëse buxheti është rritur për 3% nga e kaluara, do me thanë zhvillimi ekonomik për 3% tregon një stabilitet dhe nuk tregon se buxhetin vetëm për dëshirë apo për fontana mund ta rrisim në mënyra të ndryshme.

Një çështje tjetër për të cilën vlen të përmendet, janë investimet kapitale. Asnjë buxhet dhe asnjë shtet kudo, edhe në shtetet më demokratike në botë, nëse mban trendin e zhvillimeve në investimet kapitale, ai tregon një siguri dhe një stabilitet. Ne e dimë që në buxhetin e vitit 2010 janë paraparë mbi 400 milionë investime kapitale dhe, natyrisht, kjo do të tregojë që brenda këtyre investimeve kapitale do të ketë projekte të shumta, shkolla, rrugë të ndryshme, mandej universitete dhe projekte tjera nacionale dhe kjo është një garanci që i siguron qytetarët e Kosovës që të kenë një të ardhme edhe për vitin 2010, 2011, 2012, ashtu qysh është planifikuar buxheti. Nga dallimi prej kësaj, mund të shohim se zëri i mallrave dhe shërbimeve, edhe pse ndoshta jo në masë të madhe, mirëpo është ulur për 2%, kjo tregon se Qeveria e Kosovës, Ministria për Ekonomi dhe Financa po shkon në trendin e duhur sepse po e ulë zërin e mallrave dhe shërbimeve dhe po tenton të rrisë investimet kapitale prej të cilave fitojnë qytetarët e Kosovës dhe fitojmë natyrisht edhe ne si qytetarë të rëndomtë të shtetit të Kosovës.

Vlen të përmendet një çështje për të cilën duhet theksuar se subvencionet në ndërmarrjet publike janë ulur për 10% dhe kjo vlen të përsëritet nga vetë fakti sepse ndërmarrjet publike kanë nevojë, do të kenë nevojë edhe në të ardhmen, jo vetëm në vitin 2010 por edhe në vitet tjera, nëse mbesin ende si ndërmarrje publike. Mirëpo, zvogëlimi në 10% dhe në anën tjetër forcimi i politikave sociale, politikave për zhvillimin apo për mbështetjen e strukturave që janë dhe direkt mbahen nga buxheti i Kosovës, në këtë rast kisha për të përmendur pensionistët, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, nga vetë fakti që po mbështeten me buxhetin e vitit 2010 dhe është paraparë edhe një projekt për vitet në vazhdim, tregon se ky buxhet duhet të aprovohet sepse Qeveria me të gjitha problemet që i ka, ka mbetur dhe ka paraparë edhe një mbështetje për këtë kategori të njerëzve të cilët ndoshta do t'i kenë hallat më të mëdha në vitet në të cilat po kalojmë.

Në anën tjetër, pagat dhe mëditjet jo vetëm që kanë mbetur në nivelin e duhur, mirëpo ka edhe një rritje....

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë më tutje. Myrvete Pantina, le të përgatitet Ali Lajqi.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 mendoj se nuk do të duhej bërë pa e pasur në shqyrtim raportin 9-mujorë të shpenzimeve buxhetore për vitin 2009. Nëse bazohemi vetëm në raportin 6-mujorë të shpenzimeve buxhetore, e dimë se në këtë periudhë shpenzimet e realizuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë 34%, do me thanë në një nivel relativisht të ulët dhe prej asaj kohe nuk e dimë se në çfarë niveli janë realizuar shpenzimet. Andaj, është vështirë, pra, të vendosim tani për ndarje të reja buxhetore pa e ditur nivelin e shpenzimeve të realizuara nga ana e organizatave buxhetore. Në realitet, do të duhej që në të ardhmen organizatat buxhetore të cilat nuk i realizojnë shpenzimet e tyre duhet të përfitojnë më pak nga buxheti për vitin e ardhshëm.

Sa i përket realizimit të shpenzimeve buxhetore, sidomos atyre të shpenzimeve kapitale, në Projektligjin e buxhetit për vitin 2010 mendoj se neni 10, konkretisht paragrafi 6 i këtij neni paraqet një ndryshim pozitiv kur thuhet se një organizatë buxhetore nuk duhet të shpall ftesën për tender për një projekt kapital të aprovuar pas 31 tetorit të vitit 2010,

prandaj mendoj se me këtë mund të ndikohet në realizimin më të mirë të shpenzimeve buxhetore, sidomos të atyre kapitale.

Për dallim prej viteve tjera, buxheti i vitit 2010 karakterizohet me deficit buxhetor. Deficiti prej 117.4 milionë euro sa është i arsyeshëm, me qenë se në ekonominë bashkëkohore në vend të baraspeshës buxhetore favorizohet financimi deficitar në investimet për ringjalljen ekonomike. Mirëpo, parashtrohet pyetje – a do të realizohet ky planifikim i mjeteve apo i deficitit, të shpenzimeve më të mëdha se sa që janë të hyrat, sepse ne në realitet jemi mësuar që të kemi suficit buxhetor. Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë është përmirësimi i mirëqenies sociale të popullsisë dhe për të ndikuar në realizimin e këtij prioriteti, Qeveria ka paraparë rritjen e buxhetit për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke ofruar mbështetje familjeve të personave të humbur, si dhe për të ngritur mbështetjen për invalidët e luftës si dhe të familjeve me asistencë sociale, përveç tjerash. Këto shpenzime dihet se janë të nevojshme, por ato kanë karakter social dhe jo produktiv sepse nuk do të kenë ndikim të madh në rritjen ekonomike, çka është prioritet i parë i Qeverisë, edhe pse ndikojnë në rritjen e konsumit të familjeve. Andaj, do të ishte më e arsyeshme që këto shpenzime të kenë karakter produktiv, do me thënë këto kategori të familjeve të përkrahen me subvencione aty ku ka mundësi për t'u marrë me ndonjë aktivitet ekonomik, konkretisht me bujqësi, ku do të realizonin të ardhura për jetën e tyre dhe do të ndikonin në rritjen e prodhimit sepse deficiti i prodhimeve bujqësore në vendin tonë është për kokë të banorit mbi 200 euro. Prandaj, edhe bujqësia ka nevojë për një përkrahje më të madhe se sa që është paraparë me buxhetin për vitin 2010.

Një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen ekonomike janë investimet kapitale. Me buxhetin e vitit 2010 është paraparë që vlera e këtyre investimeve të ulet për 70 milionë euro në krahasim me vitin 2009, ku janë përfshi një numër i konsiderueshëm i projekteve infrastrukturore. Mirëpo, në kuadër të këtyre shpenzimeve, do të thotë të buxhetit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, nga vlera e gjithëmbarshme prej 112 milionë euro për rehabilitimin e rrugëve janë paraparë 59 milionë, që do të thotë mbi 50% të shpenzimeve kapitale dhe paraqet një shumë të madhe duke u nisur nga fakti se viteve të fundit vazhdimisht ndërtohen rrugë të reja.

Të gjithë e dimë që kemi nevojë për përforcimin e një sistemi më efektiv të drejtësisë...

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Lajqi, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

ALI LAJQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar të gjithë të tjerët,

Unë desha nja dy çështje kështu t'i shtroj, që do të mund të... sa do të kishte refleksion dhe sa do të ishin në konsideratë, do të shikohet. Është çështje e disbalancit buxhetor mes komunash dhe kjo është bartur si duket nga parashikimet më shumë dhe kemi disa kritere për ndarjen e buxhetit të cilat jo rallë janë në disharmoni me vetë buxhetin e inkasuar nga komunat, deponimin e tyre dhe pastaj ndarjen e tyre në grande apo nga..., sot i themi nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, që këto hetohen në disa nga komunat, sidomos në qoftë se përmendim, nisemi nga komuna e Pejës, po edhe të tjerat, që vërehen atje në tabelar dhe

kjo praktikë ka vazhduar diku prej Rregullores së UNMIK-ut e kënde, të cilët sigurisht kanë bërë disa parashikime, siç është një kriter për ndarjen e buxhetit - regjistrimi i popullsisë, që ne e kemi debatuar dhe nuk e kemi regjistrimin për shkaqe të shumta statutare, tekniko-administrative e tjera e tjera, që tash nuk po hyjmë, por do të duhej mundësisht që Ministria për Buxhet dhe Financa të bëjë një kornizë të mundshme të re, kriteret të reja për ndarjen e buxhetit, ku do të mundë të balancoheshin këto komuna të cilave vërtet u hyhet me hak, sepse dihet çfarë bëjnë deponime ato në kuptim të buxhetit dhe dihet pastaj ndarja nga grandit dhe ka një diferencë për të cilën duhet të shqetësohet edhe vetë ministri për Buxhet dhe Financa.

Sigurisht unë kisha për të propozuar në këtë mes, kur jemi këtu, edhe disa parashikime buxhetore. Ne kemi pasur një kërkesë të kahershme, mund të them dyvjeçare, mos më shumë, për një universitet të Pejës, që nuk është planifikuar për shkak se nuk ka vendim, është shumë e qartë, por të mendohet për atë e do të jetë një mendim nesër nga Ministria e Arsimit. Nuk do të ishte keq, kushtet janë dhe kriteret për një universitet të Pejës janë gjithnjë të favorshme. Sigurisht duke e përshëndetur këtë të Prizrenit që është mjaftë i domosdoshëm dhe mjaftë me vend vendimi. Mirëpo, s'kish qenë keq të jetë në propozim që më vonë gjatë shqyrtimit të buxhetit final apo vendimit përfundimtar, që Rugova të jetë një zonë, të shpallet një zonë e interesit nacional për zhvillimin e turizmit e të zhvillimeve tjera, siç janë zhvillimi hapësinor, të mbrojtjes, madje rregullative e të tjera, që vërtet do t'i krijonte mundësi buxhetit të Qeverisë të shkojë më favorshëm dhe do të lente një portë hapur në këtë aspekt. Prandaj, unë këto dy çështje i shtrova dhe do të ishin besoj me konsideratë, por gjithnjë duke parë nga mundësitë atje buxhetore, madje edhe të planifikimit që u besoj se do të mund ta përthehte Qeveria këtë. Ju falënderim!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Jakup Krasniqi.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,
Buxheti i secilit vend jo vetëm që bën financimin e funksioneve publike dhe të shërbimeve publike, por duhet të krijojë edhe kushte të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik dhe të stabilitetit makroekonomik. Për të arritur këtë, duhet të krijojmë kushte për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe të kemi racionalizim të shpenzimeve dhe përmirësimin e menaxhimit të buxhetit.

Qeveria gjatë ekspozesë të ministrit tha se me këtë buxhet parasheh një nxitje të zhvillimit ekonomik, një stabilitet të madh social dhe zbutjen e papunësisë, fuqizimin e qeverisjes së mirë dhe sundimin e ligjit dhe të gjitha këto duhet që pikë së pari të bëhet zgjerimi i bazës tatimore, të bëhet përmirësimi i vjeljes së tatimeve më të mëdha, të bëhet përmirësimi i kapaciteteve të administratës tatimore, por edhe të doganës. Tha dikush që nuk duhet të hyrat buxhetore të jenë vetëm nga dogana, mirëpo momenti i zhvillimit ekonomik është i tillë që edhe për shumë kohë do të varen nga të hyrat doganore dhe këtë duhet ta kemi në kujdes, bile një administratë më efikase në mbledhjen e të hyrave në doganë, gjithashtu përdorimin e burimeve tjera financiare për investime të infrastrukturës publike. Unë shpresoj që tani ka krijuar kushte më tepër që paratë për infrastrukturë

publike dhe për investime kapitale të thithen nga forma të tjera dhe jo nga buxheti, por buxheti i Kosovës të shfrytëzohet më tepër për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për investime më të madha ekonomike të cilat do të kenë një zhvillim më të madh ekonomik se sa infrastruktura rrugore. Duhet të analizojmë edhe infrastrukturën rrugore të mos e lëmë pas, por të shohim se infrastruktura rrugore me të vërtetë a na ka sjellë zhvillim shumë të madh ekonomik apo jo. Kemi fonde të tjera që mund të përdoren, si paratë e privatizimit, paratë e Trustit pensional, mund të bëhet një tryzni të vije në vend dhe të shfrytëzohen për infrastrukturë rrugore.

Një problem tjetër që e ceku ish kryetari i Pejës, zoti Ali Lajçi, është se edhe forma e shablloneve të krijimit të buxheteve nëpër komuna besoj që është e tejkaluar. Ekziston një rregull që në bazë të numrit të banorëve dhe në bazë të territorit, mirëpo unë do të them këtu që shpeshherë disa komuna po lihen anash. Dua ta marr shembullin e Pejës dhe të Prizrenit. Prizreni e ka dyfish buxhetin më të madh se sa Peja, ndërsa se ka dyfishin e banorëve dhe dyfishin e territorit dhe për këtë arsye zoti Lajçi ka qenë në disfavor në krahasim me zotin Kryeziu, i cili ka pasur buxhet shumëfish më të madh se sa vetë zoti Lajçi. Do të thotë, edhe këtu është një problem që ne duhet të ndryshojmë këtë praktikë, e cila ju ka sjell dëm. Çka mund të hyhet në këtë projekt, është se komuna duhet të shikohet edhe në bazë të zhvillimit ekonomik. Ne e dimë që edhe Drenica, po edhe Dukagjini ka pësuar gjatë luftës shkatërime të mëdha. Pse atëherë Peja, kur është shkatërruar mbi 90%, nuk ka ndonjë benificion më tepër që të ketë të hyra më të mëdha dhe grande qeveritare më të mëdha se sa, bie fjala, Prizreni që ka pësuar shumë më pak se sa ndonjë komunë tjetër. Unë besoj që në të ardhmen kjo formë e shablloneve të formimit të buxhetit duhet të kihet parasysh, të merret edhe kjo bazë, sepse shumë vende marrin për bazë edhe zhvillueshmërinë e rajoneve. Nëse një rajon është më pak i zhvilluar dhe nëse në një rajon janë bërë më pak investime, duhet të ketë një buxhet më të madh dhe duhet të ketë investime më të mëdha edhe në infrastrukturën rrugore, po edhe në investime tjera.

Çka do të isha ndalur, është për fund edhe Ministria e Komunitetit dhe Kthimit, e cila po ashtu me këto para të gjitha investimet dhe të gjitha në të ardhmen që i ka planifikuar, është që do t'i harxhojë për komunitetin serb edhe për vitin 2010 komunitetet tjera duhet të fishkëllejnë dhe të rreziten. Kjo është në bazë të projekteve që janë paraparë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe më vije shumë keq se Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e ka ndarë asnjë centë për njerëz që do të kthehen në vitin 2010, sidomos nga diaspora, ku parashihet dhe kemi paralajmërime që do të kthehen mbi 13 mijë ose 14 mijë njerëz të të gjitha etnive, ndërsa Ministria e Komunitetit dhe Kthim nuk e parasheh asnjë centë për këta të kthyer dhe atëherë do të ballafaqohemi me probleme dhe këta njerëz mandej duhet të shkojnë ja te Ministria për Komunitete, ja pranë ambasadave të atyre shteteve që do të kthejnë këta njerëz. Unë shpresoj që ...

KRYETARI: Faleminderit!

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

E shoh të arsyeshme t'i them pak fjalë për buxhetin e planifikuar për vitin 2010. Ju e dini që kur kemi qenë në opozitë, buxhetin e vitit 2005 apo 2006 e kam pas quajtur buxhet të

varfërisë. Nga atëherë deri më sot buxhet ka bërë një ngritje gati të dyfishtë, por realisht vazhdon të jetë buxhet për t'i plotësuar nevojat ndoshta sociale të qytetarëve të Kosovës dhe ende nuk mund ta quajmë buxhet të zhvillimit edhe pse, krahasuar me vitet e mëhershme, një pjesë e mirë e buxhetit, 1/3 e tij gati shfrytëzohet për investime kapitale, që në fakt investimet kapitale në një formë ose një tjetër edhe pse ndoshta nuk janë të mjaftueshme, çojnë ujë kah zhvillimi ekonomik, janë në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe është mirë kjo që ndodh në Kosovë.

Mendoj që duhet ta shikojmë këtë buxhet që është, u përgjigjet prioriteteve që i kanë qytetarët e Kosovës. Dhe, nëse po, atëherë duhet ta pranojmë se është një buxhet i planifikuar mirë dhe unë dua të besoj që ata që e kanë planifikuar buxhetin, janë duke planifikuar buxhetin e Kosovës që 10 vite dhe konsideroj që ata e kanë bërë planifikimin më mirë se ne, me qenë se ne jemi këtu dhe për të bërë ndonjë ndryshim. Do të thotë, një pjesë e mirë e buxhetit po shkon për investime kapitale, një pjesë e buxhetit po shkon për ndërtimin e shkollave dhe sigurisht në Kosovë ka nevojë të ndërtohen shkolla, se pa shkolla të mira nuk vinë as ndryshime tjera në procesin e arsimit.

Kemi një ngritje edhe për shëndetësinë e Kosovës, ndoshta jo sipas nevojave që i kanë qytetarët e Kosovës, por si prioritet s'mund të themi se nuk është trajtuar shëndetësia dhe, natyrisht, si prioritet janë konsideruar edhe kategoritë sociale, pensionet e në mënyrë të veçantë ndoshta kategoria që më së shumti ka pasur nevojë të ketë një përkujdesje institucionale, siç janë invalidët e luftës.

Shërbimi Policor, natyrisht, edhe këtij i është dhënë një përparësi. Prandaj, ne tash nëse duam të flasim se në cilën kategori, cilin prioritet e kemi lënë keq, ne buxhetin e kemi diku rreth një miliardë e 400 milionë të paraparë për vitin 2010. Ku mund të marrim dhe ku mund të japim, por realisht ne nuk mund ta bëjmë 2 miliardë buxhetin, se po të jetë 2 miliardë, mundësitë për të ndarë janë më të mëdha. Mendoj që sa herë që të flasim për këtë buxhet, duhet të shikojmë në cilin segment kemi orientuar shumë mjete financiare dhe cilin segment e kemi lënë keq dhe të marrim prej atyre që i kemi çuar pa nevojë dhe t'i çojmë ku janë nevojat më të mëdha. Unë mendoj që si deputet këtë përgjegjësi e kemi të flasim në këto vija.

Mua më vjen keq që vërtet disa deputetë e përdorën një frazë se u zvogëlua Kosova në 2000 kilometra katrorë. Për mua është shumë interesat se e kemi zvogëluar shumë dhe vërtet ndoshta duhet bërë një pyetje - kush kujt po i thotë për zvogëlim të Kosovës, a thua vetëm tani filloj zvogëlimi i Kosovës? Politikisht mendoj është e paqëndrueshme dhe e dëmshme kjo frazë që është përsëritur nga disa deputetë.

Kushtëzimi me Prishtinën. Mendoj se askush nga ne nuk mund të themi se Prishtina është më shumë, ose më pak e imja. Prishtina është e imja, sa edhe e atij tjetrit. Prishtina është qytet i të gjithëve. Kosova është tepër e vogël që ne të mendojmë se dikush është më i Prishtinës e dikush më pak i Prishtinës. Unë e konsideroj gjithë angazhimin tim politik për Prishtinën, kudo që jetoj në Kosovë se, në fund të fundit, Prishtina është pasqyrë e zhvillimit ekonomik, e kulturës dhe e edukatës sonë. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme që dikush në këtë Kuvend të bëhet më i zëshëm për kryeqytetin tonë. Në fund të fundit,

edhe Kosova, edhe Prishtina s'mund të jetë më pak e atyre që kanë investuar gjithçka edhe për Kosovën, edhe për Prishtinën, më shumë se sa e atyre që s'kanë investuar asgjë për të. Prandaj, mendoj që duhet të kemi respekt për fjalën që e themi në Kuvend, ky është Kuvendi i Kosovës në Prishtinë dhe Prishtina është e Kosovës. Prandaj, unë po e përfundoj, por po dua të them se po qahemi kot për mënyrën se si ndahet buxheti. Nuk ka komunë në Republikën e Kosovës që është e kënaqur me ndarjen e buxhetit. Prishtinës i ndahet buxhet për 400 – 500 mijë banorë, Skenderajt i ndahet për 55 mijë banorë, a i ka 40 mijë zgjedhës. Është e pamundshme që Skenderaj, me shtimin natyral më të madhin në Kosovë, t'i ketë 55 mijë banorë dhe t'i ketë 40 mijë zgjedhës. Prandaj, mendoj që ne duhet të krijojmë kriteret për ndarjen e buxhetit. Por, nuk janë kriter vetëm banorët, kriter është edhe e kaluara, ne e dimë se dikush për 100 vite është shkel dhe është nëpër këmbë dhe dikush megjithatë ka qenë pozita më të favorizuara. Mua më vjen rëndë, unë gjatë gjithë kohës asnjëherë s'e kam ngritur zërin për Drenicën se nuk jam angazhuar politikisht vetëm për Drenicën. Por, të bëhemi korrektë, ta shikojmë buxhetin kujt mund t'i marrim dhe kujt mund t'i japim. Unë nuk shoh hapësirë se cilit prioritet duhet t'i marrim dhe cilit prioritet duhet t'i japim. Nëse keni argumente të tilla, ku mund të merret dhe ku mund të bëhen lëvizjet, ne jemi për të bërë lëvizje. Ju faleminderit! Gjylnaze, faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryetar, sepse si i tillë patët të drejtën t'i keni 10 minuta. Në radhë është zonja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Përshëndetje për të gjithë,! ju faleminderit, zoti kryesues, zoti kryetar! Kolegë deputetë dhe ju Qeveri, Edhe unë kam disa nga vërejtjet për këtë projekt-propozim të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010. Nën një, ju propozojmë ndryshimin e nenit 11, pagesa e paradhënies, ku thuhet se organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie deri në 15% të vlerës së kontratës. Kjo të jetë që organizatat buxhetore të paguajnë paradhënie deri në 20%. Fjala “mund” kërkoj të hiqet, ndërsa kushtet tjera për lejimin e paradhënies të mbeten të njëjta. Pasusi që ka të bëjë për mundësitë e aprovimit të pagesës nga ana e ministrit dhe Qeverisë, për shkak të mundësisë së keqpërdorimit të detyrës, të hiqen.

Nën dy, në projekt-propozim vërehet se Republika e Kosovës në vitin fiskal në vitin 2010 po hynë me deficit prej 212.4 milionë euro ose deficitin merr pjesë 24% në strukturë të të hyrave buxhetore, e kjo ndikon negativisht në politikën fiskale të Republikës së Kosovës. Në tabelën numër 2 përmbledhëse të ndarjeve buxhetore ekziston një dallim i ndarjes së mjeteve për 22 milionë euro, që Qeveria nuk e arsyeton atë ndarje se ku janë ato mjete, Qeveria planifikon t'i ndajë 193 milionë euro, e arsyeton ndarjen e mjeteve 171 milionë euro, kjo shihet edhe në këtë materialin që e kemi këtu, ju lutem.

Zoti ministër,

Sa u përket projekteve investive, në nivelin qendror vërehet se për komunën e Gjilanit, Qeveria ndanë vetëm 6.5 milionë euro ose vetëm 2% të nivelit të mjeteve të parapara për investime në nivel të Kosovës. Çka është më interesant, nuk ka planifikuar asnjë projekt në kulturë, rini e sport, mos të flasim për shëndetësi primare dhe atë sekondare dhe në

mbrojtjen e mjedisit. Ndërsa për rregullimin e lumit Mirusha, Qeveria e Kosovës që 3 vjet radhazi ndanë nga 300 mijë euro, e puna fare nuk kryhet, vetëm bartet buxheti prej një viti në vit. Mendojmë se Gjilanit, në bazë të numrit të popullatës duhet t'i takojnë më shumë mjete për investime. Gjilanit i janë ndarë 16 milionë mjete më pak për investime kapitale. Kam një pyetje – ku janë 110 milionë euro të premtuara nga Kryeministri i Republikës tonë për komunën e Gjilanit gjatë fushatës zgjedhore?

Nëse krahasohen treguesit tjerë ekonomikë, siç janë investimet kapitale komunale, gjendja është me sa vijon: Investimet kapitale komunale janë të lejuara në mesatare prej 2,18 euro për një euro të të hyrave vetjake komunale, ndërsa Gjilanit i janë lejuar 1.3 euro për investime për një euro të të hyrave vetjake komunale. Gjilanit, do me thanë, i janë lejuar më pak mjete për investime për 2 milionë e 640 mijë euro, në krahasim me mesataren në nivel të Republikës së Kosovës, të ndara për komunat. Ndërsa janë të favorizuara komunat, siç janë, me keqardhje, por duhet ta cek sepse u cek edhe më herët, zotëri të nderuar, komuna e Prizrenit është e favorizuar për një milionë e 538 mijë euro më tepër në krahasim me mesataren e Republikës së Kosovës. Skenderaj është favorizuar për 1.274.000 euro në krahasim me mesataren e Kosovës. Podujeva është favorizuar për 2.497.000 euro, Shtimja është favorizuar për 290.500 euro në krahasim me mesataren e Kosovës, që janë ndarë mjete për investime në buxhetin e komunave. Te treguesi ekonomik, shpenzimet për mallra dhe shërbime krahasuar me numrin e punëtorëve vërehet një josingëritet i ndarjes së drejtë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime nëpër komuna, e këtë padrejtësi e kemi vërejtur edhe tek....

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Fehmi Mujota, le të përgatitet Synavere Rysha.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra, i nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Më lejoni që të shpreh konsideratën e lartë për mirëkuptimin e plotë që ka pasur Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave për buxhetin e vitit 2010 që i takon Ministrisë së Forcës së Sigurisë. Gjithashtu, konsideroj se me këtë projektbuxhet të vitit 2010 është arritur që të jetë në përputhje të plotë me misionin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, e cila është përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit civil dhe demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe është përgjegjëse për politikën, menaxhimin dhe administrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Pikërisht në përputhje me Draft-strategjinë e zhvillimit të vitit 2010 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, është ndarë edhe buxheti i cili buxhet ka qenë gjatë gjithë kohës në diskutim të hapur me Ministrinë tonë, natyrisht, bashkë me Ministrinë e Financave dhe në këtë rast do të falënderoja edhe Komisionin për Buxhet, i cili po ashtu ka pasur një konsideratë të lartë për nevojat e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, si një institucion i ri, i cili brenda një viti ka arritur që të plotësojë një pjesë të kapaciteteve të saj.

Neve na gëzon fakti që tashmë janë arritur kapacitete të plota operationale dhe synimi ynë është arritja e kapaciteteve të plota profesionale të Forcës së Sigurisë dhe mbi bazën

e kësaj, buxheti i cili ishte në vitin 2009 prej 20.4 milionë, këtë vit për Ministrinë tonë është ndarë buxhet prej 31.1 milionë, që do të thotë 51.8% më tepër se vitin e kaluar.

E ndjej të nevojshme të njoftoj deputetët e Parlamentit se në vitin 2010 ne do të kemi një bashkëpunim të ngushtë me Fondin e mirëbesimit, të ngritur për ngritjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili buxhet do të mund të plotësojë një pjesë të kapaciteteve të buxhetit tonë që është i nevojshëm për ngritjen e këtyre kapaciteteve. Prandaj, buxheti aktual që është propozuar dhe që do të miratohet për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, në këtë rast është në përputhje të plotë me mbajtjen e politikave aktive për tërheqje të investimeve, përkatësisht donacioneve nga Fondi i mirëbesimit të ngritur në Bruksel dhe, natyrisht, duke shpenzuar dhe menaxhuar në mënyrën më të drejtë të mundshme buxhetin që është paraparë për vitin 2010 nga ana e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ky buxhet besojmë se do të arrijë që t'i plotësojë të gjitha kapacitetet tona për vitin 2010, që nënkupton prioritetet me realizimin e objektivave tona, që nënkupton personelin dhe regrutimin aktiv të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë për vitin 2010, do të mbajë në nivel të lartë bashkëpunimin rajonal dhe bashkëpunimin me vendet mike në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, do të arrijmë që të kemi stërvitjet e parapara për vitin 2010, do të arrijmë që të kemi pajisjet dhe armatimin individual dhe kolektiv për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë, sikurse që do të arrijmë të kemi infrastrukturën për punë, jetë dhe mësim sa më të mirë të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë.

Gjithashtu ky buxhet mundëson mbajtjen e gatishmërisë për ngritjen e kapaciteteve të plota operationale, synim yni që do të jetë deri në vitin 2012.

Pra, buxheti aktual është një buxhet i cili ka gjetur një mirëkuptim të plotë në Qeveri, ka gjetur një mirëkuptim të plotë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe jemi shumë të bindur se do të gjejmë mirëkuptim për gjithë Parlamentin, në mënyrë që të japim një përparësi të dukshme shpenzimit të buxhetit sipas kriterëve dhe standardeve të NATO-s. Ne do të arrijmë që brenda afatit të përcaktuar kohor t'i kemi të gjitha projektet të cilat janë të parapara për vitin 2010, duke i shtuar asaj edhe bartjen prej 1.864.000 euro për projekte kapitale nga viti 2009 në vitin 2010 kur ju keni parasysh faktin që Ministria e Forcës së Sigurisë nga 15 qershori ka arritur të marrë menaxhimin e plotë të buxhetit dhe shpenzimin e buxhetit që ka qenë paraparë për vitin 2009.

Dhe, krejt në fund, të them edhe një fjalë që ndoshta në këtë rast duhet thënë jo për emocion ose jo për një paragjykim, por vërtet buxheti është një shpërndarje e drejtë dhe proporcionale dhe mbi bazën e kriterëve të cilat kanë qenë të parapara për të gjitha komunat dhe për të gjitha njësitë buxhetore në mënyrë të njëjtë. Dhe buxheti i Republikës së Kosovës në Qeverinë e Kosovës është miratuar më 31 tetor, që nënkupton se nuk ka pasur mundësi të ketë asnjë paragjykim dhe asnjë parashikim për emra të veçantë apo personal. Mendoj që është mirë ta lexojmë Ligjin për financat lokale dhe Ligjin për financat publike të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të jemi shumë më të saktë në prognozime, po të jemi shumë më të saktë edhe në vlerësime për buxhetin që e bëjmë. Buxheti është një buxhet mirë i punuar dhe nga ana jonë do të ketë përkrahjen e plotë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, le të përgatitet Hafize Hajdini.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Planifikimi dhe ndarja e buxhetit janë ndër përgjegjësitë kryesore tonat si deputetë karshi qytetarëve të Kosovës, taksapaguesve të tij.

Buxheti i planifikuar për vitin 2010 kap shumë një miliardë e 23 milionë euro, të hyra këto të cilat planifikohen të mbushin buxhetin për këtë vit.

U thanë shumë për mënyrën e planifikimit dhe të ndarjes së tij që vërtet duhet respektuar, por sidoqoftë është bërë praktikë që këtu diskutimet të përfundojnë dhe më tutje të mos futen dhe të mos inkorporohen në pjesën e buxhetit, të paktën as edhe një përqindje e vogël e tyre.

Sido që të jetë, Qeveria gjatë fushatës elektorale premtoi qindra miliona euro investime nëpër komunat e ndryshme të Kosovës. Dështoi në planifikim për vitin 2010, premtoi por nuk e bërë këtë dhe dështoi. Dështoi në planifikim, do të dështojë edhe në qeverisje. Sipas këtij buxheti, Qeveria dhe shteti i Kosovës në përgjithësi e ka vështirë të funksionojë, normalisht, pasi që do të kemi probleme të mëdha sociale, papunësi, mundësi minimale të zhvillimit ekonomik, shërbime të ulëta të nivelit shëndetësor, arsim pa reforma, e çfarë mund të presim nga kjo.

Megjithatë, unë ndjej obligim të shpreh shqetësimet e mia rreth buxhetit të Agjencionit Rregullativ të Telekomunikacionit rreth kompensimit për paga. Pagat e këtyre shërbyesve janë më të ulëta se në çdo autoritet rregullativ tjetër që rregullon një sferë të veçantë të shoqërisë. Sido që të jetë, ne kërkojmë që te këta punonjës të bëhet një rritje për pagat e këtyre punëtorëve sepse, të paktën këtu, krahasuar me autoritete të tjera kemi një diskrepancë apo mospërputhje diku rreth raportit 1:5, që është një rrogë mesatare, te autoriteti rregullativ sillet 250 deri 300 euro. Kërkojmë rritjen apo edhe harmonizimin me autoritetet tjera.

Gjithashtu, është edhe kërkesa tjetër për rritjen e pagave të shërbyesve civilë, kategoria që më së paku janë përkrahur deri më tash apo mos të themi fare janë përkrahur. Ka qenë një përkrahje minimale nga viti i kaluar 10% nga paga bazë, që vërtet pak ka reflektuar. Do të isha mirënjohëse nëse respektohen këto ose futen në buxhet edhe pse shumë pak besoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër, a e deshe fjalën. Urdhëro!
Fjala kryeministrit Hashim Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha vetëm të theksoj se në përcaktimin për këtë buxhet ne kemi punuar, do të thotë, shumë ngushtë me ekspertë edhe vendorë, edhe ndërkombëtarë, edhe me këshillat edhe rekomandimet, por dëshiroj të theksoj se ne kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë

për një Kosovë si shtet i pavarur, për një Kosovë unike, si tërësi, do të thotë, është një buxhet për Kosovën, për shtetin e Kosovës, për gjithë qytetarë dhe në shërbim të të gjithëve, është buxhet i të gjithëve. E kuptoj se është kohë e fushatës elektorale, por dëshiroj të theksoj se edhe pretendimi politik për regjionalizim të Kosovës është më tepër i ulët se sa politikë. Mendoj se duhet ta shikojmë vendin si një dhe si tërësi, por edhe dëshiroj të theksoj se ky buxhet dhe ky vizion i zhvillimit, të ndërtimit dhe të perspektivës evropiane duhet të na bashkojë dhe t'i lëmë anash disa mëri të interesave të fushatës elektorale lokale, por do të ishte gjithashtu me rëndësi që të bëhen krahasime kur flitet për investime nëpër lokalitete të caktuara, sepse nëse bëjmë krahasime të cilat nuk dëshiroj t'i prezantoj sot për shkak të rrethanave që jemi në këtë periudhë politike, për dy vite Qeveria që e udhëheqë unë ka investuar më tepër në çdo komunë të Republikës së Kosovës se sa në shumë vitet e kaluara qeveritë tjera. Sikur të mos ishte fushatë elektorale, do t'i krahasoja një nga një të gjitha. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Hafize Hajdini, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

HAFIZE HAJDINI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi e kemi sot në rend të ditës buxhetin 2010, dua ta falënderoj Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve që kanë bërë vizitën në fshatin Dubravë, në komunën e Ferizajt, dhe e kanë parë gjendjen e këtij komuniteti, në çfarë kushtesh jetojnë fëmijët e komunitetit ashkali. Pasi që ka nevojë edhe komunat tjera për ndërtimin e shtëpive të këtij komuniteti, pyetja ime është për ministrin e Financave apo kryeministrin – në buxhetin 2010 a janë të planifikuara ndërtimi i 44 shtëpive të familjeve me gjendje të rëndë sociale, pasi që keni bërë Memorandum mirëkuptimi në mes të Zyrës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale? Faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Faleminderit! Zonja Kaqusha e ka fjalën, pastaj Danush Ademi.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

I nderuari kryesues!

I nderuar kryeministër, ministra dhe kolegë,

Buxheti për vitin 2010, të cilin po e shqyrtojmë sot, mendoj se është përfshirës, është përgatitur mirë dhe ka mundësi, pasi është dhënë në detaje, edhe të krahasohet me vitin 2009. Prandaj, unë në tërësi këtë propozim e përkrah, sidomos që është harmonizuar me ministrive dhe gjithashtu është harmonizuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Por kisha pas dëshirë t'i jap edhe katër sugjerime.

Një prej sugjerimeve, në fillim ku janë përfshirë hyrjet e përgjithshme buxhetore, janë dhënë cilat janë ato burimet dhe unë mendoj se ato janë reale, por kur është një prej burimeve të hyrave, rritja e vazhdueshme e importit, që ndikon në ngritjen e të hyrave

nga kufiri, mendoj se objekti ynë duhet të jetë që të mbulojë me eksportin sa më shumë importin sepse dihet se importi është një prej shkaqeve edhe të inflacionit, e gjithashtu edhe të uljes së standardit pasi importojmë shumë. Është burim kufitar, krejt është në rregull, por si synim duhet të jetë e kundërta, duhet të theksohet më shumë që rritja e buxhetit duhet të bazohet në zvogëlimin e ekonomisë jo formale dhe gjithashtu në zbatimin e funksionimit të ligjit.

Sugjerimi i dytë për Ministrinë e Transportit dhe Postelekomunikacionit mendoj se duhet të përfshihet në objektivat e Ministrisë, ku janë 5. Edhe unë pajtohem se është dhënë edhe prioriteti i infrastrukturës rrugore, sidomos integrimi i saj në rrjetin Trans-Ballkanik edhe korridorin kryesor Merdarë Kukës-Durrës dhe mjaftë kemi orientuar mjetet në përmirësimin e strukturës rrugore ekzistuese, në ndërtim dhe mirëmbajtje. Por, çka mungon këtu? Që sa vjet po i ndajnë mjetet e mëdha për ndërtimin, që është në rregull, nuk është bërë asnjë hap në organizimin e brendshëm dhe riorganizimin e administrimit rrugor. Unë mendoj se kemi ardhur në situatë asisoj se nuk kemi mundësi të mbikëqyrjes as të ndërtimit, as të mirëmbajtjes, edhe me numrin, por edhe me kualifikimin e njerëzve, prandaj po propozoj që edhe një objektiv të shtohet - objektivi i gjashtë, që të bëhet riorganizimi, administrimit rrugor për menaxhimin më të mirë të mjeteve të cilat ndahen për këtë destinim, e nuk janë aq të vogla.

Gjithashtu, kam rezervë për lejen që të jepet në koncesion Aeroporti i Prishtinës. Mendoj se duhet të merren të gjitha eksperiencat pozitive, edhe ato dështimet edhe në rajon dhe mendoj, pasi kemi përfitime dhe një punë të mirë në Aeroport, ndoshta nuk duhet bash aq të ngutemi.

Sugjerimi i tretë, është për Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Mirë është që është përkrahja financiare edhe më tutje e ndërtimit të objekteve shkollore, pajisjet e tyre, shpërndarja e teksteve dhe nevojat tjera, por mendoj se nuk i është dhënë mjaft rëndësi arsimimit të lartë dhe zhvillimit të kërkimeve shkencore. Prandaj, propozoj se duhet kësaj pjese t'i jepet më shumë përkrahja financiare, se një sistem i fortë arsimor me njerëz të diplomuar, të aftë, me njohuri të lartë me siguri mund t'iu japin një shtytje të fortë zhvillimeve pozitive.

Dhe, në fund, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Mirë kishte qenë që gjithkund në botë misioni i Ministrisë së Punës të jetë që qytetari i Kosovës të jetojë me një shoqëri të bashkuar, pa varfëri, me...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Jashari, zoti Danush Ademi, të bëhet gati zoti Arsim Barjami.

DANUSH ADEMI: I nderuar zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeverisës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në këtë projektligj për buxhet, sikurse edhe në vitet e kaluara shihet se sa u përket komuniteteve të tjera joshqiptare të cilat jetojnë në Kosovë, mbeten të lënë disi pas

dore. Nuk e di pse bëhet kjo, por duhet të mendohet për ta, për të gjithë, ndoshta jo në formë të barabartë, por së paku të kemi diku rreth 10% të projekteve në investimet kapitale të komuniteteve tjera.

Nuk di se në gjithë këto shifra të cilat janë të paraqitura, a janë edhe projektet apo janë vetëm shifrat e imagjinuara. Kisha dashur që projektet të jenë të sakta dhe jo në fund të vitit të dalin që një ministri e cila për shkak të mos përcjelljes së investimeve kapitale, del në fund se ka pasur mjete edhe për investime tjera të cilat do të ishin jetike për çdo komunë. Pra, të menaxhohet buxheti mirë dhe jo në fund të kemi deficit të mjeteve.

Do të isha ndalur pak te Ministria për Komunitete dhe Kthim. Shihet qartë se kjo Ministri mendon vetëm për një komunitet, atë serb dhe jo për komunitetet tjera të cilat jetojnë në Kosovë.

A mund të më thoni se cili projekt parasheh edhe investimet kapitale te komunitetet tjera pakicë të cilat janë joserbe, të cilat jetojnë në Kosovë. Është një pozicion atje te kthimi i organizuar, ku janë ndarë rreth 90.000 euro. Kjo shumë mendoj se është e pamjaftueshme për organizimin që po mendohet dhe kjo është e paraparë vetëm për vitin 2010, kurse për vitin 2011-2012 nuk parashihet fare.

Pastaj, shkruhet se janë rreth 7.5 milionë euro për projektet e paspecifikuara. Çka në fakt janë këto projekte pa specifikuara? Pse nuk është dhënë apo nuk është paraqitur një plan konkret ato se ku do të harxhohen këto mjete, kurse për tri vitet ndahen vetëm 2 milionë euro për ndërtimin e shtëpive. Mendoj se këtu lihet shumë për të diskutuar. Kisha kërkuar që këto pika të rishikohen edhe një here, që mjetet të shkojnë në vendin e duhur dhe të caktohen për rindërtim, ku ne si komunitet ashkali, romë dhe egjiptas kemi nevojë për rindërtim të shtëpive, ku vetëm në Kosovë në kushte të vështira, në kushte ekstreme jetojnë 547 shtëpi.

Duke e ditur se dita-ditës për shkak të kushteve, shumica e fëmijëve të komunitetit tonë po e ndërpresin mësimin, mendoj se Qeveria duhet të mendoj edhe në këtë aspekt. Asnjë projekt nuk parashihet për uljen e analfabetizmit dhe stimulim të nxënësve për ta ndjekur mësimin.

Një vërejtje tjetër që arrita të hasë, është se në spitalin e Ferizajt edhe kësaj here nga ana e Ministrisë për Shëndetësi shumë pak investime po bëhen, edhe pse duhet të përkrahet më shumë ky spital, i cili ka vetëm 160.000 banorë, duke mos përfshirë edhe komunat tjera: Kaçanikun, Hanin e Elezit dhe Shtërpçën.

Të nderuar, nuk mund të themi se nuk ka investime, por shpërndarja e tyre po bëhet në disa raste jo në mënyrë të duhur. Ju kisha lutur, të nderuar anëtarë të kabinetit, më thoni se në cilën vend keni paraparë përmirësimin e kushteve të jetesës për komuniteteve tjera. Edhe fëmijët kanë nevojë për një fushë sportive apo ndonjë aktivitet për të rinj. Këtu nuk po e shoh se është paraparë në këtë projektbuxhet. Edhe ne jemi pjesë e këtij shteti dhe kërkojmë që edhe shteti i Kosovës të mendoj për ne, e jo të presim ndoshta mos po shkrep ndonjë donacion nga jashtë. Në fund të fjalës sime, si rekomandim po

jap dhe dëshiroj që ky rekomandim të shqyrtohet që 10% të buxhetit nëpër komuna dhe nga vetë ministritë të jenë të obligueshme të shfrytëzohen edhe ato në mënyrë të barabartë edhe për komunitetet tjera, jo vetëm për komunitetin serb që jeton sot në Kosovë.

Zoti ministër, si rekomandimi i imi, viti 2010 të jetë vit që vlen të mbahet në mend nga familjet që ballafaqohen pa kullm mbi kokë. Unë mendoj që prioritet t'i jepet rindërtimit të shtëpive për të gjitha rastet sociale që i kemi në Kosovë. Në këtë vit, së paku 50% të asfalteve që janë paraparë të punohen në vitin 2010, të bëhen në vitin 2011, sepse nëpër çdo natë para ekranit po shohim se në çfarë kushtesh jeton komuniteti ashkali, egjiptas, romë dhe të tjerët. Viti 2010 të jetë vit i ndërtimit, t'iu kushtojmë më shumë rëndësi njerëzve të varfër se sa veturave luksoze. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ademi! Fjalën e ka zoti Arsim Bajrami, le të bëhet gati zoti Gani Koci.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fillim t'i jap mbështetje të plotë buxhetit të përgatitur nga Ministria e Financave, si një buxhet profesional, i ekuilibruar dhe buxhet që merr parasysh kapacitetet e vendit tonë. Po ashtu, më lejoni të mbështes planifikimin që është bërë për Ministrinë e Administratës Publike, e cila përkon edhe me planifikimet e zhvillimit të kësaj Ministrie në vitin e ardhshëm. Dëshiroj që fillimisht që të tërheq vëmendjen që kapacitetet e agjencive buxhetore nuk do të varen vetëm nga buxheti, por shumë agjencione buxhetore kanë arritur të sigurojnë edhe donacione nga donatorët ndryshëm që do të zgjerojnë kapacitetet zhvillimore të tyre. Fillimisht, dëshiroj të falënderoj Ministrinë e Financave që ka planifikuar mjetet fillestare për fillimin e reformës së implementimit të Ligjit për shërbim civil dhe të Ligjit për paga. Është jashtëzakonisht pozitive që Ministria e Financave ka ndarë 5 milionë, të cilat do të përdoren në vitin ardhshëm për hapat e parë në drejtim të reformës së Shërbimit civil dhe të sistemit të pagave. Ju e dini, të nderuar deputetë, se ne kemi miratuar në leximin e parë këto dy ligje dhe e dini zotimin tonë që në fillim të vitit të ardhshëm të fillojmë këtë reformë esenciale për krijimin e një administrate publike. Këto mjete do të shërbejnë për fillimin e klasifikimit të shërbyesve civilë dhe krijimin e sistemit të ri të pagave konform me këtë legjislacion.

Gjithashtu, dëshiroj që t'ju njoftoj që përpos këtij planifikimi buxhetor nga Ministria e Financave, ne kemi arritur që me donatorë të sigurojmë edhe përafërsisht të njëjtin buxhet nga donatorët tonë, nga Klubi i donatorëve të cilët do ta mbështesin edhe implementimin e reformës së shërbimit civil dhe të sistemit të pagave, por edhe rritjen e kapaciteteve të agjencioneve që brenda Ministrisë së Administratës Publike, konkretisht te Agjencioni Kadastral i Republikës së Kosovës dhe Enti i Statistikave. Mjetet e destinuara për reformën e administratës publike kryesisht janë të orientuara në tri drejtime kryesore. Drejtimi i parë ka të bëjë me atë që ne e kemi proklamuar si projekt të qeverisjes elektronike apo të krijimit të një administrate moderne. Siç e dini, ne kemi një qeveri nacionale për qeverisje elektronike që është miratuar dhe sivjet kemi bërë

hapat e parë apo kemi promovuar dhjetëra produkte të aplikacioneve elektronike, që do të mundësojnë një azhuritë më të madh dhe një përqendrim të administratës për shërbimet e qytetarëve, kështu që 1/3 e buxhetit është planifikuar për vazhdimin e kësaj reforme të administratës publike dhe për projektet konkrete që dalin nga plani i veprimit të qeverisjes elektronike.

Gjithashtu, janë planifikuar mjetet për zhvillimi e aktiviteteve drejt regjistrimit të popullsisë. Ju e dini se regjistrimi i popullsisë do të mbahet në vitin 2011, por gjatë vitit 2010 ka një sërë aktiviteteve që do të mbështeten nga buxheti i Republikës së Kosovës, kurse Ministria e Financave për vitin 2011, besoj që do të zotojë dhe të planifikojë mjetet e nevojshme për regjistrimin e popullsisë, e cila ka një kosto tani të përlllogaritur. Duke pasur parasysh objektivin e Qeverisë së Kosovës për akomodim rezidencial dhe për akomodim sipas standardeve evropiane të ministrive, është parashikuar një buxhet i cili nënkupton krijimin e parakushteve për funksionimin e institucioneve të reja kushtetuese. Në buxhet të Kosovës është planifikuar ndërtimi i godinës së Agjencionit Kosovar të Inteligjencës, akomodimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë, e cila është në një akomodim të përkohshëm dhe në akomodim që nuk i plotëson nevojat e kësaj ministrie. Disa objekte që janë marrë nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës do të akomodohen dhe do t'u përshtatet nevojave të kësaj Force të Sigurisë. Gjithashtu, do të fillohet me projektin e ndërtimit të kompleksit qeveritar, projekt që do të ndërtohet në lagjen "Prishtina e Re" dhe tani gati kanë përfunduar të gjitha përgatitjet dhe është bërë fizibiliteti dhe do të fillojë ky projekt madhor që do të nënkuptojë akomodimin e mirë dhe të përshtatshëm të ministrive. Siç e dini, këto ditë kemi përruar edhe objektin e Rilindjes, ku së shpejti do të vendosen afër 4 ministri apo afër 800 zyrtarë dhe ky projekt sivjet po finalizohet dhe po mundëson që vërtet ne të ndërrojmë disproporcionin sepse para dy vitesh kemi pasur një situatë të pafavorshme, vetëm 37% të ministrive dhe të agjencioneve qeveritare kanë qenë në objekte publike. Tani kemi arritur që deri në fund të këtij viti plotësisht 100% të gjitha ministrisë, por edhe shumica e agjencioneve të pavarura të akomodohen në objekte të përshtatshme dhe të kenë kushte të përshtatshme.

Meqenëse Ministria e Administratës Publike është një ministri që kujdeset edhe për segmentet tjera të funksionimit të Republikës...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Fjalën e ka zoti Gani Koci, të bëhet gati zonja Edita Tahiri.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
U tha shumëçka rreth Projektbuxhetit. Unë do të ndalem vetëm në një segment, ndoshta që do të duhej vet ministri të na sqaronte më mirë, por duke pasur parasysh se i kemi marrë dy libra, një të vogël dhe një libër shumë të madh dhe nganjëherë nga librat e mëdhenj s'mund t'i qojmë, por së paku bile këta të vegjlit i kishim shikuar, i kishim parë shumë mirë disa sende dhe ajo që duhet të them, t'i orientojë të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në faqen 79, rreth mënyrave të përcaktimit të buxheteve komunale dhe të formulave që janë përdorë dhe përdoren akoma në përcaktimin dhe ndarjet nëpër komuna. Nuk do të binim në dilema këtu, librin e vogël e thashë se ata..., dhe nuk do të kishim rënë në dilemë të themi se kjo komunë mori më

shumë ose iu bë me hile kësaj komune tjetër. Sa e sa herë ne e kemi diskutuar ndoshta edhe në atë komisionin e grandeve, edhe si kryetar i komisionit e kam ngritur çështjen për kriteret e ndarjes, që nuk jemi pajtuar dhe nuk pajtohemi absolutisht me këto kriterë, por janë të vendosura dhe janë të vendosura për arsye të mungesës së një baze të të dhënave, të bazës statistikore dhe, natyrisht, me këto formula që përdoren sot pësojnë të gjithë dhe përfitojnë të gjithë në mënyrën e vet. Prandaj, është mirë t'i lexojmë këto.

Një çështje tjetër për sa u përket mënyrave të ndarjes, është mirë të shikohet edhe Ligji i buxhetit që i përcakton disa kufi dhe disa norma, por ajo çka është kryesore, tha edhe ministri në fjalën e vet hyrëse se është i vetmi buxhet, ndoshta, që e ka një pajtueshmëri me të gjitha institucionet ndërkombëtare monetare, siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, që është një kusht i mirë që Kosova edhe të përmbushë obligimet të cilat ka marrë, por edhe të futet ndoshta në obligime të reja, në mënyrë që t'i përmbushë këto katër prioritete që janë dhënë që në fillim, si nxitjen e zhvillimit ekonomik, stabilitetin më të madh social dhe zbutjen e varfërisë, pastaj fuqizimin e qeverisjes së mirë, promovimi i zhvillimit të mëtejshëm dhe të konsolidimit të institucioneve.

Në faqen 11, e kemi një grafikun dhe kemi parë se si është ndarë ose si është shpërndarë tërësia e buxhetit. Kaq janë kufijtë, nuk ka kufi, nuk mund t'i rrisim, siç kemi pasur mundësi t'i rrisim votat diku - diku. Këto janë dhe kjo është dhënë kështu dhe nuk ka asnjë mënyrë tjetër përpos këtyre kufijve buxhetor. I kemi diku 400 milionë investime kapitale, që janë diku për 3% më shumë se sa ato që kanë qenë të projektuara në vitin e kaluar. Kur është deklaruar Qeveria për uljen e shpenzimeve, sigurisht ka pasur parasysh të mallrat dhe shpenzimet që është një ulje e ndjeshme, po them, është diku 2%, megjithatë është ulje e shpenzimeve dhe po ashtu të subvencionet dhe transferet kemi një ulje diku prej 8%, që unë konsideroj se është një planifikim i mirë dhe i drejtë i Qeverisë në këtë rast.

Për sa i përket forcimit të institucioneve, ju e dini shumë mirë se në vitin e kaluar dhe vazhdojmë akoma edhe në këtë vit me krijimin e institucioneve të reja që dalin nga statusi i Kosovës, por edhe nga Pakoja e Ahtisarit, është përmendur këtu edhe në këtë Projektbuxhetin. Megjithatë, krijimi i atyre institucioneve krijon obligime edhe buxhetore, siç e përmendi ministri për Forcën e Sigurisë, pastaj e kemi Shërbimin e Inteligjencës, Policinë dhe shumë shërbime tjera që megjithatë deri dje ndoshta i kemi mbajtur me donacione, sepse kemi pasur donacione më shumë dhe tash janë barrë ekskluzive e buxhetit të Republikës së Kosovës. Desha një fakt ta them për hir të opinionit, jo të atyre që janë në sallë këtu, sepse ata e dinë mirë, në Skenderaj në vitin 2009 ka pasur 1.770.000 euro investime kapitale dhe prej këtyre vetëm në nëntëmujorin janë realizuar 75%. Në Deçan ka pasur 1.343.000 euro investime kapitale, do të thotë diku për 400.000 euro më pak paska marrë Deçani se Skenderaj në këtë rast, ndërsa ka realizuar vetëm 48% dhe në Prishtinë kanë qenë 27.900.000 euro investime kapitale, prej të cilave deri më tash janë realizuar vetëm 12.000.000, janë zotuar 3.000.000, shkalla e realizimit ose progresi i realizimit është 46%. Prandaj, ...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Koci! Fjalën e ka zonja Edita Tahiri, të bëhet gati zoti Heset Cakolli.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në përgjithësi mendoj se Projektbuxheti është i projektuar mirë, duke marrë parasysh këto katër prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe mendoj se debati i sotëm nxori disa ide dhe propozime shumë të rëndësishme që do të duhej të merreshin parasysh, natyrisht, në bazë të prioritetit. Unë personalisht do të ndalesha në disa çështje që nuk u thanë dhe që mendoj se kanë peshë. E para, dua të koncentrohem te debati që u tha për Prishtinën, që mendoj se ishte konstruktiv, por unë mendoj se një pjesë e debatit do të duhej të përqendrohej në Veri të Kosovës dhe mendoj se çështja e shtrirjes së sovranitetit të Kosovës në Veri dhe zhbërja e strukturave paralele është një investim kapital dhe duhet të konsiderohet në kuadër të investimeve kapitale.

D dyta, mendoj se në kuadër të forcimit të institucioneve tona, do të ndalem në shtëpinë tonë. Mendoj se Kuvendit të Kosovës i takojnë më shumë financa sepse ne ende edhe pas dhjetë vjetësh të përfundimit të luftës nuk kemi zyra për deputetë edhe detyrohemi të takojmë delegacione dhe qytetarë nëpër kafiteritë e Parlamentit. Po ashtu, dihet se diplomacia parlamentare tashmë është një komponentë e re në aktivitetet parlamentare në krejt botën dhe këtu ne nuk kemi shumë përkrahje për shkak të financave. Ta përmendi veç Komisionin për Integritet Evropian, ku jam unë vet. Nuk kemi pasur asnjëherë përkrahje prej Parlamentit për udhëtime, vetëm me donacione, për shkak të mungesës së financave.

E treta, dua të përmend që do të duhej t'i kushtojmë rëndësi përmirësimit të kushteve materiale të sektorit në shëndetësi, në arsimimin fillor dhe të mesëm, sepse Universiteti me të vërtetë mori një përkrahje shumë të mirë në këtë drejtim, polici dhe pensione.

E katërta, dua të ndalem te një buxhet, ndoshta askush nuk e ka përmendur, do ta përmend unë. Besoj se duhet të krijohet një buxhet që të ndihmojë zgjidhjen e çështjes banesore të njerëzve, të liderëve që dhanë kontribut për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, sepse ka një listë e gjatë e njerëzve, disa kanë gjetur rrugë e zgjidhjes së problemit, por disa të tjerë ende sot pas 20 vitesh nuk kanë banesë, nuk dua të përmend me emra, besoj dihen kush janë ata.

Pastaj, dua të ndalem te Këshilli për Trashëgimi, një mekanizëm që u formua, pra, sivjet dhe i cili mori përkrahjen financiare, por ende nuk i ka marrë mjetet financiare dhe po ashtu për vitin e ardhshëm ka rënie, ka marrë vetëm 141.000 dhe unë mendoj do të duhej të marrë më shumë për shkak se janë në fillim të formimit, aq më shumë që ky këshill po ballafaqohet me disa ndërhyrje politike. Unë besoj se ky është një mekanizëm i pavarur që duhet të bëjë kontrollin e trashëgimisë në Kosovë.

Dhe, e fundit, desha të kërkoj që të ketë një linjë buxhetore për fuqizimin e grave, sepse të gjithë e kemi plotë gojën barazi gjinore, por kur nuk ka buxhet, nuk ka mundësi as Ligji për barazi të implementohet, as Rezoluta 1325. Ka edhe shumë çështje tjera, por unë do të ndalem këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Tahiri! Fjalën tani e ka zoti Heset Cakolli, të bëhet gati zonja Vezira Emrush.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2010, duhet të rregullohet me ligj në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ky Projektligj duhet të aprovohet në këtë Kuvend të respektuar. Në tabelën numër 1, është dhënë totali i të hyrave në vlerë prej 1.029.200.000 euro dhe totali i shpenzimeve primare në vlerë prej 1.146.600.000 euro. Do të thotë se totali i shpenzimeve primare është më i madh se totali i të hyrave në vlerë prej 117.400.000 euro për vitin 2010. Vetvetiu shtrohet pyetja - si do të sigurohet kjo diferencë e mjeteve financiare? Edhe pse kryeministri i Qeverisë i sqaroi disa nga burimet e mundshme, mbetet që të shihet në të ardhmen se a do të përmbushet, do me thënë, ky deficit buxhetor. Në tabelën numër 2, janë paraparë ndarjet buxhetore për investimet kapitale në vlerë prej 400.500.000 euro për organizata buxhetore të nivelit qendror dhe komunal, ndërsa me rishikim të buxhetit për vitin 2009, kanë qenë të parapara për shpenzime në investime kapitale 470.500.000 euro, që do të thotë diku 70 milionë më pak për vitin 2010, ndërsa për paga dhe mëditje janë paraparë 18 milion euro më shumë në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009.

Shtrohet pyetja – a janë shpenzuar të gjitha mjetet e parapara me rishikim të buxhetit për vitin 2009 nga institucionet buxhetore të ndryshme?

Të nderuar deputetë,

Unë besoj se secili nga ne dhe çdo qytetar i gëzohet çdo projekti të realizuar në territorin e Republikës së Kosovës, e që ka të bëjë me përmirësimin e jetës së qytetarit, por unë mendoj se përcaktimi i prioriteteve të projekteve është relative, pra është mirë që ato prioritete të jenë me interes për një numër më të madh të qytetarëve të Kosovës. Unë me këtë rasat kisha përmendur, për shembull, autostrada Prishtinë – Hani i Elezit, si dhe autostrada Morinë-Merdare, që janë gjithsesi me interes për Kosovën. Por, shtrohet pyetja – cilës autostradë duhet t'i jepet prioritet si dhe shumë projekteve tjera të parapara me buxhetin për vitin 2010. Prandaj, debati në këtë Kuvend ka për qëllim paraqitjen e opinionëve të ndryshme të deputetëve lidhur me shpenzimet kapitale të buxhetit të Kosovës. Unë me këtë rast kisha përmendur se në komunën e Ferizajt janë paraparë gjithsej investime kapitale për vitin 2010 – 5.845.000 euro, ku 3.730.000 nga grandet qeveritare dhe 2.100.000 nga të hyrat vetjake. Është mirë që Qeveria të angazhohet që të ndajë mjete shtesë për investime kapitale për këtë komunë, sepse buxheti nga të hyrat vetjake nuk ka mundësi të mbështes shumë projekte me interes për qytetarët sepse shumë vendbanime në këtë komunë kanë nevojë për kanalizime, ujësjellës dhe infrastrukturë rrugore. Gjithashtu, duhet të vazhdohet edhe ndërtimi i rrugës Ferizaj – Rahovicë, sepse kjo rrugë lidhë 9 fshatra me qytetin dhe ka ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të kësaj komune.

Në tabelën 4.5 shihet se me planin afatmesëm komunal është paraparë që të ndërtohet rruga unazore që lidhë këto vendbanime: fshatin Talinoc, Rahovicë, Mirash dhe Babush, do të thotë në vitin 2012, por unë mendoj se kjo rrugë duhet të fillohet të ndërtohet, nëse ka mundësi, dhe të krijohen burime buxhetore në vitin 2010, për arsye të cekura më lartë.

Edhe sektori i arsimit duhet të ketë synim kryesor zhvillimin e një sistemi efektiv arsimor në të gjitha nivelet. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka paraparë buxhet për shpenzime kapitale 24.700.000 për vitin 2010 dhe ky buxhet është më i vogël për 21 milion, krahasuar me vitin 2009. Mirëpo, unë mendoj se tani është koha që të investohet edhe në rishikimin e plan-programeve dhe të teksteve mësimore, të mjeteve konkretizues dhe të teknologjitë informative, si dhe në shkencë kërkimore dhe hulumtuese, e jo vetëm në objekte shkollore, me qëllim që nxënësit dhe studentët të jenë të aftë të futen në tregun e punës në vendet e rajonit dhe në vendet e Evropës. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Eset! Fjalën e ka zonja Vezira Emsush, të bëhet gati zoti Rustem Mustafa.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam predsedavajućeg,

Vladu i kolge poslanike,

Danas imamo pred sobom razmatranje planiranog budžeta za 2010. godinu. Moram da kažem, pored toga što sam čula od svih kolega da ovaj budžet nema razvojnu politiku, što i sama tvrdim iz prostog razloga zato što je planiaran, ovo je planiran budžet troškova, nećemo da ponavljamo šifre, da je potrošnja veća od prihoda, to znamo svi.

Medjutim, to što hoću da dam segment danas, jesu davanja koja vidim, koja se ponovo daju za elektroprivredu, sredstva, subvencije od 50 miliona ponovo KEK-u i 80 miliona za razvoj. Smatram da ova Vlada treba da prestane sa ovakvom politikom investiranja u javna preduzeća koja su dužna da sama steknu svoj doprinos, svoj dohodak i da pune, rekla sam, budžet Kosva, a ne da prazne. Ja ću da pročitam jedan član iz Zakona o današnjem budžetu koji smo dobili i koji Vlada autentično krši davanjem sredstava elektroprivredi. Citiram, član 17: „Ministar je ovlašćen da odredjenim entitetima u skladu sa članom 52. Zakona o preduzećima u javnom vlasništvu, kao što je definisano Zakonom o javnom preduzeću, broj o3-L/087, da dodeljuje povratni zajam u iznosu koji je u skladu sa uslovima i rokovima koji su odobroni od strane Vlade“. Odobraeni iznosi za takve zajmove ili kredite, dodeluju se na osnovu ovog zakona i prikazani su u tabeli 1. Medjutim, šta kaže zakon? „Povratni zajam ili kreditna sredstva zasnivaće se na sporazumu koji će se zaključiti izmedju odredjenog entiteta i javnog preduzeća koja prima zajam ili kreditna sredstva i ministra i koristiće se samo za kapitalne troškove“. Meni je žao što predsednik, gospodin Gani Koci, nije pročitao ovaj član 17. i kada je radio u Komisiji nije sprečio davanja od 50 miliona namenske za kupovinu energije. To su samo sredstva za kapitalne investicije, a mi znamo da i dalje Elektro kompanija nije koristila namenski, da nema u izgradnji ni jednu kapitalnu investiciju. Miliardu ipo dali smo do sada ovaj kompaniji i mislim da je to previše.

Drugo što hoću da dam segment, zato što mi je vreme ograničeno i meni je mnogo žao što ima malo vremena, a ima puno toga da kažem korisnog, drugo kada su ovo grantovi, kada se radi o opštinama, neću da zalazim koliko je koja opština dobila, ali moram da kažem da se budžet ne slaže, analitika i sintetika se ne slaže. Osnovnu matematiku moramo da znamo svi a ovde u budžetu, ja otvaram stranicu 13. kada su u pitanju kosovski budžet i opštinske kapitalne investicije za 2010. godinu, kapitalane investicije da Dragaš, opština Dragaš. Ja moram da kažem da u opštini Dragaš imamo ukupna kapitalna investicija, kada je u pitanju, pored albanske, druga zajednica, goranska i bošnjačka zajednica, koja sa procentom stanovništva imaju odnos 49-41, ukupna sredstva za investicije puteva, kanalizacije, infrastrukture i ostalo je 1.461.000 eura, od toga je 530 euro samo, skupila sam pozicije koda, samo 530 euro se daje za bošnjačku i goransku zajednicu, a dok su ostala sredstva u iznosu od 50%, 100% , dakle 50% više albanskoj zajednici, albanskim selima.

Ovo kažem iz ovog razloga i jako me zabrinula mogućnost da je ovde, da li je namerno ili matematička greška, Zli potok pojavljuje se dva puta sa izgradnjom puta, jednom sa pozicijom od 200 hiljada eura, jednom sa pozicijom 170 hiljada euro. Ovo dajem do znanja zato što mislim da se preraspodela sredstva ne vrši namenski, da je jako...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Emrush. Fjalën e ka zoti Rrustem Mustafa, të bëhet gati zoti Gani Buçinca.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Buxheti i Kosovës kësaj radhe teknikisht është i përgatitur mirë dhe ka ardhur me kohë. Unë besoj se kemi ndërtuar një buxhet të kënaqshëm tani, ndarja buxhetore nëpër vijat buxhetore është bërë e kënaqshme, mendoj, janë këshilltarët tanë dhe njerëzit që i kemi pyetur dhe thonë se një buxhet aq voluminoz, ka mundësi të shumta të lavdërohet, qysh edhe ka mundësi të gjendet diku edhe të sulmohet. Mua më intereson vija buxhetore për siguri, gjegjësisht në komisionin që unë e drejtoj kemi biseduar pagat e policëve sa e sa herë. Motivi dhe plani ynë është për ngritjen e pagave të policisë në nivel shumë më të kënaqshëm se që është bërë deri me tani. Unë e di dhe jemi të njoftuar se ka filluar të lëvizë kjo punë, por nuk është e kënaqshme me këto mundësi që janë bërë. Unë ndoshta e gjejë një pjesë të fajit te kapacitetet tona ndërtuese të programeve të buxhetit. Mund të ndodhë që ende nuk i kemi gjetur njerëzit që dinë t'i organizojnë kapacitetet në Ministri, për shembull, ose në vijën buxhetore për të bërë kërkesa të duhura pranë Qeverisë për buxhetin e Kosovës. Mirëpo, sido që të jetë, ne duhet të sigurohemi se do të përmbushen objektivat e Qeverisë, që tashmë janë objektiv, siç është lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për t'u siguruar në këto objektiva të Qeverisë, që tash janë publike, ne duhet që të ndërtojmë sisteme, ku pagat do të jenë të dinjitetshme për policët. Unë e di se kësaj radhe janë ndarë për këtë vijë buxhetore diku rreth 3 milionë. Mendojmë se nuk është e mjaftueshme, por na gëzon fakti se veç ka filluar kjo punë të ndodhë. Pres ta dimë dhe të fillojmë qysh tash të punojmë që brenda tri vitesh paga e

policit së paku të mos të jetë paga fillestare me e vogël se 500 euro për polic. Unë kisha dashur shumë t'i kushtojmë rëndësi, t'i zhvillojmë kapacitetet dhe sidomos t'i gjejmë njerëzit që dinë t'i organizojnë kapacitetet për të ndërtuar kërkesat dhe vijat buxhetore shumë mirë. Unë vi nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe do ta përkrahim buxhetin.

Dua të shprehë edhe një shqetësim timin sot për debatin që u fol për politikën regjionale. Kjo ka filluar të flitet te qytetarët që një kohë të gjatë, sot u fol edhe këtu. Ka filluar një punë e keqe. një punë e ligë të legjitimohet, të legalizohet, uroj që më vonë ta kontrollojmë dhe ta drejtojmë mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti Shkunbin Demalijaj.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ju përshëndes zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar dhe ju kolegë deputetë,

Aprovimi, përkatësisht diskutimi i projektbuxhetit për vitin e ardhshëm, është një ngjarje e rëndësishme, pa dyshim një nga ngjarjet më të rëndësishme, ndoshta, të një viti qeverisës. Unë mundem t'ju them se pavarësisht vërejtjeve dhe sugjerimeve, pavarësisht kritikave që u dhanë këtu dhe sugjerimeve jo dashamirëse të disa kolegëve deputetë, me kënaqësi mund të konstatoj se buxheti, megjithatë, është i balancuar dhe ruan balancat makro-ekonomike dhe përpiqet të bëjë, të ruaj edhe kohezionin brenda shoqërisë kosovare, duke respektuar edhe komponentet regjionale edhe komponentet demografike, ka edhe komponentet sociale, të gjitha i ka të stisura mirë dhe besoj që shënon një progres në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar. Këtu pati diskutime të cilat shkonin nga pikëpamja personale, krejtësisht interesa personale mes tyre, interesa regjionaliste deri te propaganda partiake, që mori përmasa edhe të fushatës. Nuk ka kurrgjë të keqe në këtë lloj diskutimi. Pa dyshim, Parlamenti është një vend ku shfrytëzohet edhe për propagandë politike, është vend ku ballafaqohen mendimet, idetë, pikëpamjet dhe konceptet e ndryshme dhe nuk e shoh si një tension apo si një diçka të jashtëzakonshme që po ndodhë vetëm në Parlamentin e Kosovës. Mua më brengos fakti se, siç e tha edhe parafolësi im kolegë, një mentalitet regjionalist, tribalist, për të cilin unë kam folur edhe më herët në këtë parlament, i cili po pretendon të marrë qytetari në Kosovë dhe të bëhet si normë politike, si normë e diskursit dhe e kulturës sonë politike...

KRYETARI: A je në temë Gani?!

... po në temë jam, sidomos vjen nga ata individë të cilët shpesh e përmendin Raportin e progresit dhe e përmendin se si ne, po pengon kjo Qeveri integrimin tonë evropian dhe, fatkeqësisht, mua më vjen keq për mendësinë e tyre tejet regjionaliste dhe tribaliste që s'ka të bëjë kurrgjë me mentalitetin evropian. Do të ishte mirë që këta kolegë të nderuar të fillojnë transformimin e tyre në formën e të menduarit dhe të qasjes, e pastaj të japin edhe kritika, se bien ndesh vet me konceptet e tyre politike. Mua askush nuk ka të drejtë të ma mohojë të drejtën time që unë ta dua Prishtinën, siç e dua Llapin ose

Drenicën ose Dukagjinin. Këto tendenca për të ... nga individë të caktuar ose parti të caktuara, regjionet e caktuara, për mua janë premisa shumë primitive. Mua më vjen shumë keq, mua më vjen shumë keq. Unë e po aq sa e dua, se kam të drejtë ta dua Prishtinën, e dua çdo cep të atdheut tim edhe jashtë kufijve administrativ të Kosovës dhe këto tendenca vijnë pikërisht për shkak të mungesës së vizionit, për shkak të vizionit të tyre dhe mungesës së tyre përkrah alternativave politike, alternativave programore. Këtu do t'i them mikut tim të nderuar, zotit Ismet, më kujtohet kur e përdorte dhe aq bukur i rrinte veshja jonë kombëtare kur vallëzonte dhe atëherë i kisha propozuar që ky të vesh vetëm veshjen e Llapit dhe mos të vesh veshjen kombëtare të regjioneve të tjera, ... po më duket se kohëve të fundit është bërë ma shumë llapjan se në kuptimin..., më shumë llapjan se sa shqiptar, a po me kupton, dhe më vjen keq se e kama mik dhe po e kam këtë të drejtë t'ia them. Sinqerisht....

(Ndërhyrje e Kryetarit: Gani, të lutem, nuk je në temë, nuk jemi në temë politike, e kemi buxhetin)

...është e vërtetë, e shfrytëzoja miqësinë time që e kam me Ismetin dhe respektin që kam për te, se nuk e besoj se kështu intimisht mendon, se besoj që kështu intimisht mendon. Kurse, në rasat se do të më pyeste mua dikush dhe do të varej prej dëshirës sime, unë tërë buxhetin e Kosovës e kisha çua vetëm për kulturë, sport edhe për asgjë tjetër. Ko do të ishte dëshira ime personale. Mirëpo, asnjë qeveri në botë nuk mendon kështu, qeveritë në botë mendojnë për hallet dhe problemet integrale të qytetarëve dhe bëjnë balanca dhe mundohen që në mënyrë proporcionale t'i plotësojnë ato nevoja të cilat i mundëson buxheti i Kosovës. Ismet, e di që ke për të marrë, ke për të bërë replikë, por prapë do të pimë kafe së bashku dhe do të jemi miq edhe në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro Ismet Beqiri, 2 minuta replikë.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit kryetar! Unë e di që Gani punon në RTK, por s'e kam ditur që është në pjesën e humorit, atë skemën programore të humoristëve. Sinqerisht, gjatë gjithë punës, unë nuk dua t'i arsyetohem Ganiut, por para opinionit, unë nuk e di, ky e përmendi petkun të kujt, unë sot kam diskutuar, as nuk kam përmendur Llap, nuk kam përmendur, dhe sigurisht s'e mohon asnjëri origjinën. Po e shfrytëzoj edhe njëherë rastin të them, unë kam diskutuar veçmas për buxhetin e Prishtinës, pa ia mohuar, ose trajtimin e Prishtinës pa ia mohuar të drejtën askujt që ta dojë Prishtinën, siç e tha edhe vet kryeparlamentari, që nuk e kontestoj edhe të asnjërit, por me të vërtetë kjo është, do me thënë, të mos ngutemi ta themi, është qesharake dhe të diskutojmë kështu në parlament kur është fjala për buxhet. Me gjithë respektin për Ganiun, por kjo lidhje nuk kishte me buxhet. Asnjëherë nuk kam biseduar jashtë buxhetit dhe nuk jam përcjellë me ato të regjionalizmave e të ngjashme. Prandaj, unë zoti kryetar, ju kisha lutur, e tha edhe vetë Ganiu që këtu lejohet çka të dush të flasësh dhe kësi hovi bash ia ka futur, me nderë me thënë, ka folur çka ka dashur.

(Qeshje dhe duartrokitje në sallë)

KRYETARI: Edhe ti nuk e le keq! Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

U tha publikisht se teknikisht ky projektligj është i punuar mirë. Me rëndësi për neve si deputetë, për qytetarët e Kosovës është se a është i punuar profesionalisht mirë, se teknikisht shihet se është i punuar mirë edhe është për dëshirën e vet spektrit që e ka ndërtuar, se nganjëherë po përzihen edhe kompetencat duke marrë mirënjohje edhe nga bashkësia ndërkombëtare për hartimin e një projektligji, i cili ende nuk ka kaluar as në lexim të parë, sot është në shqyrtim të parë.

Unë, fillimisht kisha thënë se ky projektligj duhet të kthehet mbrapa, të punohet edhe teknikisht në te, sepse në preambulën e tij, do të thotë, nuk ka kërkesë se kush e bën kërkesën që ky ligj të vijë në Parlamentin e Kosovës, vetëm është i bazuar në dy pika të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo e dëshmon më së miri se Qeveria nuk ka ligj dhe Qeveria pa ligj nuk mund të bëjë kërkesë. Andaj, edhe nuk kemi pasur nevojë që nocione dhe definicione të kemi në përkufizimet, do të thotë, në nenin e parë të projektligjit, sepse të gjithë deputetët ma merr mendja e dinë se çka do të thotë mëditje, bilanc, organizatë buxhetore e të gjitha këto, sepse ka ligje tjera që i rregullojnë këto fusha.

Në tekstin e projektligjit askund nuk shkruan kush është ekzekutues edhe mbikëqyrës i këtij buxheti edhe pikërisht për këtë neni 15 përfshin kush është ekzekutues, po thotë, zyrtarët financiarë, drejtori i Thesarit, zyrtari i lartë financiar në komunë edhe nuk përfshin kurrëgjë. Shumë pak kush ka përmendur sot se çka shkruan në tekstin e neneve të Projektligjit lidhur me këto çështje. Për vitin 2010, do të thotë, u ka dhënë më së shumti ministrave, ashtu sikur e kanë bërë deri tash dhe besojmë se gjatë vitit ose brenda këtij viti, fjalën do ta merr EULEX-i për gjithë atë gatishmëri që e ka paraparë dhe dikush duhet të hetohet për këtë çështje. Janë 149 milionë, 148 milionë që nuk dihet, Qeveria aktuale thotë se janë nënshpenzime për ta zbutur fjalën suficit edhe nuk dihet ku janë. Mirëpo, besoj se duhet ta dimë se EULEX-i duhet ta marrë fjalën edhe për të gjitha këto, sepse as brenda këtij projektligji nuk është asnjë normë sanksionuese lidhur me shkeljet që mund t'i bëhen këtij projektligji.

Ndërkaq, për pjesën tjetër të kornizës të organogramit të buxhetit, brenda për brenda u fol shumë, lokalizma, do të thotë nuk flitet për qytetarët e Kosovës, por flitet për komuna më të vogla ose bëhen krahasime mes Deçanit dhe Skenderajt. Dihet se janë komuna më të shkatërruara, mirëpo ne në fillim të shtatorit kemi pasur një deklaratë, në Epoka e Re nga vet kryetari i komunës të Skenderajt, që thotë për dy vite të menaxhimit tim, në komunën e Skenderajt kemi shpenzuar dhe janë investuar 21 milion euro, ndërkaq sot flitet për shifra të vogla. Unë them se ka hapësirë jetike për t'u investuar në Deçan, janë disa projekte jetike, por edhe të tjera humane që duhet të ndihmohen atje edhe të mos bëhen krahasime. U fol më herët për..., thotë se janë grandet qeveritare në vlerë 4 milionë që do t'i dorëzohen, do t'i jepen nga Qeveria e Kosovës Deçanit. Duhet të

lexohet mirë Projektligji edhe të shihet. Është një vlerë që përfshin edhe të hyrat vetjake që ofrohet në 1.060.000 euro. Mirëpo, është shumë e vogël për atë komunë, sepse është e domosdoshme.

Zvicra i ka disa kantone, mirëpo për vendosjen se kush është me të vërtetë zviceran, me kuadro është Sfisi, Kantoni i Sfisit, ndërkaq te politikat kadrovike duhet të kemi kujdes ndaj Deçanit, sepse për nga numri i banorëve është 90% më kuadër profesional edhe politik edhe më i shkolluar në Kosovë në të gjitha kohërat edhe normal se po injorohem edhe po ndihem i ofenduar kur dikush flet për Deçanin në këtë kontest. Ne mund të mos kemi përkrahje të kësaj Qeverie si komunë e Deçanit, mirëpo duhet të dihet, unë po flas në këtë rast, u bëra më lokalist, por edhe me një buxhet të tillë Klina nuk mund të ngrihet, sepse ata vuajnë për ujin e pijes, por edhe të gjitha komunat tjera në Kosovë, që në vazhdimësi janë duke u shkelur nga vetë kjo qeverisje.

Kisha thënë kushtimisht që deputetët të ndalen në avazin, se kryeministri tha nuk po dua të flas se jemi në fushatë zgjedhore. Zgjedhjet nuk janë ilegale në Kosovë, zgjedhjet janë institucionale, kemi pasur...

KRYETARI: Ju faleminderit! Nuk është mirë të manipuloni me 140 milionë, se unë jam i bindur se Drejtori i Departamentit që është duke na dëgjuar, ai qesh, se është e pamundur të humbin 140 milionë. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi. Hajt dy minuta. Gani Koci.

GANI KOCI: Ne dhe unë, nuk e nisëm me komuna të vogla, i nisët ju, zoti Shkumbin, krahasimet dhe unë i dhashë krahasimet me letra. Ju i folët paushall, unë i dhashë me letra dhe tash dua ta jap një me letër. Nuk janë 1.500.000 të hyra vetjake në komunën e Deçanit, por janë vetëm 500.000 euro. Ja ku janë të dhënat këtu, prandaj lexoje më mirë. Edhe një herë po e përsëris, buxheti i Republikës së Kosovës është ky, nuk është sikurse votimi dhe e mbushja e sanduqeve sa të kam qejf unë, ky është problemi. Prandaj, këta janë kufijtë buxhetorë, duhet t'i pranojmë, ose nuk duhet t'i pranojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjala është e deputetit Shkumbin, 1 minutë.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë as nuk ia përmenda emrin edhe dihet kush i ka mbushur sanduqet, dihet përqindja e daljes së njerëzve në zgjedhje në komunën e Deçanit edhe cila është norma....

KRYETARI: Sot buxhetin e kemi në pyetje.

...kjo është ajo çka po flet, ndërkaq për buxhetin i them Ganiut se kur të bisedojnë deputetët, le të jetë në sallë, mos të vjen të kyçet, veç hajt ndjeva diçka, se unë e di sa janë të hyrat vetjake të Deçanit, janë 500.000, ndërkaq letrat nuk të bëjnë punë, se ti ki letra boll, por përgjegjësia ka për të qenë në atë nivel sa besoj hetimet kanë për ta provuar. Shansi dhe ne obligativisht, jemi obligativ që në shqyrtimin e dytë në Komisionin që e drejton ti, zoti Gani, t'i thotë shifrat buxhetore për zgjedhjet qendrore

në vitin e ardhshëm, se nuk keni dhënë mjete për vitin e ardhshëm për zgjedhjet qendrore. Kjo ka për të qenë ai niveli i përgjegjësisë së juaj.

KRYETARI: Mos u bë merak për atë punë. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet Mark Krasniqi.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që duke ju përshëndetur, të shpreh që në fillim mbështetjen time për buxhetin e propozuar. Do ta bëja këtë edhe sikur të mos i takoja mazhorancës parlamentare. Mendoj se jemi në një fazë të tillë, në cilën duhet t'u gëzohemi të arriturave, pavarësisht nga vijnë. Unë i konsideroj edhe vërejtjet që i bëhen propozim-buxhetit si pasurim të tij dhe besoj kështu edhe do të akceptohet.

Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti se edhe propozim-buxhetit mund t'i bëhen vërejtje. Është evidente progresi në buxhetbërjen, është evident edhe progresi në zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës, që vërehet edhe në buxhet, madje edhe forma në të cilën na është sjellë buxheti, vërtet meriton të lavdërohet. Por, unë mbetem megjithatë i bindur se një disbalancë në ndërtimin e buxhetit, megjithatë ekziston. Janë përcaktuar kryesisht mirë prioritetet, por me të drejtë për mendimin tim mendohet edhe reflektohet a thua janë gjithmonë të renditura siç duhet prioritetet, a thua për shembull, me të vërtetë duhen të ndahen aq shumë mjete për KEK-un, pa bërë përpjekje që të funksionalizohet, më në fund, sistemi i pagesave dhe sado që të investojmë, nëse thesi mbetet i shqyer, do të jenë para e humbur. Mua më impresionon projekti i autostradës, por për mendimin tim, me të drejtë shtrohet edhe dilema- a thua duhet që në këtë fazë duhet të jetë edhe ashtu siç po projektohet deri në Merdar, apo bën një herë të jetë deri në Prishtinë, pastaj të shohim kah do të shkojë, me të parë me të bërë? Ose- jo, sepse po mendohet edhe për kompensimin e tjerave, ato megjithatë janë llogari që duhet të jenë edhe konkrete. Ose, a duhet në këtë fazë ne të lejojmë edhe projekte aq ambicioze siç janë Shtëpia e Bardhë, Qendra Protokollare, me do shifra të rrumbullakuara me miliona e tjera, kur ne po shihemi që ballafaqohemi edhe me sfida që janë elementare? Dhe, vargut të dilemave të tilla mund t'u shtohen edhe shumë çështje tjera. Për mua, megjithatë, është shumë e rëndësishme që në prioritetet e buxhet bërjes ka zënë vend edhe ajo që është quajtur stabiliteti social, sundimi i ligjit, demokratizimi i shoqërisë. E konsideroj të nevojshme, madje të domosdoshme, që kjo pa hapësirë të zgjerohet dhe të mbushet edhe me mbështetjen e nevojshme. Dhe, duke rrezikuar që të jem edhe ekskluziv, megjithatë mendoj që duhet investuar më shumë edhe në ligjvënien, sepse shumë ligje që nuk na janë sjellë, janë prioritet dhe ne po vazhdojmë pastaj të kemi pasoja edhe funksionale për shkak të kësaj.

Këtu dua të shtroj veçanërisht edhe nevojën e korrigjimit të padrejtësive të së kaluarës, si nevojë e domosdoshme e transformimeve shoqërore, pa e vënë pikën mbi këtë çështje të vështirë nëse mund të ecim përpara dhe besoj e keni të qartë se ku dua të dal, pa mohuar kategoritë e tjera. Mendoj që është koha që të shtrohet dhe të zgjidhet siç duhet edhe

çështja e të drejtave të burgosurve politikë, për të cilën ky Kuvend ka bërë një ligj, e ka proceduar, e ka futur në kalendarin ligjvënës dhe mbetet vetëm një mbështetje nga Qeveria që ai të kalojë dhe kjo kategori të gjejë, së paku, satisfaksionin moral. Janë disa çështje në të cilat nuk do të ishte mirë të qeshet as buzëqeshet, sepse janë të dhembshme. Dhe, mendoj që duhet të kihet parasysh fakti se është një padrejtësi, madje edhe midis kategorive të cilave u bëhen padrejtësi. Nëse dikush ka humbur një sy në luftë, ai konsiderohet invalid i luftës dhe duhet edhe më shumë, por nëse dikush i ka humbur të dy sytë nga terri i burgjeve, kazamateve serbe, ai konsiderohet sikur nuk i ka kush borxh. Nëse dikush ka humbur prindin ose anëtarin e familjes prej 99-ës e këndeje, konsiderohet familje e dëshmorëve, por nëse ka ndodhur një vit më parë- në burgje e tortura e tjera, ai konsiderohet ndryshe. S'mund të justifikohet, zonja e zotërinj, kjo.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet Lutfi Haziri.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve,

Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Kur është puna për ... para, gjithmonë ka telashe, sidomos atje ku mbretëron varfëria e ne në Kosovë jemi në këtë stadium. Kosova është shumë e varfër. Buxheti i sivjetmë është rritur diçka, jo i sivjetmë, por i vitit të ardhshëm, por edhe nevojat janë rritur dhe apetitet, sigurisht, bashkë me nevojat janë rritur të gjitha. Unë nuk do të kthehem t'i përsëris kolegët që disa segmente i elaboruan, por do të ndalem vetëm në një pikë, në ndërtimin e autostradës Durrës, tash s'po themi Durrës, por Vërmicë, më duket dhe Prishtinë, po ndalemi në Prishtinë si tha Hydajeti, të mos shkojmë deri në Merdar se s'kemi të holla deri atje. Por, kemi të holla, bile deri në Zhur, kemi. Njëherë, zoti ministër tha këtu, ne s'kemi para për ta ndërtuar këtë rrugë. Ndërkohë, ka ndryshuar situata, ne jemi tash anëtarë të Bankës Botërore edhe të Fondit Ndërkombëtar, atje mund të nxirren parat, sigurisht, sidomos për një objekt të tillë, i cili nuk është vetëm me rëndësi kosovare, si të themi, po edhe rajonale, ndoshta edhe evropiane. Por, duhet të kemi vullnet edhe Qeveria duhet të deklarohet një herë haptas në Kuvend se a ka vullnet dhe a do ta ndërtojë këtë rrugë apo po na ngreh sot për nesër, e deri kur deri në fund? Këtu është thënë një herë, Qeveria ka premtuar se deri më 1 nëntor buldozerët do të jenë në rrugë, duke e hapur rrugën. Kaloi nëntori dhe, me sa jemi sot, me 24 a sa, 23? Herën tjetër do të na thonë- jo sot, por unë po propozoj që herën tjetër na premtoni 1 prillin, dimë atëherë çka është bile, po. Ju lutem këtë ta merrni me shumë seriozitet, sepse këtu u tha, u theksua para drekte se faktori, investimet në Kosovë nuk mund të vijnë nëpër rrugica. Duan autostradën, duhet parë një përparim evropian këtu, çdo mëhallë ose çdo qytet gëzohet kur e ka një rrugë të re në veti. Pra, gëzohet krejt Kosova në qoftë se do ta kemi na autostradën qysh duhet ta kemi. Një herë, vjet, kanë qenë 50 milionë për këtë rrugë, mandej i ra ndërmend Qeverisë që t'i marrin këta 50 milionë, të ndërtojmë rrugë e rrugica dhe qorrsokakë se fitojmë atje ndonjë votë më tepër dhe i hoqën 50 milionë dhe mbet zero. Tash i keni caktuar 20 milionë, kurse për rrugët e tjera të Kosovës, domethënë, regjionale komunale i keni caktuar 112 milionë. Unë propozoj, se këta 112 milionë të kalohen në ndërtimin e autostradës Vërmicë- Prizren, themi në Prizren, deri në Prizren, të niset rruga dhe këta 20 milionë le të jenë për rrugët tona për qorrsokakë, për

katunde, për nevoja tjera që i kemi. Ne do t'i gëzohemi sigurisht ndërtimit të çdo gjëje kudo që të jetë. Kosova është e vogël dhe të gjitha rrugët neve na interesojnë kudo që të ndërtohen, por prioriteti është këtu, duhet të jetë të paktën, duhet të jetë, se në Shqipëri nuk ka qenë, opozita është kundër asaj rruge, por është punë e tyre, por vetëm ne duhet të marrim leksione se çka duhet të bëjmë ne në Kosovë. Duhet t'i këqyrim nevojat tona dhe interesin tonë. Unë këtë e propozoj 112 milionë të shkojnë në autostradë, 20 milionë të shkojnë në rrugë të Kosovës të dorës së parë, të dytë, që doni për t' i rregulluar. Ju faleminderit për dëgjim!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Krasniqi!

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri, le të përgatitet deputetja Sala Berisha-Shala.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Unë po e përsëris prapë problemin e vitit të kaluar që kam thënë dhe Kosova përballët prapë me mundësinë apo pamundësinë që të shfrytëzojë buxhetin e planifikuar për shkak të kapaciteteve buxhetore, nuk është në fajin e resorëve apo të portfelit ministror as të Kabinetit qeveritar, është faji në planifikim dhe ndërtim të kapaciteteve njerëzore që ta ndihmojnë Qeverinë, ta ndihmojnë Kabinetin në menaxhim dhe planifikim, në mënyrë që të mos përballemi çdo vjet me problemin e njëjtë, sepse projektet në Kosovë janë afatgjatë. Pra, nuk janë vetëm brenda një viti buxhetor, janë dy-tri vjet, janë pesë vjet, janë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe kështu çdo vjet po ngulfatet në kuptimin e realizimit të planifikimit buxhetor. Do të doja realisht viti i ardhshëm buxhetor të jetë më i përthekuar në kuptimin e menaxhimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, në mënyrë që vërtet paraqet e planifikuar në buxhet të dalë në treg edhe në kuptimin e përfitimeve për investimeve, edhe në kuptimin e shfrytëzimit si mjete që janë të domosdoshme. Çështja e dytë që unë e vërej si problem ka të bëjë me projektet që hyjnë në vijën buxhetore të bashkëfinancimit. Ekzistojnë kritere për mënyrën e bashkë financimit. Edhe në vitin e dytë po më duket që është lënë në vullnetin e mirë të ministrave të vendosin për projektet e bashkëfinancimit, për bashkëfinancimin e projekteve. Nuk e kam fjalën vetëm për ministri, por janë 3-4 ministri që përfitojnë në bashkëfinancim dhe elimini i kritereve që janë të domosdoshme në shtrirjen e investimeve në projektet e përbashkëta me komuna e lëndon seriozisht shtrirjen e drejtë të investimeve në të gjitha komunat. Për të bashkë financiar në radhë të parë komuna duhet ta ketë projektin në agjendën komunale- zhvillimore që duhet respektuar, projektin detaj të paraqitur para Qeverisë, e cili kalon nëpër komision të grandëve dhe i rekomandohet ministrit apo Ministrisë së caktuar. Unë nuk e kam vërejtur në disa raste që kemi të bëjmë me respektim të agjendave komunale, në radhë të parë ose eventualisht ka ndodhur ndryshimi i agjendave komunale që s'kam mund ta shoh drejtpërdrejt. Do të doja që Komisioni i grandëve të jetë funksional, sepse po më duket mosfunksionimi i këtij komisioni si organ ligjor brenda institucioneve tona, i cili merret me grandin komunal, shkakton defekte edhe në projekte tjera. Do të doja ta shoh, e di që Kryeministri e udhëheq Komisionin e grandëve, në mungesë Kryeministrit, ministri i Financave, ku kryetarët e komunave e kanë zërin kritik, e kanë rolin e vet kritik në realizimin e kësaj të drejte. Si pasojë e mosfunksionimit ashtu siç do të duhej të jetë, unë mendoj që mandej lëndohen agjendat, lëndohen projektet dhe këtu deputetët flasin mandej për projekte regjionale, për projekte komunale, për mosrespektim të shtrirjes të

drejtë të investimeve dhe shumë problemet tjera që mund të vijnë si pasojë e mos funksionalitetit të Komisionit për grande. Unë e di se edhe më herët funksionimi i këtij komisioni ka qenë problem. Kur vjen ministri, mungon kryetari i komunës, kur vjen kryetari i komunës, mungon Kryeministri, shpeshherë agjendat nuk mund të rendohen qysh duhet, por jemi në një kohë kur realisht duhet t'i respektojmë organet ligjore, institucionet që janë të domosdoshme të merren me këtë pjesë të planifikimit buxhetor, në mënyrë që mos të kalojnë në atë që themi përgatitja e mirë teknike e buxhetit, vetëm.

Më lejoni që pjesën e fundit të fjalës time ta adresoj në nevojën e domosdoshme që Qeveria, sipas programit qeveritar, unë e di që është në program qeveritar, ta financojë, jo vetëm si premtim që ministri Shala e ka dhënë në rishikim buxhetor. Mbështetja e projektit ideor për ndërtimin e rrugës regjionale Prishtinë-Gjilan-Bujanoc dhe Ferizaj-Gjilan, që përfshin edhe hekurudhën është pjesë e programit qeveritar apo premtim iniciues që është dhënë në zgjedhjet e kaluara, do të duhej me qenë pjesë e së paku planifikimit ideor për vitin e ardhshëm, sepse do të marrë kohë. Ne e dimë që prioritet është ndërtimi i autostradës dhe i rrugëve regjionale Shkup-Prishtinë dhe Prishtinë-Podgoricë, por rëndësia në këtë rrugë do të duhej të vijë përmes fillimit të ndërtimit të projektit. Dhe, sa i përket ligjit të Prishtinës unë po dëshiroj të konfirmoj, nuk është kusht, por është premtim që është dhënë në këtë Kabinet. Në vitin e kaluar e kemi miratuar buxhetin me premtim që ka për t' u realizuar, ka për t' u votuar, ka për të ardhur në procedurë ky ligj. Ky është premtim që duhet mbajtur, është premtim se mund të hyjë në vitin e tretë buxhetor nëse nuk e realizojmë një të drejtë elementare që ka të bëjë me legjislacion, jo me kërkesë buxhetore ekskluzive, por me plotësimin e ligjit që është e domosdoshme.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala, le të përgatitet Adem Salihaj.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër, Kabinet qeverisës,

Të nderuar deputetë,

Është bukur problem të orientosh diskutimin në këtë frymë shumë shqetësuese lokaliste, siç po instalohet këtu në Kuvend. Unë do të bëj përpjekje të dal nga kjo e keqe.

Të nderuar deputetë,

Gjithkund në botën e civilizuar miratimi i Projektbuxhetit përcillet me festë, prandaj uroj që edhe tek ne të ndodhë një vetëdijesim i tillë. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm për proceset, obligim i yni si deputetë, por edhe për proceset që po kalon Kosova. Me këtë projektbuxhet Qeveria ka marrë përgjegjësinë e rritjes ekonomike të Kosovës, mbrojtjen dhe kultivimin e jetesës të gjithë qytetarëve të saj.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ua përkujtoj, ta kemi parasysh që është vetëm viti i dytë që Kosova po e diskuton buxhetin e saj si shtet i lirë demokratik, i pavarur dhe sovran, ndërsa ende nuk

është mbushur një vit nga anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Fondin Ndërkombëtar Monetar dhe Bankën Botërore. Në këtë drejtim ju ftoj për një qasje sa më pozitive, jo mohuese, karshi këtij projektbuxheti që po e diskutojmë, kështu që kemi nevojë të tregohemi të vendosur, të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm në çdo sferë, si atë ekonomike, politike e tjera. Shihet se buxheti ka rritje krahasuar me vitin e kaluar dhe kjo rritje është si rezultat i mirëfunksionimit të qeverisjes transparente dhe sundimit të ligjit. Me këtë projektbuxhet qytetarët e Kosovës do të përfitojnë prej shkollave të reja, ngritjes së cilësisë në arsim. Qeveria ka treguar se është në vazhden e përkushtimit të saj në përmirësimin e sistemit arsimor si një nga prioritetet e saj si garanci për armatën e të rinjve tanë për t'u krijuar kushte për të konkurruar në ekonominë globale, e cila ekonomi çmon më shumë se gjithçka dijen. Kështu viti 2010, nga Qeveria është përcaktuar si vit i arsimit gjithëpërfshirës, nga niveli parashkollor deri te ai më i lartë. Duke çmuar këtë sektor si burim të rëndësishëm i zhvillimit ekonomik që ofron prosperitet për gjeneratat e ardhshme, ky projektbuxhet, në mes tjerash, do të financojë themelimin e Universitetit të Prizrenit, do të zgjerojë kapacitetet e Universitetit të Prishtinës edhe për 4.000 studentë të rinj. Qeveria mbetet e përkushtuar të financojë tërheqjen e profesorëve me kualifikime më të larta duke u ofruar atyre paga më të larta. Projektbuxheti i vitit 2010 vjen si rezultat i përmbylljes së një procesi të rëndësishëm planifikues. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje të plotë me prioritetet e përcaktuara nga Qeveria që për synim kanë mbështetjen e politikave zhvillimore që adresojnë nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më saktësisht struktura e buxhetit respekton prioritetet kyçe të kësaj qeverie, që janë: rritja ekonomike, zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, qeverisja e mirë dhe stabiliteti social. Andaj, miratimin e këtij buxheti duhet kuptuar si votë për nxitje të zhvillimit ekonomik, si votë për stabilitet më të madh social, si votë për fuqizim të qeverisjes së mirë, si votë për promovim të zhvillimit të mëtejshëm dhe konsolidim të institucioneve. Duhet theksuar se Qeveria është këshilluar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me ç'rast në bashkëpunim me këtë, ky është pajtuar me strukturën e këtij buxheti dhe ne kemi shumë arsye të shpresojmë që në të ardhmen e afërt Kosova do të ketë qasje në programet e këtij fondi. Është theksuar edhe më parë se ne duhet të kërkojmë edhe burime alternative të financimit dhe hyrja në këtë fond në të ardhmen do të na mundësojë që ne të kontribuojmë në zhvillimin e vendit duke tejkaluar kufizimet që vijnë nga të hyrat buxhetore. Qeveria, përveç arsimit është e përkushtuar edhe për energjinë. Investimet e deritashme në sektorin e energjisë kanë siguruar që përkundër sistemit të vjetruar të ofrohet një nivel optimal i furnizimit me energji elektrike.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës e ka hartuar këtë projektbuxhet në harmoni edhe me projektligjet që janë në procedim. Kjo është vërejtur gjatë analizimit të këtij drafti. Kur e them këtë kam parasysh që në disa njësi buxhetore siç janë agjencitë e pavarura që dikush nga deputetët tha se i është cunuar buxheti, në harmoni po them prapë me projektligjet që janë në draftim është bërë transferi i disa projekteve në vazhdim. Për shembull, te agjencia – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, tani pas ristrukturimit këto projekte do të kalojnë si kompetencë e Ministrisë së Energjisë, po e përmend sa për ilustrim vetëm një projekt, i cili është sobver për leximin e të dhënave gjeologjike. Ndoshta te kjo linjë buxhetore duhet shqyrtuar edhe numrin e stafit gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Krejt në fund, ju ftoj që ta miratoni këtë projektbuxhet duke votuar kështu pra, për arsim

gjithëpërfshirës, që nga niveli parashkollor deri te niveli më i lartë arsimor, të votoi për infrastrukturë, bujqësi të avancuar, mirëqenie sociale e status respektues të kategorive më të merituar të shoqërisë tonë ,siç janë veteranët e luftës, invalidët, familjet.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, le të përgatitet Adem Grabovci.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Sigurisht jemi kah fundi dhe jemi mjaft të lodhur, kështu që unë do të flas mjaft shkurt, do t'i kap disa segmente të buxhetit të Kosovës që parashihet për vitin 2010.

Së pari u përmend shumë herë, por nuk mund të mos e përmendim sërish çështjen e autostradës. Sërish janë paraparë 20 milionë e gjysmë euro për autostradën, dihet që s'do të bëhet asgjë as me këto para dhe dihet që autostrada nuk do të ndërtohet. Në vitin 2011, 2012 nuk është paraparë asnjë metelik për çështjen e autostradës dhe është një lojë që bëhet për çdo vit, thjesht për ta mashtruar opinionin dhe qytetarët e Kosovës, mendoj që as neve si Kuvend i Kosovës as Qeverisë nuk do t'i bëjë nder kjo lojë. Thjesht në fund, do të jetë një, të themi një debakël moral i të gjithë ne lidhur me çështjen e autostradës. Autostrada është interes i madh nacional dhe nuk ia vlen të bëjmë këso lojërash, ne mund të bëjmë lojëra me disa projekte të vogla, por jo edhe me këtë.

Dëshiroj të jepen, ndoshta edhe disa sqarime shtesë po e zëmë te Ministria e Punëve të Jashtme. Qytetarët e Kosovës, veçanërisht ata që janë jashtë kanë pritur dhe presin me vite e vite funksionalizimin e ambasadave dhe të konsullatave që të mund t'i kryejnë disa shërbime të dokumenteve personale, siç duket ata do të presin edhe një kohë tepër të gjatë, do të maltretohen, do të vijnë në Kosovë, nuk do të mund të kryejnë punë, sepse nuk është afër funksionalizimi i këtyre institucioneve të Kosovës.

Dëshiroj t'i cek disa aspekte të diskutimeve të ndryshme që ishin këtu. Dëshiroj ta cek faktin se një pjesë e madhe e investimeve, veçanërisht te Ministria e Transportit, shkojnë në drejtimin Prishtinë-Komoran-Skenderaj-Pejë-Malishevë-Klinë e tjera, e tjera, që tregon një orientim në bazë të njerëzve që bartin funksionet kryesore në Qeveri dhe ndoshta dhe në Parlament. Të mos keqkuptohemi, unë kam dëgjuar me kujdes diskutimin e Kryetarit të Kuvendit. Dëshiroj të them që në periudhën e pas vitit 99 nuk është lënë pas dore Drenica, zoti Kryetar, është lënë më herët para 99-ës, por jo pas 99-ës dhe të gjitha qeveritë që kanë qenë pas kësaj periudhe i kanë kushtuar kujdes edhe kur ka qenë ministër Zef Morina edhe kur ka qenë Qemajl Ahmeti edhe më vonë dhe tash kur është Fatmir Limaj, Drenica ka pasur trajtimin e duhur dhe s'është lënë pas dore aspak në aspektin e ndërtimit të rrugëve. Dhe, nuk është e drejtë tash një masë aq e madhe, enorme të mjeteve të buxhetit të shkojnë në ato drejtime dhe të lihen mbrapa ose të lihen plotësisht pas dore pjesët tjera të Kosovës dhe të mos harrojmë që po e përmend serish

rrugën Prishtinë-Shkup, është rrugë e interesit të madh nacional dhe është lënë pothuaj se plotësisht pas dore.

Dëshiroj të them që te çështja e Ministrisë së Arsimit, po e zëmë për Ferizaj janë paraparë 3 investime, një i ka 50 mijë euro, një tjetër 70 mijë dhe një 30 mijë, gjithsej janë 150 mijë euro në këtë projektbuxhet për vitin 2010. Unë dëshiroj të mos jetë kështu, por për fat të keq kështu është.

Dëshiroj po ashtu edhe një sqarim të Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit, janë paraparë për tri vjet nga 200 mijë euro për pastrimin e lumit Lepenc nga ndotja me azbest, beton nga fabrika që është aty afër. Është e palogjikshme për çdo vit të jepen nga 200 mijë euro e të mos ndalet ndotja e lumit Lepenc që është sigurisht tepër e rëndë dhe duhet të ndërmerret diçka në këtë drejtim.

Dëshiroj një sqarim, të Forca e Sigurisë janë paraparë 4 milionë e 200 mijë euro për kompjuterë, PS dhe për internet. Unë thjesht nuk e kuptoj këtë si është e mundur kjo? Nëse e bëjmë një llogaritje të thjeshtë, për çdo pjesëtar të Forcës së Sigurisë shkojnë nga 3-4 kompjuterë. Unë dëshiroj një sqarim se s'më duket e logjikshme, nuk di a do të përgatiten ata për luftë, për, nuk e di për çka apo që të rrinë tërë ditën në disa kompjuterë. Po ashtu e tha edhe kolegu ynë, nuk ka asgjë në këtë projektbuxhet për çështjen e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, nuk ka asgjë për çështjen e ish- të burgosurve politikë. Pra, në këtë projektbuxhet nuk parashihet dhe sigurisht

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë mund të them që nga 35 vjet s'kam menduar as lokalisht as provincialisht. Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci, le të përgatitet Nurishahe Hulaj.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeverisës,

Kolegë të nderuar,

Më lejoni që fillimisht dua të përshëndes ministrin dhe Ministrinë e Financave për punën e mrekullueshme që e ka bërë. Na ka ofruar një dokument jashtëzakonisht të mirë, jo vetëm në aspektin teknik që nuk i kushtoi shumë rëndësi, por e vlerësoi shumë anën e tyre profesionale, të cilët kanë dëshmuar se dinë të punojnë dhe janë të përcaktuar shumë drejt dhe qartë të ndërtojnë një shtet të vërtetë demokratik dhe të mirëfilltë.

Shpërndarja e financave, ndihem tepër mirë që edhe me këtë buxhet, parashihet sikurse edhe në vitet e kaluara, është gjithëpërfshirës dhe them me përgjegjësi të plotë dhe mund ta argumentoj dhe në resorin aty ku jam se është një buxhet gjithëpërfshirës, i cili ka një shtrirje në të gjitha komunat e vendit tonë. Pa marrë parasysh edhe në ndonjë komunë aty ku vërtet është tentuar që të na pamundësohet të bëhen investimet e dëshirueshme, vullnetmira, megjithatë edhe aty ka investime dhe unë jam i gatshëm që ato t'i them dhe t'i potencoj me emër.

Ne, është e vërtetë se rrugët regjionale dhe rrugët nacionale janë në përgjithësi të drejtpërdrejtë të Qeverisë së vendit, ku janë shtruar me qindra kilometra rrugë, nuk janë pak brenda një mandati prej dy vjetësh, jo më shumë, as dy vjet të plotë, është arritur të shtrohen jo më pak se 1000 kilometra rrugë të reja, duke përfshirë ato lokale, regjionale dhe gjithsesi ato me interes nacional.

Sa i përket rrugëve nacionale, është e vërtetë sa ato po lëshojnë shtat dhe është fatkeqësi shumë e madhe për ata njerëz, individë, të cilët nuk kanë sy që t'i shohin dhe çdo ditë kalojnë nëpër to. Po ashtu, rrugët regjionale që e kanë ndryshuar pamjen dhe jetën e çdo qytetari të vendit, kanë krijuar kushte dhe një bazament shumë të fuqishëm për një zhvillim të hovshëm ekonomik. Nuk mund të bëhet për mendimin tim që është edhe profesionalisht është shumë e qartë, nuk mund të bëhet fjalë për zhvillim të mirëfilltë ekonomik pa një infrastrukturë të nevojshme, më moderne çfarë është, ka ndodhur aktualisht në Kosovë.

Nuk jam i prirë të flas në baza regjionale se për mua është diçka e tejkaluar, po flas për tërësinë. Jam i detyruar për shkak të disa potencimeve që u bënë jo të drejta, në komunën e Gjakovës nuk është e vërtetë që janë të ndara vetëm 500 mijë euro, por janë 2 projekte të cilat janë, njëri ka filluar tash në vlerë prej 1 milion e 500 mijë euro dhe tjetri që është në rrugë për mua dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës është e shenjtë, që ka mbetur në mëshirën e fatit me vite të tëra, rruga e Koshares, ku prehen djemtë më meritore të cilët na kanë prurë dhe na kanë mundësuar neve që të jemi sot këtu, edhe aty është një pjesë e buxhetit për vitin 2010, që do të vazhdojë të investohet dhe kap në total shifrën rreth 2 milion e gjysmë euro. Prandaj, e vërteta është kjo që mund të thuhet. Ndërsa, në komunën e Deçanit është e paqëndrueshme se kemi një buxhet zero, vetëm nga Ministria e Transportit kemi tri projekte të cilat janë në zbatim aktualisht, është rruga e Carrabregut, është rruga e Vokshit, është rruga në Strelcë, të cilët kapin një shifër rreth 1 milion euro dhe ky investim do të vazhdojë në vitin e ardhshëm.

Një, mund të them me përgjegjësi të plotë se atë që e ka bërë Qeveria aktuale, po e rritet me gjithë tendencat për të penguar depërtimin e investimeve, për ta ndier dorën e kësaj qeverie ne kemi arritur që të investojmë për këtë periudhë kohore, le t'i grumbullojnë tetë e kaluara, nëse arrijnë të dëshmojnë se kanë investuar 50 përqindëshin e kësaj qeverie, atëherë unë personalisht jam i gatshëm të jap llogari, jo para EULEX-it, por para çdokujt. Unë jam shumë i sigurt dhe dëshiroj që EULEX-i do të merret, por EULEX-i do të merret edhe me shumë e shumë probleme të tjera, të cilat janë shumë më të rënda dhe duhet vërtet të dëshmojnë dhe del e vërteta në shesh.

Sa i përket autostradës që u potencua, unë vlerësoj se autostrada veç ka filluar

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit shumë!

Të nderuar deputetë, ju duhet ta dini se EULEX-i në Kosovë është si këshillëdhënës dhe detyra për të është e gjyqësisë së Kosovës, prandaj ju kisha lutur që mos i ngarkoni tjerët me detyrat që s'i kanë. Fehmi Mujota e ka fjalën, replikë me Adem Salihajn.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt dua ta sqaroj zotin Salihaj, meqë unë para vetes kam të gjitha projektet për Forcën e Sigurisë dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk nënkupton sistemi i komunikimit- kompjuterët, atëherë po jap një sqarim se sistemi dhe pajisja e komunikimeve nënkupton standardizimin e komunikimit me NATO-n dhe natyrisht me rajonin dhe pjesët e komunikimit që tani kemi hyrë në vlerën e tyre, kanë filluar dhe janë në realizim e sipër. Pra, bëhet fjalë për lidhje taktike dhe sistemin tjetër të komunikimit dhe nuk bëhet fjalë për kompjuterët që i keni lexuar ju. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Një minutë, Adem Salihaj e keni fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam lexuar mirë, këtu shkruan kompjuterët dhe rrjeti, thjesht kompjuterët dhe rrjeti janë 4 milionë e 200 mijë , zoti ministër, di të lexoj edhe unë, prandaj mos t'i pësjtjellim gjërat. Nëse këtu shkruan kompjuterë, do të thotë, duhet të blihen kompjuterë, jo radio-lidhje. Nuk ka lidhje me ato. Faleminderit!

KRYETARI: Fehmi, urdhëro, një minutë!

FEHMI MUJOTA: Unë kam besuar se të gjithë njerëzit në Parlamentin e Kosovës dinë çka do të thotë ruajtja e një konfidencialiteti të Forcës së Sigurisë dhe mbi të gjitha dua të them që plani jonë i blerjes është pikërisht i pesë vjetëve . Në vitin 2010 kemi 2 milionë e 150 mijë, në vitin 2011 janë 1 milion 550 mijë dhe në vitin 2012, 700 mijë , që bëjnë shumën prej 4 milionë e 400 mijë euro deri në vitin 2012. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nejse, deputetët nganjëherë i ngatërrojnë çështjet. Deputetja Nurishahe Hulaj e ka fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit! I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Fjalimin tim e kam përqendruar në prioritetet e sistemit shëndetësor në Republikën e Kosovës, në mbrojtjen e mjedisit dhe në sektorin e rinisë. Nga Projektbuxheti 2010 ndarja e mjeteve buxhetore prej 71 milionë e 862 mijë e 277 euro për Ministrinë e Shëndetësisë nuk adreson mjaftueshëm për realizimin e misionit të sistemit shëndetësor dhe objektivave strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë në Republikën e Kosovës. Misioni i projektuar i Ministrisë së Shëndetësisë është zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm shëndetësor, i cili do të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës me synimin e arritjes së standardeve bashkëkohore. Do t'i cek edhe pesë objektivat kryesore prioritare:

1. Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës së përgjithshme dhe specifike, është e ndërlidhur kjo edhe me objektivat e Mileniumit;

2. Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
3. Funkcionalizimi, riorganizimi dhe plotësimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit shëndetësor në përputhje me standardet evropiane;
4. Implementimi dhe zhvillimi i sistemit informativ shëndetësor;
5. Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të financimit për sektorin e shëndetësisë përmjet të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Konsideroj se nëse Qeveria e ka në prioritet shëndetësinë, e cila është cekur në kuadër të prioriteteve qeveritare, atëherë patjetër ka qenë e domosdoshme që të përkrahet kërkesa prej 21 milionë e 800 mijë euro ose 25% shtesë, pra për t' u krijuar shuma totale 92 milionë euro për periudhën afatmesme 2010-2012. Arsytet e kërkesave për shërbime të reja:

1. Instituti Onkologjik. Arsyeja është se trendi i sëmundjeve malinje është në rritje;
2. Kardiokirurgjia, sëmundjet kronike masovike kardiovaskulare janë në rritje;
3. Mjekimi intensiv qendror;
4. Mjekimi intensiv në Neurokirurgji, si dhe planifikimi për këto shërbime, gjithashtu me personel për 104 mjekë dhe 261 infermierë.

Tutje, 44 euro ose 30%shi i deklaruar nga ana e Qeverisë nuk është projektuar në projektbuxhet 2010, nëse e zbërthejmë për 12 muaj 2010 për 7 mijë e 393 punëtorë të nivelit sekondar dhe terciar, për t' i paguar 44 euro nevojiten 4 milionë, të cilat nuk janë paraqitur në tabelën buxhetore.

Tjetër, pagesa e aborteve funksionale dhe këshillave profesionale në Ministrinë e Shëndetësisë nuk është e realizuar dhe projektuar.

Investim për spital regional në Prishtinë rreth 3 milionë euro gjer në 2012 dhe në disa qendra tjera sipas planit gjithëpërfshirës të Ahtisarit.

Programi farmaceutik nuk është rritur për 4 milionë , por për 3 milionë, do të thotë prej 16 milionëve në 19 milionë, vetëm në këtë sektor nuk mund të lavdërohem i se shëndetësia është prioritet për vitin 2010. Janë cekur në pjesën hyrëse të Projektbuxhetit 2010 nga ana e ministrit të Financave se 1.5 milionë janë ndarë për kompensimin e punës jashtë orarit si dhe shtesat tjera, por kjo nuk figuron në tabelën e buxhetit 2010 apo nuk është ratifikuar qartë.

Do të kaloj pak në mbrojtjen e mjedisit, në një segment shumë të rëndësishëm për shëndetin e qytetarëve. Mjetet kapitale 1 milion e 300 mijë euro të ndara për burimet ujore, nuk mjafton, sepse kemi të dhëna se 82% të ujit të puseve lokale nëpër fshatra të Kosovës janë të kontaminuar me baktere të cilin ujë e pinë qytetarët tanë e mos të flasim për ujërat e zeza. Ndërsa, 55% e rasteve të sëmundjeve ngjitëse paraqiten si pasojë e

kontaminimit të ujit dhe ushqimit, prandaj mbrojtja e mjedisit duhet të përkrahet ashtu si arsimi dhe telekomunikacioni. Një segment tjetër është edhe rinia, mjetet e ndara nga niveli qendror, subvencione, transfere 535 mijë euro, që nuk mjafton për integrimin e rinisë dhe zhvillimin e aktiviteteve nga ana e tyre.

Dhe, në fund, kam 3 rekomandime. Për t'ia hequr pak buxhet kapital Telekomunikacionit, 2010-2012 dhe për t'ia dhënë shtesë 21 milionë euro Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën 2010-2012 për të zhvilluar misionin dhe objektivat e saj, sepse janë prioritet dhe rekomandimi i dytë – programi farmaceutik definitivisht të decentralizohet dhe nën tre - të hyrat vetjake të decentralizohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministrja Nekibe Kelmendi!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar Kryetar i Parlamentit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Unë pothuaj se u thirra nga deputeti Armend Zemaj që të jap disa sqarime lidhur me kërkesat që i kam parashtruar për përfshirjen në buxhetin për vitin 2010. Kam kërkuar vetëm për mjete shtesë dhe staf vetëm për funksionalizimin e Shërbimit Korrektues, përkatësisht Burgut të Smerkovnicës, që ka kapacitet prej 300 të burgosurish për 233 pozita shtesë. Kam kërkuar gjithashtu 71 oficerë korrektues për funksionalizimin e burgut për dëshmitarët e mbrojtur e për të cilin Qeveria e Kosovës ka investuar afër 3 milionë euro dhe tani është duke u përfundua. Dhe, kam kërkuar mjete për implementimin e Ligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar dhe të sekuestruar, sipas të cilit ligj duhet të themelohet agjencia, e për këtë kam kërkuar 17 pozita dhe mjete financiare prej 557.471,91 euro. Në masë kam kërkuar gjithsej mjete buxhetore 2 milionë e 312 mijë e 989,40 euro. Buxheti total për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2010 është 21 milionë e 737 mijë e 399 euro. Në shifra kjo paraqet një rritje prej afër 2 milionësh, por kjo rritje ka të bëjë me disa projekte sipas programit të IFA-s, pra me bashkëfinancim dhe këto nuk mund të konsiderohen rritje. Shërbimi Korrektues i Kosovës për vitin 2010 është i shkurtuar me mjete financiare prej 162 mijë euro. U tha se ka rritje pagash prej afër 14 milionë euro në polici dhe drejtësi. Për drejtësi, pra për oficerë korrektues nuk ka fare rritje pagash, ani pse edhe këta janë persona të uniformuar, rritje pagash ka për polici dhe zjarrfikës. Oficerët korrektues marrin vetëm një kompensim për rrezikshmëri, asgjë më tepër.

Është e vërtetë se në këtë vit, me rishikimin e buxhetit, pra në vitin 2009 ka pasur shtesë për Ministrinë e Drejtësisë, sepse kërkesat e saj kanë qenë të bazuara, kjo shtesë ka qenë diku rreth 2 milionë euro. Ju rikujtoj se Ministria e Drejtësisë ka katër shtëpi private me qira për të cilat paguan rreth 400 mijë euro në vit, madje ka edhe institucione shumë të rëndësishme siç janë Prokuroria e Kosovës dhe Prokuroria Komunale. Kjo ishte një pasqyrë e kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë. U mbetet komisioneve parlamentare dhe deputetëve që t'i përfshijnë kërkesat e Ministrisë së Drejtësisë, me rastin e amendamentimit të këtij buxheti, meqë të gjithë ne e kemi top-prioritet sundimin e ligjit e sundimi i ligjit, më besoni se sigurisht se do të joshë edhe investitorë të huaj në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi edhe dy deputetë për diskutim. Kisha kërkuar që t' i bini si shkurt. Deputeti Hajdin Abazi dhe le të përgatitet deputetja Drita Kadriu.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi!

I nderuar zoti Kryeministër Thaçi,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Së pari shfrytëzoj rastin që ta falënderoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave që vërtet kësaj radhe na e ka përgatitur raportin, përkatësisht Projektligjin e buxhetit ashtu që secili mundemi ta shikojmë dhe ta vlerësojmë drejt, gjë që paraqet ngritje kualitative dhe në këtë aspekt pa folur pastaj edhe për aspektin përmbajtjesor. Pjesa dërmuese e ministrive, në fakt kanë punuar në mënyrë që çdo qytetar gëzohet, duke u nisur prej Ministrisë së Arsimit, reformat në Ministrinë e Administratës, Ministrinë e Sigurisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme e shumë të tjera. Mirëpo, më lejoni mua që meqenëse këtu debate u fokusua, një pjesë e debatit u fokusua kryesisht rreth çështjes së Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, t' i ritheksoj edhe disa gjëra që konsideroj se janë të rëndësishme.

Projektligji, të cilin sot po e shqyrtojmë ofron mbështetje buxhetore për zhvillimin e infrastrukturës në përgjithësi e posaçërisht asaj rrugore si pjesë e sistemit të integruar multimodal të transportit. Mbështetja e investimeve që i është dhënë këtij sektori shumë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik si prioritet më i rëndësishëm i Qeverisë, do të mundësojë integrimin e infrastrukturës transportuese të Kosovës në rrjetin kryesor regional, zhvillimin e bizneseve, përmirësimin e sigurisë në komunikacion, shkurtimin e kohës së udhëtimit, kursimin e karburanteve, zvogëlimin e migrimit fshat-qytet e të tjera.

Pjesa më e madhe e këtij buxheti në shumë prej 112,5 milionë euro është planifikuar në ndarjen për investime kapitale ose thënë në përqindje 89.3% nga buxheti i përgjithshëm i kësaj ministrie, do të thotë, Ministrisë për Transport dhe Telekomunikacion.

Ky buxhet do të mbështesë projekte shumëvjeçare të infrastrukturës rrugore si dhe projekte të reja të shpërndara si vijon:

- 58.9 milionë janë të destinuara për rehabilitimin e rrugëve që siguron, do të thotë, për mirëmbajtjen e tyre;
- 1.8 milionë euro për sinjalizimin rrugor;
- 3.3 milionë euro për ndërtimin e urave;
- 12.1 milionë euro për projekte për bashkëfinancim me kuvendet komunale;
- 15.5 milionë euro për ndërtimin e rrugëve të reja;
- 20.5 milionë euro për fillimin e ndërtimit të autostradës Morinë-Merdar që lidh Kosovën me Shqipërinë si projekt nacional;
- 6 milionë euro janë ndarë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në mbështetje të projektit Morinë-Merdar për shpronësimin e pronave private.

Ndërkaq, ndër projektet tjera madhore që duhen planifikuar në këtë buxhet janë edhe:

- 38.2 milionë euro janë ndarë për vazhdimin e projektit të rehabilitimit dhe zgjerimit të rrugës regjionale Prishtinë-Pejë;
- 15.2 milionë euro janë ndarë për vazhdimin e projektit të rehabilitimit dhe zgjerimit të rrugës regjionale Prishtinë-Mitrovicë.

Më lejoni të theksoj se Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme se projektet madhore nuk aftësi buxhetore vetë t'i mbulojë në tërësi, prandaj pas krijimit të legjislacionit të ri në fushën e koncesionit dhe partneritetit publiko-privat do t'i shikojë edhe mundësitë alternative të financimit duke përfshirë edhe sektorin privat dhe investimet e jashtme. Ky buxhet i projektuar për Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit nuk është i mjaftueshëm krahasuar me nevojat që ka vendi në infrastrukturën rrugore, prandaj një pjesë e projektit është planifikuar të financohet në vitet në vijim. Dhe, krejt ky angazhim do të thotë i jep mundësi perspektivës dhe zhvillimit në të ardhmen gjatë këtyre viteve në vazhdim të një zhvillimi dhe të një prosperiteti më të madh edhe për investime edhe për zhvillimin industrial. Prandaj, mendoj se duke i rikujtuar këto shifra është njëkohësisht edhe një rifreskim i kujtesës të gjithë atyre që thonë se nuk ka mundësi të realizohen këto, sepse shihet se planifikimi është bërë dhe këto do të realizohen dhe sikurse që është thënë se nuk do të realizohen autostrada këtu në Kosovë që u patën sjell fotografi dhe i patën thënë një herë Kryeministrit- fotografu me to dhe ne shohim se autostrada po bëhen në Kosovë. Zotërinj edhe autostrada e re që është planifikuar kjo do të bëhet dhe do të jetë realitet dhe të gjithë ata që e duan zhvillimin e Kosovës, që duan progresin dhe ecjen përpara do të duhej ta votonin këtë projektbuxhet të mundësive të reja dhe unë jam njëri nga ata që do ta votoj dhe ju ftoj të gjithëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, e fundit për diskutim deputetja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Unë do ta respektoj propozimin e Kryetarit dhe nga fjalimi të cilin e kam përgatitur do të nënvizoj vetëm tri çështje të cilat mendoj se nuk janë theksuar gjatë diskutimeve të kësaj seance dhe po e vlerësoj si të rëndësishme. Ato janë, fjalja rreth investimeve, një fjali ose periudhë rreth investimeve në Mitrovicë, si dhe çështjet e bashkëfinancimit të projekteve.

Nëse investimet i shohim nga kryeqyteti ose nga qyteti i betonit, siç e quajnë shumë njerëz, vërtet krijohet perceptimi se ato janë të parëndësishme. Mirëpo, nëse këto investime kthehemi dhe i vërejmë nga pozita e cilitdo qytetar në cilindo kënd të Kosovës, atëherë shohim se këto investime të infrastrukturës kanë rezultuar me qarkullimin e lehtë dhe të lirë si të mallrave, shërbimeve, ashtu edhe të njerëzve. Duke ditur se për këto 2-3 vjetët e fundit buxheti për Mitrovicën është rritur dhe bashkë me rritjen e buxhetit janë rritur edhe investimet deri në 4 herë më shumë, kjo rritje e buxhetit për Mitrovicën dhe mitrovicasit do të thotë kthim në pronat e tyre, do të thotë, meremetim i shtëpive të djegura, do të thotë, rrugë dhe investim në rrugët në fshatrat më veriore të Kosovës, do të thotë, mësim në dy ndërresa që e ngrit cilësinë, por edhe sigurisht shumë rezultate tjera.

Krejt kësaj kisha për t'i shtuar edhe gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të bashkë financuar shumë projekte si në Kosovë, me theks të veçantë në Mitrovicë, prandaj më lejoni që t'ju falënderoj si Kabinet qeveritar, posaçërisht Kryeministrin për krejt atë që ka bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, më në fund i erdhi fund diskutimeve për Projektbuxhetin e vitit 2010. Dhe, mendoj se tani është fjala për ministrin për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala që të përgjigjet në disa çështje që keni parashtruar ju, deputetët e nderuar.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Sinqerisht ju falënderoj për sugjerimet, shumica prej tyre të sinqerta për kontributin e dhënë në Projektbuxhetin e vitit 2010, i cili siç e patë edhe ju nuk ka qenë një punë e lehtë, megjithatë, falënderimet që i shkuan Ministrisë sime konsideroj se unë dua t'i përcjell te kolegët e mi ministra për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e sinqertë që kanë pasur për të ardhur deri te ky nivel dhe natyrisht stafin tim i cili sinqerisht ka punuar me shumë përkushtim, kështu që të gjitha komplimentet që ishin për mua besoj se iu shkojnë atyre së pari.

Sa i përket disa nga pyetjet nuk do të shkoj. Unë kam marrë shënim për secilin nga ju në mënyrë tepër të kujdesshme dhe besoj edhe stafi im atje mbrapa ka marrë të gjitha shënimet dhe ne do të përpiqemi që në projektimet tjera buxhetore të gjitha vërejtjet me vend do të përpiqem t'i reflektojmë edhe në përgatitjen teknike, por edhe në aspektet tjera përmbajtësore.

Gjithsesi në disa elemente të cilat ka nevojë për t'u përgjigjur, mbase për tu sqaruar në përgjithësi ishte siç u tha ndarja shabllon nëpër komuna apo ndarja paushall nëpër komuna, që në fakt është ose mungesë e njohurive për të njohur Ligjin për financimin e pushtetit lokal ose mbase një mungesë e informimit më detal të mënyrës se si shpërndahen mjetet nëpër komuna. Me theks të veçantë dua të theksoj para se të kalojë në formulat sidomos për komunën e Prishtinës mbetet që të jap disa sqarime.

Kam këtu para vetes, përveç ndarjeve të rregullta buxhetore të cilat shkojnë sipas Ligjit për financimin e pushtetit lokal, kam disa projekte të cilat do të doja t'i numëroja për hir të transparencës dhe të informimit të opinionit.

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për vitin 2010 ka paraparë investimin e ndërtimit të rrotullimit te Stacioni i Autobusëve prej 2 milionë e 179 mijë e 11 euro. Ministria e Shëndetësisë ka paraparë më vonë faktikisht një ndërtim të projektit për spital, por është në periudhën e vitit 2011. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më

lejoni t'i lexoj këto disa nga projektet të cilat kapin shumë në total prej 3 milionë e 700 mijë euro. Është ndërtimi i objektit të Shkollës fillore në lagjen Kalabria II në Prishtinë, ndërtimi i objektit të Shkollës së mesme të muzikës "Prenk Jakova" Prishtinë, ndërtimi i Shkollës së mesme në Prishtinë, ndërtimi i shkollës së mesme të re në Prishtinë, mund t'i them shifrat 400 mijë, 950 mijë, 750 mijë, ndërtimi i Shkollës fillore në Hajvali-Prishtinë 600 mijë, ndërtimi i Shkollës së mesme në Prishtinë, ndërtimi i Shkollës Speciale në Prishtinë, 1 milion dhe pjesa e dytë po ashtu 100 mijë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërtimi i kolektorit të rrugës B, lagja e Spitalit, bashkëfinancim, është 100 mijë euro.

Këto janë disa nga projekt financimet të cilat i bëjnë ministrinë e linjës në bashkëpunim me financimet komunale. Më lejoni të kaloj deri te mënyra e ndarjes nëpër komuna të buxhetit në përgjithësi dhe formulat të cilat sinjerisht kanë mbetur peng e regjistrimit të popullsisë dhe ai është një dhimbje të cilën dikush në fakt e gëzon, ndërsa tjetri e vuan. Në përgjithësi, grandet e përgjithshme ndahen prej 89% në bazë të numrit të popullsisë, ndërsa numri i popullsisë është bërë një listë e cila i është bashkëngjitur Ligjit për financimin e qeverisje lokale, ku 89% të ndarjeve merr pjesë formula e popullsisë, 6% është madhësia e komunës, 2% minoritetet në tërësi në Kosovë dhe 3% në komunat komunale. Kjo ka qenë një vërejtje edhe vitin e kaluar, nuk do të mund ta rregullojmë deri sa të bëhet regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 dhe nuk ka tjetër shkop magjik për ta rregulluar këtë, përveç të presim regjistrimin e popullsisë që në fakt disa komuna vërtet janë duke vuajtur, kështu që mund të them se vërejtjet do të duhej të kanalizoheshin në këtë drejtim e jo në drejtime të cilat u thanë më herët.

Një tjetër çështje me shumë pompozitet u tha këtu fare në fillim të diskutimeve dhe për të mos zgjuar prapë debat këtu do të doja vetëm të s shpjegoj që një koleg i imi thanë që mbase edhe janë tretur 140 milionë euro...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdojani, ministri e ka kohën e pa kufizuar.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, Kryetar! Më lejoni të sqaroj se në vitin 2008 paratë e lira në fund të vitit 2008 kanë qenë 871 milionë e 100 mijë euro, që u tha këtu se mbase kanë mund edhe të tretën,, fatkeqësisht më vjen keq për nivelin e komentimeve të tilla, por nuk dua ta kualifikoj nivelin e komentimit sa të shpjegoj. 12,8 milionë euro nga këto janë para të përcaktuara nga donatorët. E dinë kolegët që e kanë dhënë këtë vërejtje. Paratë e tjera kryesisht janë mjete të llogaritura, të minoriteteve janë 13 milionë euro, të hyrat vetjake të bartura 35,7 milionë euro, paratë e Fondit të Privatizimit janë 403 milionë euro dhe kështu në fund na mbetin 414 milionë e 100 mijë euro. Kjo është gjendja e Thesarit të vitit 2008 të cilat janë të bartura në Projektbuxhetin e vitit 2009, prej të cilave në fakt unë pajtohem që ka pasur një lëshim teknik në të cilin do të duhej të ishte në pasqyrë vlerësim e jo buxheti i vitit 2009, sepse ende nuk është harxhuar i tëri. Ne, sipas supozimeve kemi që buxheti dallon për 140 milionë euro dhe të cilat janë të parapara komplet në pasqyrën në tabelën e parë në qoftë se e shikoni, unë e lash në tavolinë, 140 milionë euro janë diku te kolona e shtatë atje shkruan minus 140 dhe

kështu vijmë në fund të vitit 2009, 372 milionë euro , që janë mjete që do të duhej të ishin mbetja bilancore në fund të vitit 2009, për të qenë të filluar buxhetin 2010 me 372 milionë euro plus.

Duke konsideruar se shumicën e përgjigjeve sigurisht që do të duhej të merrte shumë kohë për t'u përgjigjur edhe një pyetje që është shumë me rëndësi mbase u paraqit nga një deputet këtu për çështjen e pasaportave. Pasaportat biometrike janë të përfshira në fillim të buxhetit të vitit 2010 dhe kjo është synim yni, besoj që mjetet e ndara për fillim janë të mjaftueshme për të filluar në qoftë se shohim se ka nevojë për mjete më të mëdha, neve besoj se gjatë rishikimit të buxhetit do të ndajmë, por ajo është një synim i Ministrisë të Punëve të Brendshme e cila është paraparë edhe në buxhet.

Unë sinqerisht nuk do ta zgjasë më tepër, edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për debat, për sugjerime të zhukta dhe për mbështetjen duke kërkuar nga ju që ta mbështetni këtë buxhet, sepse siç e thanë edhe kolegët tjerë është buxhet që siguron qëndrueshmëri fiskale, është buxhet që është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe është buxhet që i hap Kosovës dyert e donatorëve të Komisionit Evropian dhe të Bankës Botërore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për fjalën rationale. Zoti Kryeministër, a e doni fjalën? Jo. Faleminderit!

Unë ju falënderoj të gjithë pjesëmarrësve në debat. Dhe, me fjalën e ministrit për Ekonomi dhe Financa mbyllim debatin e sotëm për Projektbuxhetin e vitit 2010.

Në sallë janë 97 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Faleminderit! Konstatoj se me 65 vota “për”, 14 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektbuxhetin për vitin 2010. Pa kartelë. sa janë? 3. Atëherë, 65 dhe 3 bëjnë 68. Regjia e përmirëson: 68 “për”, 14 “kundër”, 3 abstenime. Faleminderit! Mirupafshim nesër, në orën 10:00, në seancën solemne për nder të ambasadorit Robert Rohan.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës